



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 86

Tiranë – E mërkurë, 27 maj 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 397, datë 11.5.2015	Për krijimin e ndërmarrjes shtetërore “Kantieri i ndërtimit dhe riparimit të anijeve”..... 4513
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 421, datë 13.5.2015	Për procedurat e shqyrtimit të kërkesave, dokumentacionin, afatet e shqyrtimit dhe kriteret e veçanta të licencimit të veprimtarive të lejuara me armët..... 4515
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 422, datë 13.5.2015	Për një ndryshim në vendimin nr. 175, datë 6.3.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Lushnjë, të qarkut të Fierit”..... 4516
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 428, datë 20.5.2015	Për një ndryshim në vendimin nr. 345, datë 29.4.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2015, miratuar për aparatin e Kryeministrit”..... 4520
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 429, datë 20.5.2015	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës, për bashkëpunim të ndërsjellë në fushën e sigurisë..... 4520
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 430, datë 20.5.2015	Për miratimin, në parim, të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi, për bashkëpunim në kontekst të anëtarësimit në Bashkimin Evropian..... 4526
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 431, datë 20.5.2015	Për disa ndryshime në vendimin nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit”, të ndryshuar..... 4529
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 432, datë 20.5.2015	Për disa shtesa në vendimin nr. 332, datë 17.3.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e formës, elementeve përbërëse, mënyrës së mbajtjes së afatit të përdorimit të dokumenteve bazë, që mbahen dhe lëshohen nga shërbimi i gjendjes civile”, të ndryshuar..... 4530

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 433, datë 20.5.2015	Për sigurimin e jetës së ushtarakëve të Forcave të Armatosura, që dërgohen në misione ushtarake jashtë vendit, për vitin 2015.....	4537
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 434, datë 20.5.2015	Për përcaktimin e normativave për frot, humbjet, dëmtimet dhe skarcot gjatë prodhimit, magazinimit, transportimit etj., të njohura për qëllime fiskale.....	4537
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 435, datë 20.5.2015	Për dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet ministrisë së zhvillimit ekonomik, turizmit, tregtisë dhe sipërmarrjes, si qiradhënës, dhe shoqërisë “Mito by Caterina Firenze”, sh.p.k., si qiramarrës, për pasurinë “Ish-reparti i ngjyrosjes në ish-kombinatin e tekstileve, Berat” në “Berateks”, sh.a., Berat.....	4538
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 437, datë 20.5.2015	Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve.....	4539
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 438, datë 20.5.2015	Për krijimin e fondit kombëtar të garancisë për kreditimin e bujqësisë dhe zhvillimit rural.....	4576
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 439, datë 20.5.2015	Për rishpërndarje fondesh për shpenzime kapitale, ndërmjet programeve, brenda buxhetit të vitit 2015, miratuar për Ministrinë e Mjedisit.....	4576
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 440, datë 20.5.2015	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga rikonstruksioni dhe asfaltimi i rrugëve të brendshme në Bashkinë e Vorës.....	4577

**VENDIM****Nr. 397, datë 11.5.2015****PËR KRIJIMIN E NDËRMARRJES
SHTETËRORE “KANTIERI I
NDËRTIMIT DHE RIPARIMIT
TË ANIJEVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 3, të ligjit nr. 7582, datë 13.7.1992, “Për ndërmarrjet shtetërore”, dhe të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e ndërmarrjes shtetërore “Kantieri i ndërtimit dhe riparimit të anijeve”, në vijim KNRA, në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes.

2. KNRA-ja e ka qendrën (selinë) në Pashaliman, Vlorë.

3. Objekti i veprimtarisë së KNRA-së është ndërtimi dhe riparimi i mjeteve lundruese ushtarake dhe pajisjeve të Forcave të Armatosura, të mjeteve lundruese civile, të tilla si anije, skafe, motovedeta, gomone etj., si dhe kryerja e punimeve dhe shërbimeve për të tretë, në përputhje me kapacitetet teknike të ndërmarrjes.

4. Territori, inventari dhe çështje të tjera të pronësisë janë përcaktuar sipas planvendosjes bashkëlidhur vendimit, raportit të ekspertit kontabël dhe vlerësimit të pasurive të paluajtshme.

5. Tarifat e shërbimit të mjeteve lundruese dhe pajisjeve të Forcave të Armatosura përcaktohen me urdhër të ministrit të Mbrojtjes.

6. Riparimi i mjeteve lundruese të Forcave të Armatosura do të kryhet bazuar në kontratat e lidhura midis palëve dhe sipas një grafiku vjetor. Riparimi i mjeteve të Forcave të Armatosura ka prioritet mbi të gjitha subjektet e interesuara.

7. Përjashtimisht për vitin 2015, KNRA-ja do të kryejë riparimin e mjeteve lundruese të Forcës Detare, pa shpërblim.

8. Shuma e kapitalit themeltar është 2 446 392 291 (dy miliardë e katërqind e dyzet e gjashtë milionë e treqind e nëntëdhjetë e dy mijë e dyqind e nëntëdhjetë e një) lekë.

9. Shuma prej 97 874 561 (nëntëdhjetë e shtatë milionë e tetëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e një) lekësh transferohet nga Komanda e Forcës Detare Durrës në favor të ndërmarrjes shtetërore “Kantieri i ndërtimit dhe riparimit të anijeve”, si shtesë në kapitalin themeltar, sipas aneksit bashkëlidhur këtij vendimi.

10. Paga e drejtorit të KNRA-së është në nivelin 108 780 (njëqind e tetë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë) lekë, e cila në vijim indekskohet dhe ndryshohet me urdhër të ministrit Mbrojtjes dhe me propozim të Këshillit Drejtues të KNRA-së.

11. Pagat e punonjësve të KNRA-së miratohen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

12. Statuti i ndërmarrjes shtetërore “Kantieri i ndërtimit dhe riparimit të anijeve”, miratohet nga ministri i Mbrojtjes.

13. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI**Edi Rama**



MINISTRIA E MBROJTJES

**TABELA E RISHPËRNDARJES SË FONDEVE NE PROGRAMIN FORCAT E LUFTIMIT PËR KNA
PËR VITIN 2015**

	Ministria e linjës	Kodi i institucionit	Kapitulli	Emërtimi i institucionit	Programi	Llogaria ekonomike	Kodi i degës së thesarit	Pakësohet	Shtohet
				Forcat e Luftimit	02120			97,874,561	
001	17	1017009	01	Reparti ushtarak 2001-Durrës				97,874,561	
001	17	1017031	01	Rep. Usht. nr. 2001-KF Detare, Durrës	02120	600	0707	38,200,000	
001	17	1017031	01	Rep. Usht. nr. 2001-KF Detare, Durrës	02120	601	0707	6,303,000	
001	17	1017031	01	Rep.Usht. nr. 2001-KF Detare, Durrës	02120	602	0707	53,371,561	
				Kantieri i Ndërtimit të Anijeve, Pashaliman, Vlorë					97,874,561
				Kantieri i Ndërtimit të Anijeve, Pashaliman, Vlorë		604			97,874,561

VENDIM**Nr. 421, datë 13.5.2015**
**PËR PROCEDURAT E SHQYRTIMIT TË
KËRKESAVE, DOKUMENTACIONIN,
AFATET E SHQYRTIMIT DHE
KRITERET E VEÇANTA TË
LICENCIMIT TË VEPRIMTARIVE TË
LEJUARA ME ARMËT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 19, të ligjit nr. 74/2014, “Për armët”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:**I. TË PËRGJITHSHME**

1. Policia e Shtetit bën licencimin e veprimtarisë së personave fizikë e juridikë në fushën e veprimtarisë së lejuar me armët.

2. Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve (AKSHE) autorizon subjektet e licencuara nga Policia e Shtetit për import/eksport dhe tregtim të armëve të kategorive “B1”, “B4”, “C” dhe “D”.

AKSHE shqyrton kërkesën e subjekteve për import/eksport”, vetëm për armët e kategorive “B1” dhe “B4”, sipas legjislacionit në fuqi.

**II. DOKUMENTACIONI QË PARAQET
KANDIDATI PËR T’U PAJISUR ME
LICENCË**

3. Për t’u pajisur me licencë për veprimtaritë e lejuara me armë, titullari i subjektit paraqet në strukturën e policisë këto dokumente:

a) Formular aplikimi & autodeklarim për certifikimin/licencimin/autorizimin;

b) Vetëdeklarim “Për verifikimin e gjendjes gjyqësore”;

c) Letërnjoftim i njohur sipas legjislacionit në fuqi;

ç) Certifikatë regjistrimi të subjektit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, bashkëlidhur ekstraktit të gjendjes aktuale, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit sipas legjislacionit në fuqi;

d) Kontratë pune me drejtuesin teknik;

dh) Certifikatën e drejtuesit teknik të subjektit;

e) Raportin mjekësor, që vërteton se është i aftë nga ana mendore dhe fizike;

ë) Fotografi të aplikuesit, 4 copë.

**III. PROCEDURAT PËR PRANIMIN,
VERIFIKIMIN DHE SHQYRTIMIN E
DOKUMENTACIONIT**

4. Për pranimin, verifikimin dhe shqyrtimin e dokumenteve për licencim nga strukturat përkatëse të policisë ndiqet kjo procedurë:

a) Specialisti përkatës i policisë, i ngarkuar me detyrën e pranimit të dokumenteve, kërkon nga personi fizik ose subjekti plotësimin e formularëve përkatës sipas rubrikave;

b) Seksioni për krimet verifikon besueshmërinë dhe përgatit dokumentin e besueshmërisë dhe përshtatshmërisë së personit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve;

c) Specialisti i policisë dhe i armatimit inspekton në vend objektin dhe verifikon kushtet teknike e të sigurisë. Pas verifikimit përpilon raportin përkatës nëse objekti i plotëson kushtet



apo jo sipas përcaktimeve në rregulloren e sigurisë;

ç) Struktura përkatëse në Drejtorinë e Policisë së Shtetit verifikon dokumentacionin e ardhur për subjektet që kanë aplikuar për licencë në fushën e veprimtarisë me armët dhe i paraqet në komisionin qendror të shqyrtimit të kërkesave për licencim të subjekteve për veprimtaritë e lejuara me armët;

d) Vetëdeklarimi i dërgohet strukturës përkatëse për verifikimin e gjendjes gjyqësore;

dh) Komisioni qendror i shqyrtimit të kërkesave për licencim dhe certifikim mbledhet çdo muaj, shqyrton dokumentacionin e grumbulluar për pajisjen me licencë dhe vendos miratimin/refuzimin e licencës.

5. Në përfundim të shqyrtimit të kërkesës, komisioni qendror përgatit vendimin dhe ia paraqet për nënshkrim Drejtorit të Policisë së Shtetit.

6. Refuzimi i dhënies së licencës bëhet me vendim të arsyetuar dhe të interesuarit i kthehet përgjigje me shkresë.

7. Për rastet e kërkesave për përsëritje të licencës bëhet vlerësimi i performancës dhe ligjshmërisë së aktivitetit të subjektit gjatë periudhës së mëparshme të licencimit. Kërkesa për përsëritje bëhet 90 (nëntëdhjetë) ditë para përfundimit të afatit të licencës që ka në përdorim.

8. Afati i përgjithshëm i procedurës për njoftimin e kërkuarit për licencim është 90 (nëntëdhjetë) ditë.

9. Afati i vlefshmërisë së licencës është 5 (pesë) vjet.

IV. KRITERET E VEÇANTA TË LICENCIMIT

10. Personat dhe subjektet që kërkojnë të licencohen duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 34, të ligjit nr. 74/2014, “Për armët”.

11. Krahas kriterëve të përgjithshme të përcaktuara në ligjin nr. 74/2014, “Për armët”, subjekti duhet të plotësojë edhe këto kriterë të veçanta për ushtrimin e veprimtarisë së lejuar me armë:

a) Për ushtrimin e veprimtarisë së tregtimit dhe import-eksportit të armëve të kategorive “B1”, “B4”, “C” dhe “D”, të ketë një ambient të përshtatshëm për ushtrimin e aktivitetit sipas

kushteve të miratuara me rregullore, në pronësi apo përdorim për pesë vitet në vazhdim.

b) Për ushtrimin e veprimtarisë së transportit të armëve, pjesëve dhe municioneve të armëve të kategorive “B1”, “B4”, “C” dhe “D”, të zotërojë automjete sipas kushteve të përcaktuara në rregullore.

c) Për ushtrimin e veprimtarisë për poligon civil qitjeje, ndërtimi dhe mënyrën e funksionimit të ambienteve, të plotësojë kushtet e sigurisë të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave, në pronësi apo përdorim për pesë vitet në vazhdim.

ç) Për ushtrimin e veprimtarisë për aftësimin teorik dhe praktik për armët, të ketë një ambient të përshtatshëm për ushtrimin e aktivitetit sipas kushteve të miratuara me rregullore, në pronësi apo përdorim për pesë vitet në vazhdim, dhe poligon civil qitjeje.

V. TË FUNDIT

12. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 422, datë 13.5.2015

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 175, DATË 6.3.2012, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E
LISTËS PËRFUNDIMTARE TË
PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, QË TRANSFEROHEN NË
PRONËSI OSE NË PËRDORIM
TË BASHKISË LUSHNJË, TË QARKUT
TË FIERIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, shkronja “e”, 5, 8 e 17, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

1. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme publike shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të Bashkisë Lushnjë, Qarku Fier, bashkëlidhur vendimit nr. 175, datë 6.3.2012, të Këshillit të Ministrave, shtohen pronat me nr. 4271 dhe nr. 4272, gjithsej 2 (dy) prona.

2. Pronat me nr. 4271 dhe nr. 4272, të llojit “truall”, sipas formularit dhe planimetrisë që i bashkëlidhen këtij vendimi, kalojnë në pronësi të Bashkisë Lushnjë për t’u përdorur për ndërtimin e objekteve të sh.a., Ujësjellës-Kanalizime Lushnjë.

3. Bashkisë Lushnjë i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e pronës, të përcaktuar në pikën 2, të këtij vendimi, ta tjetërsojë atë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Bashkia Lushnjë për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE
(Per inventarizimin e pronave te vecanta)

Bashkia Lushnje				Identifikoi: Brunilda Bekaj Specialist (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)		Supervizoi: Myftar Çela Specialist (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)		Aprovoi: Fatos Tushe Kryetari i bashkise (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vula)			
Fusha e përdorimit të Pronës: Infrastruktura											
Nr. Rend.	A		Lloji i Pronës	B		C					
	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurisë		Emri i Pronës Adresa	Sip. Totale e Pronës (m ²)	Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m ²)	Funksioni për të cilin përdoret Prona	Institucioni / Enti me përgjegjësi administrative	Institucioni / Enti përdorues Statusi juridik i përdorimit	Te dhëna të tjera (Shënime të veçanta)	
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	
4271	8572 Lu-M-6	14/56	Truall	Truall Lagja "Gafur Muco" Bashkia Lushnje	14850		Truall	Bashkia Lushnje	Bashkia Lushnje	Nuk përfshihet pasuria 14/269 Truall+ndertese ne pronesi pr	
4272	8572 Lu-M-6	14/57	Truall	Truall Lagja "Gafur Muco" Bashkia Lushnje	975		Truall	Bashkia Lushnje	Bashkia Lushnje		





**VENDIM****Nr. 428, datë 20.5.2015**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 345, DATË 29.4.2015, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR NJË SHITESË
FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2015,
MIRATUAR PËR APARATIN E
KRYEMINISTRISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të neneve 10 e 13, të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 2, të vendimit nr. 345, datë 29.4.2015, të Këshillit të Ministrave, fjalët “...fondi i kontingjencës ...” zëvendësohen me “...fondi rezervë i buxhetit të shtetit ...”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

VENDIM**Nr. 429, datë 20.5.2015**

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES,
NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS SË KOSOVËS, PËR
BASHKËPUNIM TË NDËRSJELLË
NË FUSHËN E SIGURISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23, të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998, “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës, për bashkëpunim të ndërsjellë në fushën e sigurisë, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Faqe | 4520

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

MARRËVESHJE

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS PËR BASHKËPUNIM TË
NDËRSJELLË NË FUSHËN E SIGURISË**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Kosovës më poshtë të referuara si “Palët”;

në kuadër të marrëdhënieve të shkëlqyera që ekzistojnë ndërmjet dy vendeve sovrane;

të shqetësuar për rritjen në shkallë botërore të akteve terroriste në nivel ndërkombëtar dhe të krimit ndërkombëtar, krimet e lidhura me lëndët narkotike dhe trafikimin e paligjshëm të tyre;

duke vepruar sipas parimit të barazisë dhe interesit reciprok, në përputhje me legjislacionin e brendshëm, rregullat dhe procedurat e vendeve të tyre, si dhe në përputhje me dispozitat e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të zbatueshme, pa cenuar interesat e ndonjë pale të tretë;

duke synuar përmirësimin e mëtejshëm të nivelit të bashkëpunimit brenda kuadrit të bashkëpunimit në fushën e sigurisë së rendit publik ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës,

kanë rënë dakord sa vijon:

Neni 1

Fushat e bashkëpunimit

1. Palët, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe nëpërmjet autoriteteve të tyre kompetente, angazhohen të bashkëpunojnë në fushën e parandalimit të kërcënimeve ndaj rendit dhe sigurisë publike, të japin ndihmë të ndërsjellë në parandalimin dhe zbulimin e veprave penale dhe në kërkimin e personave që janë autorë të këtyre veprave penale.

2. Fushat e bashkëpunimit, siç përcaktohen në legjislacionet kombëtare të secilës Palë, janë si më poshtë:

a) Veprat penale kundër jetës, shëndetit, lirisë, dinjitetit njerëzor dhe pronës;



- b) Krimi i organizuar;
- c) Terrorizmi dhe financimi i terrorizmit;
- d) Prodhimi i paligjshëm dhe trafikimi lëndëve narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve të tyre;
- e) Ulja e kërkesës për përdorimin e drogës;
- f) Korrupsioni, veprat penale që lidhen me aktivitetet financiare dhe ekonomike;
- g) Migracioni i paligjshëm dhe trafikimi i qenieve njerëzore;
- h) Tregtimi dhe trafikimi i qelizave, indeve dhe organeve të njeriut;
- i) Prodhimi, tregtimi i paligjshëm dhe kontrabanda e armëve, municioneve, eksplozivëve, materialeve bërthamore, radioaktive, kimike dhe biologjike, si edhe materialeve të tjera të rrezikshme, mallrave dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë;
- j) Tregtimi i paligjshëm i aseteve historike dhe kulturore, veprave të artit dhe metaleve të çmuara;
- k) Falsifikimi i parave, dokumenteve me vlerë, pasaportave, vizave dhe dokumenteve të tjera zyrtare;
- l) Vepra penale në fushën e aktivitetit të huaj ekonomik;
- m) Pastrimi i të ardhurave që burojnë nga aktiviteti kriminal;
- n) Shkelje e së drejtës intelektuale dhe të pronësisë;
- o) Vepra penale kundër mjedisit;
- p) Krimet kompjuterike;
- q) Vjedhjet e makinave;
- r) Veprat penale kryer ndaj të miturve;
- s) Të gjitha llojet e veprave të kontrabandës veçanërisht kontrabanda e cigareve dhe mallrave;
- t) Bashkëpunimi dypalësh dhe metodat e luftës në fushën e abuzimit të fëmijëve në internet;
- u) Krimet e vrasjes, të vjedhjes;
- v) Njerëzit e humbur të kërkuar;
- w) Bashkëpunim në fushën e mbrojtjes së dëshmitarëve.

3. Palët mund të caktojnë reciprokisht oficerë ndërlihdës në misionet e tyre diplomatike në mënyrë që të rritet efikasiteti i ndërveprimit dhe koordinimit të veprimeve të përbashkëta brenda kuadrit të kësaj Marrëveshjeje.

4. Palët, në bazë të legjislacionit kombëtar dhe nëpërmjet autoriteteve të tyre kompetente, do të

bashkëpunojnë për identifikimin, zbulimin, sekuestrimin me qëllim konfiskimin dhe rikuperimin e produkteve të krimit të organizuar, trafikeve të paligjshme, terrorizmit dhe pastrimit të parave.

Neni 2

Format e bashkëpunimit

1. Bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve kompetente të Shteteve të Palëve kryhet në përputhje me legjislacionin kombëtar në format e mëposhtme:

a) Shkëmbimi i informacionit mbi rrethanat që mund të ndihmojnë për të parandaluar kërcënimet ndaj rendit dhe sigurisë publike, si dhe për të parandaluar dhe zbuluar veprat penale;

b) Shkëmbimi i eksperiencës në fushën e zbatimit të instrumenteve ligjore që kanë të bëjnë me parandalimin e krimit dhe luftën kundër terrorizmit dhe që aplikohen ndaj formave e metodave të reja, dhe mënyrave të kryerjes së ekzaminimeve mjeko - ligjore;

c) Shkëmbimi i informacionit lidhur me format dhe metodat më efektive në luftën kundër krimit dhe terrorizmit;

d) Kryerja e veprimeve të përbashkëta të koordinuara nga autoritetet kompetente të Shteteve të Palëve që kanë për qëllim parandalimin e kërcënimeve ndaj rendit dhe sigurisë publike, parandalimin e akteve terroriste, si edhe parandalimin dhe zbulimin e veprave penale duke përfshirë dërgesat e kontrolluara;

e) Shkëmbimi i informacionit mbi personat që u shmangën ndjekjes penale;

f) Shkëmbimi i informacionit mbi identifikimin e kufomave të paidentifikuara;

g) Shkëmbimi i eksperiencës, informacionit lidhur me identifikimin, zbulimin, sekuestrimin, konfiskimin, administrimin dhe kthimin e aseteve të krimit të organizuar, trafikeve të paligjshme, terrorizmit dhe pastrimit të parave.

Neni 3

Shkëmbimi i informacionit

1. Autoritetet kompetente të Palëve ndihmojnë njëra - tjetrën mbi bazë kërkesë.

2. Kërkesat për dhënie asistence dhe përgjigjet e tyre përcillen me shkrim. Në rast emergjence, kërkesat mund të dërgohen verbalisht, të pasuara menjëherë nga konfirmimi me shkrim me



përdorimin e mënyrave teknike të dërgimit të dhënave.

Kërkesa për marrjen e informacionit përmban:

- emrin e autoritetit kompetent kërkues dhe autoritetin kompetent të kërkuar;
- formulimin e thelbit të çështjes dhe arsytimit për të, si dhe informacionin mbi ekzekutimin e saj.

3. Informacioni dhe dokumentet, të marra në përputhje me kushtet e këtij neni, nuk i dërgohen një palë të tretë, pa marrë miratimin paraprak të Palës Dërguese.

4. Në kuadrin e kësaj Marrëveshje, secila nga Palët mund të refuzojë, plotësisht ose pjesërisht, një kërkesë për ndihmë nëse Pala vlerëson se përmbushja e saj mund të kërcënojë sovranitetin, sigurinë dhe interesa të tjerë jetikë të shtetit të saj, ose nëse kërkesa nuk është në përputhje me legjislacionin kombëtar të shtetit të Palës, ose cenon detyrimet e saj që rrjedhin nga marrëveshje ndërkombëtare. Në këtë rast, Pala e kërkuar njofton menjëherë Palën Kërkuese mbi refuzimin dhe jep informacion ose shpjegon arsyet e saj.

5. Në përputhje me këtë Marrëveshje, shkëmbimi i informacionit të kufizuar kryhet në përputhje me legjislacionin kombëtar të secilës Palë.

Neni 4

Autoritetet kompetente

1. Autoritetet kompetente të Palëve për zbatimin e kësaj Marrëveshje janë si më poshtë:

Për Palën Shqiptare:

Ministria e Punëve të Brendshme;

Ministria e Financave;

Ministria e Shëndetësisë

Për Palën Kosovare:

Ministria e Punëve të Brendshme

Ministria e Financave;

Ministria e Shëndetësisë.

Neni 5

Format e bashkëpunimit në luftën kundër terrorizmit

a) Secila Palë do të marrë masa eficiente për parandalimin e përgatitjes dhe kryerjes së akteve terroriste brenda territorit të tyre, kundër qytetarëve dhe sigurisë së Palës tjetër.

b) Bashkëpunimi në luftën kundër terrorizmit do të mbulojë veçanërisht bashkëpunimin në shërbimin e informimit, zbulimit, vlerësimin e përbashkët dhe bashkëpunimin operacional në lidhje me organizatat terroriste dhe mënyrat e tyre të veprimit, aktet terroriste, financimin e terrorizmit, të cilat cenojnë sigurinë e Palëve, teknikat e metodat e përdorura në luftën kundër terrorizmit.

c) Palët në kuadër të luftës kundër terrorizmit, nuk do të lejojnë aktivitetet e strukturave të komunikimit, vizive dhe të shkruara, të organizatave terroriste, që të veprojnë në territorin e palës tjetër. Palët do t'i konsiderojnë ato si organizata të paligjshme dhe do të marrin masat e duhura në këtë fushë në përputhje me legjislacionin e tyre.

d) Palët do të zhvillojnë dhe do të zbatojnë masa efektive të luftës në lidhje me personat dhe institucionet që sigurojnë mbështetje financiare si strehim, akomodim, trajnim dhe trajtim e mbështetje logjistike për organizatat terroriste në territoret e tyre.

e) Palët do të shkëmbejnë informacion dhe përvojë në lidhje me metodat e parandalimit dhe luftës kundër terrorizmit duke përfshirë çështjet e pengmarrjeve dhe rrembimeve të avionit dhe do të kryejnë studime të përbashkëta për çështjet e përmendura, faktet e qarkullimit të paligjshëm të materialeve nukleare, armëve kimike, bakteriologjike (biologjike) ose komponentet e tyre, substancave kimike toksike, sëmundjeshkaktuese, mikroorganizma.

f) Palët do të shkëmbejnë informacion dhe përvojë në lidhje me armët, pajisjet dhe instalimet teknike të përdorura në luftën kundër terrorizmit. Ato do të sigurojnë trajnime reciproke për personelin e njërive që merren me terrorizmin dhe në këtë drejtim ata do të organizojnë kurse trajnimi, seminare dhe takime konsultative duke bashkëpunuar në fushën e analizimit të natyrës, dinamikës dhe formave të terrorizmit.

g) Palët do të shkëmbejnë informacion duke monitoruar lëvizjet e pajisjeve teknologjike, të gjitha llojeve të armëve dhe municioneve, të cilat mund të përdoren për përgatitjen e kryerjes së akteve terroriste me qëllim për parandalimin e organizatave terroriste nga blerja e këtyre pajisjeve.



h) Palët do të shkëmbejnë informacion nëpërmjet autoriteteve të tyre kompetente për të bashkëpunuar për identifikimin, zbulimin, sekuestrimin me qëllim konfiskimin, administrimin dhe rikuperimin e produkteve të krimit të organizuar, trafikëve të paligjshme, terrorizmit dhe pastrimit të parave.

Neni 6

Format specifike të bashkëpunimit në fushën e luftës kundër krimit të organizuar

1. Në pajtim me legjislacionin e tyre kombëtar, autoritetet kompetente të Palëve do të shkëmbejnë informacion rreth:

a) strukturës, përbërjes, fushave të aktivitetit dhe kontakteve të jashtme të grupeve të organizuara dhe organizatave kriminale, aktivitetet e të cilave kanë karakter ndërkombëtar;

b) formave dhe metodave të kryerjes së aktiviteteve të paligjshme nga grupe të organizuara, duke përfshirë pastrimin e parave;

c) aktivitetit konkret të paligjshëm, të planifikuar ose të kryer nga anëtarët e grupeve të organizuara dhe organizatat kriminale në territoret e shteteve të Palëve;

d) kriterëve të vlerësimit të situatës operative në luftën kundër krimit të organizuar.

Neni 7

Format specifike të bashkëpunimit në fushën e kultivimit dhe trafikimit të paligjshëm të lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope

1. Në pajtim me legjislacionet e tyre kombëtare, autoritetet kompetente të Palëve bashkëpunojnë me synimin për të luftuar qarkullimin e paligjshëm të lëndëve narkotike, nëpërmjet:

a) shkëmbimit të informacionit rreth përpjekjeve për të bërë kontrabandë të lëndëve narkotike ose substancave psikotrope e në territorin e Shtetit të njëjës prej Palëve;

b) shkëmbimit të informacionit rreth mjeteve që janë përdorur gjatë kalimit kufitar, si edhe metodat për zbulimin e tyre;

c) shkëmbimit të informacionit rreth personave që janë përfshirë në trafikimin e paligjshëm të lëndëve narkotike ose substancave stimuluese si dhe rreth itinerareve për transportimin e këtyre mjeteve dhe substancave;

d) shkëmbimi i informacionit rreth formave dhe metodave të pastrimit të parave të fituara nga prodhimi dhe trafikimi i paligjshëm i lëndëve narkotike ose substancave psikotrope, substancat e tyre dhe prekursorëve të përdorur në prodhimin e tyre;

e) shkëmbimit të ndërsjellë të rezultateve të kërkimit mbi çështje që lidhen me luftën kundër qarkullimit të paligjshëm të lëndëve narkotike.

2. Autoritetet kompetente, të cilat janë të autorizuar në përputhje me legjislacionet e tyre kombëtare, marrin në konsideratë mundësinë e përdorimit të metodës së dërgesave të kontrolluara.

Neni 8

Format specifike të bashkëpunimit në fushën e luftës kundër migracionit dhe trafikimit të paligjshëm të qenieve njerëzore

1. Në pajtim me legjislacionet e tyre kombëtare, autoritetet kompetente të shteteve të Palëve shkëmbejnë informacion mbi metodat dhe itineraret e migracionit të paligjshëm të organizuar dhe gjithashtu informacion që lidhet me kontrollin e pasaportave dhe vizave dhe ekzemplarët e këtyre dokumenteve, të cilat legalizojnë kalimin e kufirit shtetëror; shtojcat e këtyre dokumenteve; llojet e vizave dhe simboleve. Informimi i ndërsjellë rreth lëvizjes së lirë dhe procedurës së lëshimit të pasaportave dhe rreth aspekteve të përdorimit të kufizimeve do të sigurohet nga Palët.

2. Në pajtim me legjislacionin e tyre kombëtar, autoritetet kompetente të Shteteve të Palëve organizojnë bashkëveprimin e luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore, konkretisht:

a) shkëmbimin e informacionit rreth trafikanteve të qenieve njerëzore dhe viktimave të aktiviteteve të tyre të paligjshme;

b) organizimin e operacioneve rajonale mbi asgjësimin e kanaleve ndërkombëtare të trafikimit të qenieve njerëzore.

Neni 9

Format e veçanta të bashkëpunimit në luftën kundër krimeve kompjuterike

1. Në pajtim me legjislacionin e tyre kombëtar, autoritetet kompetente të Palëve shkëmbejnë informacion mbi:



a) aktivitetin e paligjshëm të organizatave, grupeve dhe personave të veçantë, të cilët veprojnë në fushën e përdorimit të kompjuterëve, sistemeve dhe rrjeteve kompjuterike si dhe rrjeteve të telekomunikimit të Palëve;

b) viruset kompjuterike, programet kompjuterike (software), shënjesat (bookmarks), hardare-software dhe hardware, si edhe mjeteve të tjera të dëmshme, të cilat mund të shkaktojnë çaktivizimin e objekteve me rëndësi jetësore ose përhapjen, humbjen dhe keqpërdorimin e informacionit të mbrojtur;

c) metodat dhe mjetet e mbrojtjes kundër viruseve kompjuterike, shënjesave, dhe mjeteve të tjera të dëmshme kompjuterike, përfshirë ndikimit të padukshëm negativ të informacionit kompjuterik;

d) materialet për sa i përket kryerjes së ekspertizës teknike të programit (mjeko – ligjore -kompjuterike) në procesin e hetimit të krimeve, i cili kryhet me përdorimin e teknologjive kompjuterike, metodave dhe teknikave të kërkimit të teknikës kompjuterike me synimin e dokumentimit të aktiviteteve kriminale;

e) legjislacionin kombëtar, i cili rregullon çështjet për sa i përket parandalimit, zbulimit, dhe identifikimit të krimeve në fushën e përdorimit të kompjuterëve, sistemeve dhe rrjeteve kompjuterike si dhe rrjeteve të telekomunikimit dhe përmirësimit të legjislacionit.

Neni 10

Bashkëpunimi në trajnime

Palët do të bashkëpunojnë me njëra tjetrën në fushat e mëposhtme të trajnimit:

1. Edukimi parauniversitar, universitar dhe pasuniversitar (përfshi dhe studimet doktorale).

Palët do të pranojnë studentë nga Pala tjetër në studimet parauniversitare dhe universitare dhe pas universitare në akademitë policore dhe institucioneve të tjera të formimit policor të vendeve të tyre. Procesi i përzgjedhjes i studentëve do të bëhet nga autoritetet përkatëse të Palës dërguese, në përputhje me kërkesat e pranimit.

2. Trajnimet ndërkombëtare

Palët do të pranojnë personelin e Palës tjetër në programet trajnuese të ofruara në nivel ndërkombëtar.

3. Pozicioni i të diplomuarve

Barasvlefshmëria e diplomave parauniversitare do të pranohet dhe të diplomuarit do të marrin detyrën në vendet e tyre në të njëjtin pozicion si oficerët e tjerë të lartë. Më tej, Palët mund të organizojnë trajnime të përbashkëta dhe programe shkëmbimi ekspertësh mbi luftën kundër terrorizmit dhe krimit të organizuar dhe mbi çështje të tjera bashkëpunimi.

Neni 11

Mbrojtja e të dhënave personale

Autoritetet kompetente të Palëve shkëmbejnë të dhëna personale në pajtim me legjislacionin e tyre kombëtar, si dhe me kushtet e mëposhtme që zbatohen:

1. Të dhënat e dërguara duhet të përdoren ekskluzivisht për qëllimet për të cilat ato janë dhënë.

2. Me kërkesën e Palës dërguese, institucioni që merr të dhënat jep informacion mbi përdorimin e tyre brenda 30 ditëve kalendarike.

3. Autoriteti kompetent, i cili jep këto të dhëna, siguron vërtetësinë dhe saktësinë e tyre. Nëse këto të dhëna provohen se janë të pavërteta ose përhapja e tyre konfirmohet se është e ndaluar për shkak të kërkesave të legjislacionit, autoriteti i cili merr të dhënat njoftohet menjëherë për këtë dhe asgjëson ose korrigjohet këto të dhëna sipas pikës 4.

4. Të dhënat e dërguara asgjësohen ose korrigjohen në rastet e mëposhtme:

a) Nëse provohet pasaktësia e këtyre të dhënave;

b) Autoriteti kompetent dërgues njofton që këto të dhënat u mbledhën ose u dhanë në kundërshtim me ligjin;

c) Të dhënat nuk janë më të nevojshme për përmbushjen e detyrës për të cilën u dhanë, përveç kur ekziston një leje me shkrim që të dhënat e dërguara mund të përdoren për qëllime të tjera.

5. Nëse autoriteti që merr të dhënat ka arsye të vlerësojë se të dhënat e dërguara janë të pasakta ose duhet të shkatërrohen, ai njofton për këtë autoritetin dërgues.

6. Autoritetet kompetente marrin masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga fshirja, hyrja e paautorizuar, ndryshimet ose përhapja e tyre, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në



rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi.

7. Me dërgimin e të dhënave, autoriteti dërgues dhe autoriteti marrës do të përpilojnë një formular për të regjistruar dërgimin dhe marrjen e këtyre të dhënave dhe për të vendosur mbi procedurat për sa u përket këtyre të dhënave.

8. Autoritetet kompetente do të mbajnë të dhënat e dokumentuara në atë formë që të lejojnë identifikimin e subjekteve të të dhënave për një kohë, por jo më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar më tej.

9. Autoritetet kompetente që vihen në dijeni më të dhënat e përpunuara, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmerinë edhe pas përfundimit të funksionit. Këto të dhëna nuk përhapen, përveç rasteve të parashikuara në legjislacionin përkatës.

10. Palët kompetente do të sigurojnë që zbatimi i kërkesave për mbrojtjen e të dhënave personale të vendosura në këtë Marrëveshje të monitorohet nga autoritetet e pavarura që mbikëqyrin në përputhje me legjislacionet përkatëse të Palëve kompetente në këtë fushë. Në rast të shkeljes së të drejtave që lidhen me mbrojtjen e të dhënave, personale prekur kanë të drejtë ligjore të ankohen në autoritetin e pavarur, si dhe në gjykate në përputhje me legjislacionet respektive kombëtare të Palëve kompetente.

Neni 12

Zbatimi i marrëveshjes

1. Autoritetet kompetente të Shteteve të Palëve, nëse është e nevojshme, mund të ndërmarrin konsultime dhe takime pune për të diskutuar masat përsa i përket zbatimit të kësaj Marrëveshjeje.

2. Për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, autoritetet kompetente të shteteve të Palëve mund të nënshkruajnë protokolle, të krijojnë grupe pune, të organizojnë takime ekspertësh dhe të kryejnë aktivitete të koordinuara.

Neni 13

Komisioni i përbashkët

1. Palët krijojnë një komision të përbashkët për koordinimin dhe vlerësimin e bashkëpunimit në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje. Palët informojnë

njëra - tjetrën nëpërmjet rrugëve diplomatike për përfaqësuesit e tyre në Komisionin e Përbashkët, brenda 90 ditëve nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje.

2. Komisioni i Përbashkët mbledhet sa herë që është e nevojshme. Secila prej Palëve mund të iniciojë takimet e Komisionit të Përbashkët.

3. Komisioni i Përbashkët ndërmerr takimet e tij në mënyrë të njëpasnjëshme në Republikën e Shqipërisë dhe në Republikën e Kosovës.

Neni 14

Shpenzimet

Të gjitha shpenzimet lidhur me kryerjen e aktiviteteve brenda kuadrit të kësaj Marrëveshjeje, do të përballohen vetë nga Palët.

Neni 15

Raporti me marrëveshjet e tjera ndërkombëtare

Kjo Marrëveshje nuk cenon te drejtat dhe detyrimet që parashikohen nga marrëveshjet e tjera ndërkombëtare në të cilat bëjnë pjesë Palët.

Neni 16

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Çdo mosmarrëveshje në interpretimin dhe zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje zgjidhet nëpërmjet konsultimeve dhe bisedimeve ndërmjet autoriteteve kompetente të Palëve.

2. Në rast se nuk arrihet një konsensus në procesin e konsultimeve dhe bisedimeve sipas paragrafit çështja zgjidhet nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 17

Hyrja në fuqi dhe përfundimi

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi ditën e marrje se njoftimit të fundit me shkrim ku Palët njoftojnë njëra - tjetrën, nëpërmjet kanaleve diplomatike, për përmbushjen e procedurave të tyre të brendshme ligjore të kërkuara për hyrjen në fuqi.

2. Kjo Marrëveshjeje do të mbetet në fuqi për një periudhë të pacaktuar. Secila Palë mund të njoftojë Palën tjetër në çdo kohë me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike rreth qëllimit të saj për të përfunduar Marrëveshjen, 6 muaj para skadimit.



3. Me miratimin e përbashkët të palëve, kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me anë të Protokolleve të veçanta, të cilat janë pjesë integrale e Marrëveshjes.

4. Në rastin e përfundimit të Marrëveshjes, të gjitha veprimtaritë të nisura nga kjo Marrëveshje do të ndërmerren nën termat dhe kushtet e saj.

Bërë në Tiranë, më 23 mars 2015, në dy kopje origjinale, secila në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze, duke qenë të gjitha tekstet njëloj autonome. Në rast mosmarrëveshjes në interpretimin e kësaj Marrëveshje, do të mbizotërojë teksti në shqip.

VENDIM

Nr. 430, datë 20.5.2015

PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MALIT TË ZI, PËR BASHKËPUNIM NË KONTEKST TË ANËTARËSIMIT NË BASHKIMIN EVROPIAN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 7, të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998, “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin, në parim, të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi, për bashkëpunim në kontekst të anëtarësimit në Bashkimin Evropian, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MALIT TË ZI NË KONTEKSTIN E ANËTARËSIMIT NË BASHKIMIN EUROPIAN

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Malit të Zi (në vijim referuar si “Palët Kontraktuese”):

- *nisur nga objektivi strategjik* për të arritur anëtarësimin e plotë në Bashkimin Evropian;

- *duke mbajtur parasysh* rëndësinë e qasjes individuale në vlerësimin e përmbushjes së kriterëve për anëtarësim në BE;

- *të vetëdijshëm* për rëndësinë e kontributit të përbashkët për përparimin në arritjen e afirmimit të përhershëm të vlerave europiane në rajon;

- *duke riafirmuar* rëndësinë e reformave politike, institucionale, ekonomike dhe ligjore në arritjen e standardeve të BE-së;

- *duke mbajtur parasysh* përkushtimin e BE-së për të mbështetur reformat në rajon përmes programeve të ndryshme dhe instrumenteve për ndihmë financiare dhe me ekspertë;

- *të vendosur* për të vazhduar zhvillimin e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë dhe bashkëpunimit rajonal;

- *të vetëdijshëm* për rëndësinë e zhvillimit të mëtejshëm të bashkëpunimit në fushat me interes të përbashkët me qëllim përsheptimin e harmonizimit të legjislacionit vendor me *acquis*;

- *nisur nga konkluzionet* e Kryesisë së Këshillit Europian në Selanik, në Samitin e BE-së dhe të vendeve të përfshira në Procesin e Stabilizim Asociimit të muajit qershor 2003;

- *të inkurajuar* nga konsensusi i rinovuar për zgjerimin, siç përcaktohet në konkluzionet e Kryesisë së Këshillit Europian të dhjetorit 2006 në Bruksel;

- *duke përsëritur* konkluzionet e Këshillit Europian të 29 qershorit 2012 mbi fillimin e negociatave me Malin e Zi dhe dhënien e statusit kandidat Republikës së Shqipërisë nga ana e Këshillit Europian më 27 qershor 2014;

- *të gatshëm* për rritjen e dialogut të rregullt politik me fokus të veçantë në bashkëpunimin që synon integrimin në strukturat europiane;



- duke marrë parasysh të gjitha marrëveshjet dypalëshe të lidhura midis Palëve Kontraktuese; kanë rënë dakord si më poshtë:

KAPITULLI I Dialogu politik

Neni 1

Palët Kontraktuese bien dakord të intensifikojnë dialogun e tyre të rregullt politik me qëllim rritjen e bashkëpunimit në kontekstin e integritimit evropian dhe afirmimit të vlerave europiane në bashkëpunimin dypalësh dhe rajonal.

Neni 2

Dialogu politik do të zhvillohet përmes mbledhjeve të Ministrave të Punëve të Jashtme dhe Integritimit Evropian ose takimeve të përfaqësuesve të tre ministrive në nivel të lartë, çdo vit.

Dialogu politik do të nxisë bashkëpunimin në fushat me interes të ndërsjellë në procesin e anëtarësimit në BE dhe çështjet që lidhen me stabilitetin në rajon dhe në përmirësimin e bashkëpunimit rajonal.

Palët Kontraktuese do të jenë të hapura për dialog me vendet e tjera në procesin e pranimit.

Neni 3

Palët kontraktuese do të forcojnë dialogun dhe bashkëpunimin midis autoriteteve shtetërore kompetente për integrimin evropian, posaçërisht Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë, Ministrisë së Integritimit Evropian të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Integritimit Evropian të Malit të Zi.

Në kuadrin e këtij bashkëpunimi, Palët Kontraktuese do të ketë konsultime në nivel operativ në lidhje me:

- reformën e legjislacionit dhe harmonizimin e legjislacionit vendor me acquis;
- trendet aktuale dhe në zhvillim në procesin e pranimit në BE;
- menaxhimin i Instrumentit të paraaderimit dhe ndihma të tjera që lidhen me integrimin e të dy vendeve në BE;
- shkëmbimin e ekspertëve në fusha me interes të përbashkët;
- ndihmën administrative dhe me ekspertë.

Neni 4

Me synimin për të zhvilluar marrëdhëniet e përgjithshme në rajon dhe përshejtimin e procesit të integritimit evropian, Palët Kontraktuese do të inkurajojnë bashkëpunimin ndërmjet parlamenteve, veçanërisht në mes të komisioneve kompetente për pranimin në BE dhe do të kontribuojnë në rritjen e bashkëpunimit ndër-parlamentar në rajon.

KAPITULLI II Bashkëpunimi ekonomik dhe tregtar

Neni 5

Palët Kontraktuese do të bashkëpunojnë për të siguruar respektimin e të gjitha dispozitave të parapara për adoptimin e tregtisë së lirë në rajon, dhe për të arritur harmonizimin e sistemit doganor, duke ndihmuar zbatimin e Marrëveshjes për amendimin dhe aderimin në Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë të Europës Qendrore, nënshkruar në Bukuresht më 19 dhjetor 2006.

Neni 6

Palët Kontraktuese do të marrin në konsideratë potencialet e forcimit të bashkëpunimit ekonomik dhe do të kërkojnë të bëjnë përparim në fushat me interes të ndërsjellë.

Neni 7

Palët Kontraktuese do të sigurojnë mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale, duke përfshirë masat për dhënien dhe zbatimin e të drejtave të tilla që përputhen me standardet ndërkombëtare.

KAPITULLI III Lëvizja e punonjësve dhe kapitalit, krijimi dhe ofrimi i shërbimeve

Neni 8

Në lidhje me lëvizjen e punonjësve dhe kapitalit, krijimin dhe ofrimin e shërbimeve, Palët Kontraktuese do t'i bëjnë njëri tjetrit koncesione të tjera të barabarta, në përputhje me marrëveshjet e tyre të veçanta.

Lëvizja e punonjësve do të rregullohet me një marrëveshje dypalëshe, duke marrë në konsideratë mundësitë e punësimit të përcaktuara nga gjendja në tregun e punës të secilës Palë Kontraktuese.



Neni 9

Palët Kontraktuese do të lehtësojnë lëvizjen e lirë të kapitalit dhe të ushtrimit të së drejtës së krijimit të ndërmarrjeve, dhe do të japin stimuj adekuate dhe mbrojtje për këtë qëllim. Pagesat aktuale ndërmjet Palëve Kontraktuese do të kryhen në pajtim me dispozitat e Statutit të Fondit Monetar Ndërkombëtar, në një monedhë të konvertueshme sipas praktikës të zakonshme bankare ndërkombëtare.

Neni 10

Palët Kontraktuese bien dakord të inkurajojnë bashkëpunimin reciprok në furnizimin e shërbimeve në përputhje me dispozitat përkatëse të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tregtinë në Shërbime (GATS) dhe Organizatës Botërore të Tregtisë.

KAPITULLI IV

Harmonizimi i legjislacionit me *acquis*

Neni 11

Me synimin për procesin e pranimit të tyre në Bashkimin Europian, Palët Kontraktuese theksojnë rëndësinë e harmonizimit të ligjeve të tyre ekzistuese dhe të ardhshme me *acquis*.

KAPITULLI V

Bashkëpunimi në fushat e gjyqësorit dhe të punëve të brendshme

Neni 12

Palët Kontraktuese bien dakord të intensifikojnë bashkëpunimin në fushat e gjyqësorit dhe të punëve të brendshme, në veçanti në lidhje me politikën e azilit, migrameve, ripranimin, trafikimin e qenieve njerëzore, regjimin e vizave, pastrimin e parave, korrupsionin, kontrabandën, tregtinë ilegale të drogës dhe armëve, luftën kundër terrorizmit ndërkombëtar, mbrojtjen e të dhënave personale, reformën e gjyqësorit, reformën e administratës publike dhe sundimin e ligjit.

Neni 13

Palët Kontraktuese bien dakord të bashkëpunojnë në parandalimin e përdorimit të sistemeve të tyre financiare për pastrimin e të ardhurave nga krimi, sidomos të ardhurave nga krimi i organizuar.

Bashkëpunimi në këtë fushë do të përqendrohet në zbatimin e rregulloreve dhe funksionimin efikas të mekanizmave dhe standardeve përkatëse ndërkombëtare për të luftuar pastrimin e parave.

Neni 14

Palët Kontraktuese do të krijojnë një kuadër bashkëpunimi që synon parandalimin dhe luftimin e aktiviteteve kriminale dhe të paligjshme, veçanërisht krimin e organizuar.

Neni 15

Brenda fushëveprimit të kompetencave të tyre përkatëse, Palët Kontraktuese do të bashkëpunojnë për të rritur efikasitetin e politikave dhe masave për të luftuar furnizimin e paligjshëm dhe trafikimin e narkotikëve dhe substancave psikotrope dhe prekursorëve, si dhe për të zvogëluar abuzimin me narkotikë dhe substanca të tjera psikotrope.

Neni 16

Me synimin për ngritjen e kapaciteteve të sistemeve administrative dhe gjyqësore, si dhe forcimin e sundimit të ligjit dhe pavarësinë e gjyqësorit, Palët Kontraktuese mund të bashkëpunojnë në fushën e trajnimit të profesionistëve ligjor.

KAPITULLI VI

Bashkëpunimi në fusha të tjera

Neni 17

Palët Kontraktuese duhet të marrin masa që synojnë luftën kundër ndryshimeve klimatike dhe nxitjen e bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes së mjedisit, veçanërisht në menaxhimin e përbashkët të ujërave ndërkombëtare, mbrojtjen e biodiversitetit, mbrojtjen e ajrit, parandalimin e trafikimit të mbeturinave dhe përafrimit të legjislacionit me *acquis* me një pikëpamje për arritjen e kuadrit ligjor të unifikuar për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit.

Palët Kontraktuese do të nxisin bashkëpunimin ndërmjet njësive të qeverisjes vendore në fushën e funksionimit të qeverisjes vendore, përgatitjen e njësive të qeverisjes vendore për anëtarësim në Bashkimin Europian, aksesin dhe përdorimin e fondeve nga instrumentet financiare të Bashkimit Europian, promovimin e zhvillimit rajonal dhe bashkëpunimit territorial, bashkëpunimin ndërmjet



rajoneve planifikuese dhe ndërmjet institucioneve dhe organeve rajonale.

Palët Kontraktuese do të nxisin bashkëpunimin në fusha të tjera me interes të përbashkët sipas nevojës.

KAPITULLI VII

Mekanizmat institucionale dhe dispozitat e përgjithshme

Neni 18

Në këtë marrëveshje përcaktohen mekanizmat institucionalë si vijon:

Takimi i Ministrave të Punëve të Jashtme dhe të Integritetit Europian, në kuadër të dialogut politik, duke përfshirë zhvillimin e bashkëpunimit, adresimin e çështjeve që lidhen me pranimin e Palëve Kontraktuese të Bashkimit Europian, si dhe çështjet me interes për rajonin, politikën e jashtme dhe sigurinë e përbashkët të Bashkimit Europian.

Komiteti i përbashkët i përbërë nga përfaqësues të ministrave respektive, të Jashtme dhe Integritetit Europian, të cilët, në nivel operacional, do të shqyrtojnë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe do t'i bëjnë rregullimet e nevojshme për takimet e ministrave të jashtëm, së bashku me përfaqësues nga ministratë e tjera.

Grupi i punës i përbashkët për përmirësimin e bashkëpunimit në fusha të veçanta.

Neni 19

Palët Kontraktuese do të konsultohen dhe do të informojnë Bashkimin Europian mbi forcimin e bashkëpunimit të tyre.

Komisioni Europian mund të ftohet të marrë pjesë në mbledhjet e organizuara në bazë të kësaj Marrëveshjeje si vëzhgues.

KAPITULLI VIII

Dispozitat e fundit

Neni 20

Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë të pacaktuar kohe.

Secila nga Palët Kontraktuese mund të prishë këtë Marrëveshje, duke e informuar palën tjetër nëpërmjet kanaleve diplomatike të paktën gjashtë muaj përpara.

Neni 21

Çdo mosmarrëveshje që lind nga zbatimi dhe interpretimi i kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 22

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim, nëpërmjet kanaleve diplomatike, me anë të të cilit Palët Kontraktuese njoftojnë njëra-tjetrën mbi përmbushjen e kërkesave të përcaktuara nga legjislacioni i tyre kombëtar për hyrjen e saj në fuqi.

Neni 23

Kjo Marrëveshje nuk cenon të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga traktatet në fuqi për Palët Kontraktuese.

Nënshkruar në, më, në dy kopje origjinale, secila në gjuhët shqipe, malazeze dhe angleze, të gjitha tekstet janë njëloj autentike. Në rast mosmarrëveshjes në interpretim, do të mbizotërojë teksti në gjuhën angleze.

VENDIM

Nr. 431, datë 20.5.2015

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 718, DATË 29.10.2004, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, 25, pika 1, dhe 28, pika 1, të ligjit nr. 157/2013, datë 10.10.2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutës së Këshillit të Sigurimit (“Lista e OKB-së”), që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit”, të ndryshuar, të bëhet ndryshimi, si më poshtë vijon:



Në listën e shkronjës “C”, “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida”, çregjistrohen individët e renditur në shkronjën “a”, të listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, sipas ndryshimeve në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues për organizatën “Al-Qaida”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**AZHURNIMI NË LISTËN E PERSONAVE
TË SHPALLUR SI FINANCUES TË
TERRORIZMIT**

SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË
SIGURIMIT (“LISTA E OKB-së”)

C. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË
OSE BASHKËPUNËTORË ME ORGANI-
ZATËN AL-QAIDA

a) Lista e ndryshuar në “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida”;

1. RIADH; BEN BELKASSEM; BEN
MOHAMED; AL-JELASSI,

2. SAMIR; ABD EL LATIF; EL SAYED;
KISHK,

3. AL-AZHAR; BEN MOHAMMED; BEN
EL-ABED; AL-TLILI,

4. FAOUZI; BEN MOHAMED; BEN
AHMED; AL-JENDOUBI,

5. AHMED; HOSNI; RARRBO,

6. NAJIB; BEN MOHAMED; BEN
SALEM; AL-WAZ.

Shënim: Gjeneralitetet e tjera për personat emrat e të cilëve janë radhitur më sipër, mbahen në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

VENDIM

Nr. 432, datë 20.5.2015

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.
332, DATË 17.3.2010, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E
FORMËS, ELEMENTEVE PËRBËRËSE,
MËNYRËS SË MBAJTJES SË AFATIT TË
PËRDORIMIT TË DOKUMENTEVE
BAZË, QË MBAHEN DHE LËSHOHEN
NGA SHËRBIMI I GJENDJES CIVILE”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 25, pika 4, e 61, të ligjit nr. 10129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme dhe ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 332, datë 17.3.2010, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

a) Në pikën 1 dhe në lidhjen nr. 1, bashkëlidhur vendimit, shtohen modelet e mëposhtme, që i bashkëlidhen këtij vendimi:

“t) Mod. nr. 17, “Certifikatë lindjeje”, për përdorim nga autoritetet e huaja, që lëshojnë përfaqësitë diplomatike dhe konsullore;

th) Mod. nr. 17/1, “Certifikatë për lidhje martese”, për përdorim nga autoritetet e huaja, që lëshojnë përfaqësitë diplomatike dhe konsullore;

u) Mod. nr. 17/2, “Certifikatë martese”, për përdorim nga autoritetet e huaja, që lëshojnë përfaqësitë diplomatike dhe konsullore;

v) Mod. nr. 17/3, “Certifikatë vdekjeje”, për përdorim nga autoritetet e huaja, që lëshojnë përfaqësitë diplomatike dhe konsullore;

x) Mod. nr. 17/4, “Certifikatë familjare”, për përdorim nga autoritetet e huaja, që lëshojnë përfaqësitë diplomatike dhe konsullore.”.

b) Në pikën 2 dhe në lidhjen nr. 2, bashkëlidhur vendimit, shtohen 3 (tri) kodet për zyrat në përfaqësitë diplomatike dhe konsullore, respektivisht:

–kodi 501 për Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Romë;

–kodi 502 për Konsullatën e Përgjithshme në Milano;



- kodi 503 për Konsullatën e Përgjithshme në Bari.”.

c) Pas pikës 6 shtohen pikat 6/1, 6/2, 6/3 dhe 6/4, me këtë përmbajtje:

“6/1 Në ushtrim të veprimtarisë së tyre, zyrat e gjendjes civile në bashki dhe zyrat konsullore në përfaqësitë diplomatike, të cilat kryejnë veprime për pasqyrimin e akteve të mbajtura në shtetet e huaja, përsa u përket të dhënave të pasqyruara në to, për përbërësit e gjendjes civile (emrat, mbiemrat e përveçëm), zbatojnë rregullat e përcaktuara në këtë vendim.

6/2 Në përkthimin e dokumenteve të hartuara në shtetet e huaja që pranohen nga shërbimi i gjendjes civile, emrat dhe mbiemrat e personave nuk shqipërohen. Ato ruajnë formën grafike origjinale të emrit/mbiemrit, duke e riprodhuar atë shkronjë për shkronjë, përfshirë shenjat diakritike të alfabetit latin të gjuhës në të cilën është hartuar akti.

6/3 Në rastet kur akti është hartuar në një gjuhë me alfabet jolatin (cirilik, grek, arab etj.),

përkthyesit riprodhojnë shkronjë për shkronjë emrin dhe mbiemrin në alfabetin latin sipas sistemit ndërkombëtar të transliterimit.

6/4 Nëpunësit e zyrave të gjendjes civile në bashki dhe nëpunësit konsullorë bëjnë pasqyrimin e emrave/mbiemrave, sipas të njëjtit rregull gjatë regjistrimit të akteve të mbajtura jashtë shtetit.”.

2. Ngarkohen ministri i Punëve të Brendshme dhe ministri i Punëve të Jashtme për nxjerrjen e një udhëzimi që do të rregullojë veprimtarinë e lëshimit të certifikatave nga zyrat në përfaqësitë diplomatike dhe konsullore.

3. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



			
REPUBLIKA E SHQIPËRISË Republic of Albania République d'Albanie Republica de Albania Republik Albanien Repubblica d'Albania Δημοκρατία της Αλβανίας		267646 Zyra e Gjendjes Civile Ambasada Rome / Ambasciata dell' Albania, Roma Civil Registry Office Office de l'Etat Civil Servicio del Registro Civil Standesamtsbehörde Ufficio dello Stato Civile Ληξιαρχείο	
ÇERTIFIKATE LINDJE Birth Certificate - Certificat de Naissance - Certificado de Nacimiento - Geburtsurkunde Certificato di Nascita - Πιστοποιητικό Γέννησης			
Enuri - Name - Prénom - Nombre - Vorname - Nome - Ονομα		Monik	
Mbiennri - Surname - Nom - Apellido - Familienname - Cognome - Επώνυμο		SOJLI	
Numri personal - Personal number - Numéro personnel - Número personal - Personal number - Numero personale - Προσωπικός αριθμός		H85120230A	
Enuri i babait - Father's name - Prénom du père - Nombre del padre - Vorname des Vaters - Nome del padre - Ονομα Πατρός		Altin	
Enuri i nënës - Mother's name - Prénom de la mère - Nombre de la madre - Vorname der Mutter - Nome della madre - Ονομα μητρός		Ana	
Datëlindja - Date of birth - Date de naissance - Fecha de nacimiento - Geburtsdatum - Data di nascita - Ημερομηνία γέννησής		20-01-1978	
Vendlindja - Place of birth - Lieu de naissance - Lugar de nacimiento - Geburtsort - Luogo di nascita - Τόπος γέννησής		Durrës, Durrës, ALB	
Vendbanimi - Place of residence - Lieu de domicile - Domicilio - Wohnort - Luogo di domicilio - Τόπος κατοικίας		bbbb 0000/000/00 0000 Berat	
Gjinia - Sex - Sexe - Sexo - Geschlecht - Sesso - Φύλο		F	
Gjendja civile - Civil status - Etat civil - Estado civil - Familienstand - Stato civile - Οικογενειακή κατάσταση			
Beqar/e - Single - Célibataire - Soltero/a - Ledig - Celibe - Αγαμος/η		☐	
i/e Martuar - Married - Marié/e - Casado/a - Verheiratet - Coniugato/a - Έγγαμος/η		☒	
i/e Shkurorëzuar - Divorced - Divorcé/e - Divorciado/a - Geschieden - Divorziato/a - Διαζευγμένος/η		☐	
i/e Ve - Widower/Widow - Veuf/veuve - Viudo/a - Verwitwet - Vedovo/a - Χήρος/α		☐	
Shtetësia - Citizenship - Citoyenneté - Ciudadanía - Staatsangehörigkeit - Cittadinanza - Ιθαγένεια		ALB	
Mbiennri para martesë - Surname before marriage - Nom avant le mariage - Apellido antes del matrimonio - Geburtsname - Cognome prima del matrimonio - Επώνυμο πριν/ μετά το γάμο		Sojli	
Data e lëshimit - Date of issue - Date de délivrance - Fecha de expedición - Ausstellungsdatum - Data del rilascio - Ημερομηνία χορήγησης		07-04-2015	
Enuri, Mbiennri, Nënshkrimi i Nëpunësit të Gjendjes Civile, Vula Name, Surname, Signature and Seal of Keeper Prénom, Nom, Signature, Sceau de l'Officier de l'Etat Civil Nombre, Apellido, Firma y Sello del Oficial de Registro Civil Vorname, Familienname, Unterschrift und Dienstsiegel des Standesbeamten Nome, Cognome, Firma e Timbro del Pubblico Ufficiale dello Stato Civile Ονομα, Επώνυμο, Υπογραφή και Σφραγίδα του Υπαλλήλου του Ληξιαρχείου		Miranda Harizaj	




			
REPUBLIKA E SHQIPËRISE Republic of Albania République d'Albanie Republica de Albania Republik Albanien Repubblica d'Albania Δημοκρατία της Αλβανίας		267646 Zyra e Gjendjes Civile Ambasada Rome Civil Registry Office Office de l'Etat Civil Servicio del Registro Civil Standesamtsbehörde Ufficio dello Stato Civile Ληξιαρχείο	
CERTIFIKATË PER LIDHJE MARTESE Certificate of Capacity to Contract Marriage - Certificat de Capacité à Contracter Mariage - Acta de Matrimonio - Ehefähigkeitszeugnis - Certificato per Contrarre Matrimonio - Πιστοποιητικό για Σύναψη Γάμου			
Emri - Name - Prénom - Nombre - Vorname - Nome - Onoma		Artan	
Mbiemri - Surname - Nom - Apellido - Familienname - Cognome - Enënvopo		SOJLI	
Numri personal - Personal number - Numéro personnel - Número personal - Personal number - Numero personale - Προσωπικός αριθμός		H20915188H	
Datëlindja - Date of birth - Date de naissance - Fecha de nacimiento - Geburtsdatum - Data di nascita - Ημερομηνία γεννήσεως		15-09-1972	
Vendlindja - Place of birth - Lieu de naissance - Lugar de nacimiento - Geburtsort - Luogo di nascita - Τόπος γεννήσεως		Berat, Berat, ALB	
Vendbanimi - Place of domicile - Lieu de domicile - Domicilio - Wohnort - Luogo di domicilio - Τόπος κατοικίας		bbbb 0000/000/00 0000 Berat	
Gjinia - Sex - Sexe - Sexo - Geschlecht - Sesso - Φύλο		M	
Gjendja civile - Civil status - Etat civil - Estado civil - Zivilstand - Stato civile - Οικογενειακή κατάσταση			
Beqar/e - Single - Célibataire - Soltero/a - Ledig - Celibe/Nubile - Άγαμος/η		☐	
i/e Shkurorëzuar - Divorced - Divorcé/e - Divorciado/a - Geschieden - Divorziato/a - Διαζευγμένος/η		☒	
i/e Ve - Widower/Widow - Veuf/veuve - Viudo/a - Witwer/Witwe - Vedovo/a - Χήρος/α		☐	
Shtetësia - Citizenship - Citoyenneté - Ciudadanía - Staatsangehörigkeit - Cittadinanza - Υπηκοότητα		ALB	
Emri - Name - Prénom - Nombre - Vorname - Nome - Onoma		Monik	
Mbiemri - Surname - Nom - Apellido - Familienname - Cognome - Enënvopo		SOJLI	
Numri personal - Personal number - Numéro personnel - Número personal - Personal number - Numero personale - Προσωπικός αριθμός		H85120230A	
Datëlindja - Date of birth - Date de naissance - Fecha de nacimiento - Geburtsdatum - Data di nascita - Ημερομηνία γεννήσεως		20-01-1978	
Vendlindja - Place of birth - Lieu de naissance - Lugar de nacimiento - Geburtsort - Luogo di nascita - Τόπος γεννήσεως		Durrës, Durrës, ALB	
Vendbanimi - Place of domicile - Lieu de domicile - Domicilio - Wohnort - Luogo di domicilio - Τόπος κατοικίας		aaaaa 000/000/00 0000 Berat	
Gjinia - Sex - Sexe - Sexo - Geschlecht - Sesso - Φύλο		F	
Gjendja civile - Civil status - Etat civil - Estado civil - Zivilstand - Stato civile - Οικογενειακή κατάσταση			
Beqar/e - Single - Célibataire - Soltero/a - Ledig - Celibe/Nubile - Άγαμος/η		☒	
i/e Shkurorëzuar - Divorced - Divorcé/e - Divorciado/a - Geschieden - Divorziato/a - Διαζευγμένος/η		☐	
i/e Ve - Widower/Widow - Veuf/veuve - Viudo/a - Witwer/Witwe - Vedovo/a - Χήρος/α		☐	
Shtetësia - Citizenship - Citoyenneté - Ciudadanía - Staatsangehörigkeit - Cittadinanza - Υπηκοότητα		ALB	
Nuk ka pengesë ligjore për të lidhur martesë në: No legal impediments to contract marriage in - Il n'y a pas d'obstacle légal pour contracter mariage au - No existe impedimento legal para contraer matrimonio a - Keine Hindernisse für die Eheschließung in - Non ci sono impedimenti per contrarre matrimonio a - Δεν υπάρχουν νομικά κώλυμα για το γάμο στη Data e lëshimit - Date of issue - Date de délivrance - Fecha de expedición - Ausstellungsdatum - Data del rilascio - Ημερομηνία χορήγησης		Manëz 07-04-2015	
Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i Nëpunësit të Gjendjes Civile, Vula Name, Surname, Signature and Seal of Keeper Prénom, Nom, Signature, Sceau de l'Officier de l'Etat Civil Nombre, Apellido, Firma y Sello del Oficial de Registro Civil Vorname, Familienname, Unterschrift und Dienstsiegel des Standesbeamten Nome, Cognome, Firma e Timbro del Pubblico Ufficiale dello Stato Civile Ονομα, Επώνυμο, Υπογραφή και Σφραγίδα του Υπαλλήλου του Ληξιαρχείου		Miranda Harizaj	



			
REPUBLIKA E SHQIPËRIË Republic of Albania République d'Albanie Republica de Albania Republik Albanien Repubblica d'Albania Δημοκρατία της Αλβανίας		267646 Zyra e Gjendjes Civile <u>Ambasada Rome / Ambasciata dell' Albania, Roma</u> Civil Registry Office Office de l'Etat Civil Servicio del Registro Civil Standesamtsbehörde Ufficio dello Stato Civile Ληξιαρχείο	
CERTIFIKATE MARTESE Marriage Certificate - Certificat de Mariage - Certificado de Matrimonio - Heiratsurkunde Certificato di Matrimonio - Πιστοποιητικό Γάμου			
Emuri - Name - Prénom - Nombre - Vorname - Nome - Onoma	Artan	Monik	
Mbiemri - Surname - Nom - Apellido - Familienname - Cognome - Επώνυμο	SOJLI	SOJLI	
Numri personal - Personal number - Numéro personnel - Número personal - Personalnummer - Numero personale - Προσωπικός αριθμός	H20915188H	H85120230A	
Emuri i babait - Father's name - Prénom du père - Nombre del padre - Vorname des Vaters - Nome del padre - Όνομα Πατρός	Gilbert	Altin	
Emuri i nënës - Mother's name - Prénom de la mère - Nombre de la madre - Vorname der Mutter - Nome della madre - Όνομα μητρός	Anjola	Ana	
Datëlindja - Date of birth - Date de naissance - Fecha de nacimiento - Geburtsdatum - Data di nascita - Ημερομηνία γεννήσεως	15-09-1972	20-01-1978	
Vendlindja - Place of birth - Lieu de naissance - Lugar de nacimiento - Geburtsort - Luogo di nascita - Τόπος γεννήσεως	Berat, Berat, ALB	Durrës, Durrës, ALB	
Vendbanimi - Place of domicile - Lieu de domicile - Domicilio - Wohnort - Luogo di domicilio - Τόπος κατοικίας	bbbb 0000/000/00 0000 Berat	bbbb 0000/000/00 0000 Berat	
Gjinia - Sex - Sexe - Sexo - Geschlecht - Sesso - Φύλο	M	F	
Gjendja civile - Civil status - Etat civil - Estado civil - Zivilstand - Stato civile - Κατάσταση του πολίτη	☐ Beqar/e - Single - Célibataire - Soltero/a - Ledig - Celibe/Nubile - Άγαμος/η ☒ i/e Martuar - Married - Marié/e - Casado/a - Verheiratet - Coniugato/a - Έγγαμος/η ☐ i/e Shkurrezuar - Divorced - Divorcé/e - Divorciado/a - Geschieden - Divorziato/a - Διαζευγμένος/η ☐ i/e Ve - Widower/Widow - Veuf/veuve - Viudo/a - Witwer/Witwe - Vedovo/a - Χήρος/α		
Shtetësia - Citizenship - Citoyenneté - Ciudadanía - Staatsangehörigkeit - Cittadinanza - Υπηκοότητα	ALB	ALB	
Nr., data e aktit të martesës - No., date of marriage act - No., date de l'acte de mariage - No., fecha de registro del acta del matrimonio - Nr., Datum der Eheschließungsurkunde - No., data dell'atto di matrimonio - Αριθ., ημερομηνία ληξιαρχικής πράξης γάμου	No. 1 Date 31-03-2015		
Vendi i lidhjes së martesës - Place of marriage - Lieu du mariage - Lugar donde ocurrió el matrimonio - Ort der Eheschließung - Luogo del matrimonio - Τόπος γάμου	Manëz		
Mbiemri para martese - Surname before marriage - Nom avant mariage - Apellido antes del matrimonio - Geburtsname - Cognome prima matrimonio - Επώνυμο πριν το γάμο	Sojli	Sojli	
Data e lëshimit - Date of issue - Date de délivrance - Fecha de expedición - Ausstellungsdatum - Data del rilascio - Ημερομηνία χορήγησης	07-04-2015		
Emuri, Mbiemri, Nënshkrimi i Nëpunësit të Gjendjes Civile, Vula Name, Surname, Signature and Seal of Keeper Prénom, Nom, Signature, Sceau de l'Officier de l'Etat Civil Nombre, Apellido, Firma y Sello del Oficial de Registro Civil Vorname, Familienname, Unterschrift und Dienstsiegel des Standesbeamten Nome, Cognome, Firma e Timbro del Pubblico Ufficiale dello Stato Civile Όνομα, Επώνυμο, Υπογραφή και Σφραγίδα του Υπαλλήλου του Ληξιαρχείου			
			



			
REPUBLIKA E SHQIPËRISE Republic of Albania République d'Albanie Republica de Albania Republik Albanien Repubblica d'Albania Δημοκρατία της Αλβανίας		267646 Zyra e Gjendjes Civile Ambasada Rome / Ambasciata dell' Albania, Roma Civil Registry Office Office de l'Etat Civil Servicio del Registro Civil Standesamtsbehörde Ufficio dello Stato Civile Αρχιπαρχειο	
ÇERTIFIKATE VDEKJE Death Certificate - Certificat de Décès - Certificado de Defunción - Sterbeurkunde Certificato della Morte - Πιστοποιητικό Θανάτου			
Enuri - Name - Prénom - Nombre - Vorname - Nome - Ονομα		Monika	
Mbiemri - Surname - Nom - Apellido - Familienname - Cognome - Επώνυμο		SOJLI	
Numri personal - Personal number - Numéro personnel - Número personal - Personal number - Numero personale - Προσωπικός αριθμός		L55330001J	
Enuri i babait - Father's name - Prénom du père - Nombre del padre - Vorname des Vaters - Nome del padre - Ονομα Πατρός		Alban	
Enuri i nënës - Mother's name - Prénom de la mère - Nombre de la madre - Vorname der Mutter - Nome della madre - Ονομα μητρός		Ernira	
Datëlindja - Date of birth - Date de naissance - Fecha de nacimiento - Geburtsdatum - Data di nascita - Ημερομηνία γεννήσεως		30-03-1986	
Vendlindja - Place of birth - Lieu de naissance - Lugar de nacimiento - Geburtsort - Luogo di nascita - Τόπος γεννήσεως		Tiranë, Tiranë, ALB	
Vendbanimi - Place of residence - Lieu de domicile - Domicilio - Wohnort - Luogo di domicilio - Τόπος κατοικίας		Ali Demi 000/000/000 0000 Njesia bashkiake nr. 1	
Gjinia - Sex - Sexe - Geschlecht - Sesso - Φύλο		F	
Gjendja civile - Civil status - Etat civil - Estado civil - Familienstand - Stato civile - Οικογενειακή κατάσταση		☒ x ☐ ☐ ☐	
Beqar/e - Single - Célibataire - Soltero/a - Ledig - Celibe - Αγαμος/η			
i/e Martuar - Married - Marié/e - Casado/a - Verheiratet - Coniugato/a - Εγγαμος/η			
i/e Shkurorëzuar - Divorced - Divorcé/e - Divorciado/a - Geschieden - Divorziato/a - Διαζευγμένος/η			
i/e Ve - Widower/Widow - Veuf/veuve - Viudo/a - Verwitwet - Vedovo/a - Χήρος/α			
Shtetësia - Citizenship - Citoyenneté - Ciudadanía - Staatsangehörigkeit - Cittadinanza - Ιθαγένεια		ALB	
Data e vdekjes - Date of death - Date du Décès - Fecha de la muerte - Zeitpunkt des Todes Data della morte - Ημερομηνία θανάτου		07-04-2015	
Data e lëshimit - Date of issue - Date de délivrance - Fecha de expedición - Ausstellungsdatum - Data del rilascio - Ημερομηνία χορήγησης		07-04-2015	
Enuri, Mbiemri, Nënshkrimi i Nëpunësit të Gjendjes Civile, Vula Name, Surname, Signature and Seal of Keeper Prénom, Nom, Signature et Cachet de l'Officier d'état civil Nombre, Apellido, Firma y Sello del Oficial de Registro Civil Vorname, Familienname, Unterschrift des Standesbeamten, Dienstsiegel Nome, Cognome, Firma e Timbro del Pubblico Ufficiale dello Stato Civile Ονομα, Επώνυμο, Υπογραφή και Σφραγίδα του Υπαλλήλου του Αρχιπαρχειού		Miranda Harizaj	



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
Republic of Albania
République d'Albanie
Republika e Albanië
Republik Albanien
Repubblica d'Albania
Δημοκρατία της Αλβανίας

000942201

Tirane 501, më 07.04.2015

Zyra e Gjendjes Civile Ambasada Rome / Ambasciata dell' Albania, Roma
Civil Registry Office
Office de l'Etat Civil
Servicio del Registro Civil
Standesamtsbehörde
Ufficio dello Stato Civile
Ληξιαρχείο

CERTIFIKATË FAMILJARE
FAMILY CERTIFICATE / FICHE FAMILIALE D'ÉTAT CIVIL / CERTIFICADO DE FAMILIA /
AUSZUG AUS DEM FAMILIENBUCH / CERTIFICATO DI STATO DI FAMIGLIA /
ΠΙΣΤΟΠΟΙΗΤΙΚΟ ΟΙΚΟΓΕΝΕΙΑΚΗΣ ΚΑΤΑΣΤΑΣΗΣ

Në bazë të Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010, vërtetohen të dhënat e mëposhtme / Based upon the National Civil Registry of 2010, the following information is hereby certified / Sur la base du Registre national de l'état civil 2010, sont certifiées les données suivantes / En la base de la Registraduría Nacional del Estado Civil 2010, está certificada la siguiente información / Gemäß dem Nationalen Standesamtsregister vom Jahr 2010 werden folgende Angaben zertifiziert / In base al registro nazionale dello Stato Civile 2010, si certificano i seguenti dati / Έξοφεί του Εθνικού Μητρώου του Ληξιαρχείου 2010, πιστοποιούνται τα ακόλουθα δεδομένα:

1. Name - Surname : Prénom - Nom; Nombre - Apellido; Vorname - Familienname; Nome - Cognome; Όνομα - Επώνυμο.
2. Father's name - Prénom du père - Nombre del padre - Vorname des Vaters - Nome del padre - Όνομα Πατρός
3. Mother's name - Prénom de la mère - Nombre de la madre - Vorname der Mutter - Nome della madre - Όνομα μητρός
4. Sex - Sexe - Sexo - Geschlecht - Sesso - Φύλο
5. Lidhja me kryefamiljarin / Relation to the head of the household / Relation avec le chef de famille / Los lazos familiares / Bezug zum Familienoberhaupt / Relazione con il capofamiglia / Σχέση με τον οικογενειάρχη
6. Date of birth - Date de naissance - Fecha de nacimiento - Geburtsdatum - Data di nascita - Ημερομηνία γεννήσεως
7. Civil status - Etat civil - Estado civil - Familienstand - Stato civile - Οικογενειακή κατάσταση
8. Place of birth - Lieu de naissance - Lugar de nacimiento - Geburtsort - Luogo di nascita - Τόπος γεννήσεως
9. Citizenship - Citoyenneté - Ciudadanía - Staatsangehörigkeit - Cittadinanza - Ιθαγένεια
10. Personal number - Numéro personnel - Número personal - Personalnummer - Numero personale - Προσωπικός αριθμός

Page 1 nga 2

REPUBLIKA E SHQIPËRISE
Republic of Albania
République d'Albanie
Republika e Albanië
Republik Albanien
Repubblica d'Albania
Δημοκρατία της Αλβανίας

000942201

Nr.	1 Emri e mbiemri	2 Emri i babait	3 Emri i nënës	4 Gjinia	5 Lidhja me K. Familjarin	6 Datëlindja			7 Gjendja Civile	8 Vendlindja	9 Shtetësia	10 Numri personal
						Dita	Muaji	Viti				
1.	Monik SOJLI	Altin	Ana	F	I panj.	20	01	1978	I/e martuar	Durrës, Durrës, ALB	Shqipëri	H85120230A
2.												
3.												
4.												
5.												
6.												
7.												
8.												
9.												
10.												
11.												
12.												
13.												
14.												
15.												

Kjo certifikatë lëshohet për përdorim jashtë vendit / This certificate is issued to be used in a foreign country / La présente Fiche familiale est délivrée afin d'être utilisée à l'étranger / El presente certificado se expide para uso en el extranjero / Diese Urkunde ist im Ausland gültig / Il presente certificato viene rilasciato per uso all'estero / Το πιστοποιητικό αυτό εκδίδεται για χρήση στο εξωτερικό.

Emri, Mbiemri, Nenshkrimi i Nënësitet të Gjendjes Civile, Vula
Name, Surname, Signature Superintendent registrar
Prénom, Nom, Signature et Cachet de l'Officier d'état civil
Nombre, Apellido, Firma y Sello del Oficial de Registro Civil
Vorname, Familienname, Unterschrift und Dienstsiegel des Standesbeamten
Nome, Cognome, Firma e Timbro del Pubblico Ufficiale dello Stato Civile
Όνομα, Επώνυμο, Υπογραφή και Σφραγίδα του Υπαλλήλου του Ληξιαρχείου

Miranda Harizaj

Page 2 nga 2

**VENDIM****Nr. 433, datë 20.5.2015****PËR SIGURIMIN E JETËS SË
USHTARAKËVE TË FORCAVE TË
ARMATOSURA, QË DËRGOHEN NË
MISIONE USHTARAKE JASHTË
VENDIT, PËR VITIN 2015**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 5, të nenit 6, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “c”, të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministria e Mbrojtjes, në bashkëpunim me shoqërinë e sigurimeve “INSIG”, sh.a., të bëjë sigurimin e jetës së ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, që dërgohen në misione ushtarake jashtë vendit, për vitin 2015.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2015, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.

3. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe shoqëria e sigurimeve “INSIG”, sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

VENDIM**Nr. 434, datë 20.5.2015****PËR PËRCAKTIMIN E NORMATIVAVE
PËR FIROT, HUMBJET, DËMTIMET
DHE SKARCOT GJATË PRODHIMIT,
MAGAZINIMIT, TRANSPORTIMIT ETJ.,
TË NJOHURA PËR QËLLIME FISKALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “m”, të pikës 1, të nenit 21, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Firot, humbjet, dëmtimet dhe skarcot gjatë procesit të prodhimit, magazinimit apo transportimit, për produktet që janë subjekt i akcizës, përcaktohen sipas vendimit nr. 612, datë 5.9.2012 të Këshillit të Ministrave “Për dispozitat zbatuese të ligjit “Për akcizat”, të ndryshuar”.

2. Për industrinë prodhuese, që përdorin lëndë djegëse në procesin e prodhimit, normativat e lëndëve të para djegëse përcaktohen sipas vendimit nr. 612, datë 5.9.2012 të Këshillit të Ministrave “Për dispozitat zbatuese të ligjit “Për akcizat”, të ndryshuar”.

3. Për duhanin, firot dhe humbjet në procesin e përpunim-manipulimit përllëgariten sipas përcaktimeve të bëra në vendimin nr. 687, datë 18.6.2009 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e nivelit të firove të lejuara gjatë procesit të përpunim-manipulimit të duhanit”.

4. Për humbjet dhe firot në procesin e prodhimit, për të cilat nuk ka akte të veçanta ligjore dhe nënligjore, sasia dhe vlera e lejuar e tyre do të llogariten duke u bazuar në kartat apo skemat teknologjike të procesit të prodhimit. Autoritetet tatimore, gjatë kontrollit të ushtruar në vend pranë tatimpaguesit, analizojnë kartat apo skemat teknologjike të procesit të prodhimit, që shoqërojnë makineritë apo linjat përkatëse nga prodhuesi i tyre dhe kryejnë verifikimet lidhur me nivelin e humbjeve të pësuar gjatë procesit të prodhimit/përpunimit. Për matjen e nivelit të humbjeve gjatë prodhimit, inspektorët tatimorë mbajnë procesverbalin përkatës, të firmosur edhe nga drejtuesi teknik apo administratori, të cilin ia bashkëlidhin aktit të kontrollit.

5. Nëse karta teknologjike përcakton norma të amortizimit të makinerive, në varësi të përmbushjes së orëve të punës, atëherë tatimpaguesi, me përmbushjen e këtyre orëve, si pasojë e konsumit apo amortizimit të linjës së prodhimit, duhet të paraqesë një kërkesë për ndryshim të normave të lejuara të humbjeve në prodhim. Kërkesa paraqitet pranë institucioneve përgjegjëse për konfirmimin e kartave teknologjike.

6. Nuk do të njihen firo për transportim apo magazinim, me përjashtim të rasteve të produkteve të akcizës të përcaktuara në vendimin nr. 612, datë 5.9.2012 të Këshillit të Ministrave



“Për dispozitat zbatuese të ligjit “Për akcizat”, të ndryshuar”.

Për energjinë elektrike, humbje gjatë shpërndarjes së energjisë elektrike do të konsiderohet përqindja e humbjeve të energjisë elektrike e përcaktuar në vendimin nr. 171, datë 25.2.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e planit të rimëkëmbjes financiare të sektorit të energjisë elektrike”.

7. Brenda 45 ditëve, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, çdo tatimpagues duhet të paraqesë në Drejtorinë Rajonale Tatimore dokumentacionin për miratimin e firove, ku të përfshihen:

a) karta teknologjike;

b) përshkrimi i detajuar i procesit të prodhimit;

c) planimetria e objektit;

ç) normativat e konsumit të lëndës së parë dhe të orëve të punës për njësi produkti të gatshëm (karta teknologjike), shoqëruar edhe me të dhënat për:

- llojin e lëndës së parë, të përdorur në procesin e prodhimit;

-fazat, në procesin teknologjik, ku përdoret lënda e parë.

Karta teknologjike, duhet të jetë e konfirmuar /certifikuar nga një institucioni njohur, që ka aftësinë teknike të konfirmimit të kartave teknologjike, si: Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN), Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU), Instituti i Materialeve të Ndërtimit, Drejtoria e Përgjithshme e Standardeve, Drejtoria e Patentave dhe Markave, Inspektorati Shtetëror, përgjegjës dhe Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, institucione që miratojnë karta të ndryshme teknologjike apo çdo institucion tjetër që ka aftësitë dhe lidhet me proceset teknologjike përkatëse.

8. Firot e miratuara nga drejtoritë rajonale tatimore (DRT), në përputhje me këtë vendim, do të njihen për efekte fiskale për periudha jo më të hershme se data e miratimit zyrtar në DRT, sipas pikës 7, më lart.

9. Ngarkohen drejtoritë rajonale tatimore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 435, datë 20.5.2015

**PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PËR
LIDHJEN E KONTRATËS SË QIRASË
ME TARIFËN 1 EURO/KONTRATA,
NDËRMJET MINISTRISË SË
ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT,
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES, SI
QIRADHËNËS, DHE SHOQËRISË
“MITO BY CATERINA FIRENZE”,
SHPK, SI QIRAMARRËS, PËR PASURINË
“ISH-REPARTI I NGJYROSJES NË ISH-
KOMBINATIN E TEKSTILEVE, BERAT”
NË “BERATEKS”, SH.A., BERAT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të vendimit nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfitëozë apo kontratave të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave


VENDOSI:

1. Dhënie e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, si qiradhënëse, dhe shoqërisë “MITO by CATERINA Firenze”, sh.p.k., si qiramarrës, për pasurinë “Ish-reparti i ngjyrosjes në ish-Kombinatit e Tekstileve, Berat”, në “Berateks”, sh.a., Berat, me sipërfaqe të përgjithshme 9 151 (nëntë mijë e njëqind e pesëdhjetë e një) m², nga e cila sipërfaqe ndërtimore, sipas genplanit, përkatësisht, në katin e parë 5884 (pesë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e katër) m², në katin përderes 2500 (dymijë e pesëqind) m² dhe sipërfaqe funksionale 767 (shtatëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) m².

2. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



VENDIM
Nr. 437, datë 20.5.2015

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË
PËRGJITHSHME TË BURGJEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 76, të ligjit nr. 8328, datë 16.4.1998, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të të paraburgosurve", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore së përgjithshme të burgjeve, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Vendimi nr. 303, datë 25.3.2009, i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullore së përgjithshme të burgjeve", të ndryshuar, shfuqizohet.

3. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**RREGULLORE E PËRGJITHSHME E
BURGJEVE**

KREU I
RREGULLA TE PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Kjo rregullore garanton respektimin e të drejtave dhe përmbushjen e detyrimeve të të paraburgosurve dhe të të dënuarve, rehabilitimin, organizimin e jetës së tyre, mënyrën dhe kushtet e funksionimit të regjimit të brendshëm, mënyrën dhe kushtet e ekzekutimit të vendimeve penale me burgim, zhvillimin e aktivitetit të punës dhe shpërblimin për punën e kryer, rehabilitimin dhe riintegrimin, organizimin e shërbimit shëndetësor, si dhe çështje të tjera që lidhen me funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe të institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale në përputhje me legjislacionin në fuqi.



Neni 2

Parime të përgjithshme

1. Të paraburgosurit dhe të dënuarit trajtohen me dinjitet dhe duke respektuar të drejtat njerëzore të tyre.

2. Të paraburgosurit dhe të dënuarit trajtohen pa njëanshmëri dhe pa diskriminim mbi bazë gjinie, race, ngjyre, përkatësie etnike, gjuhe, feje, bindjeje politike, fetare ose filozofike, orientimi seksual, identiteti gjinor, gjendjeje ekonomike, arsimore ose shoqërore, përkatësie prindërore, moshe, gjendjeje familjare ose martesore, gjendjeje shëndetësore, aftësie të kufizuar, shtetësie ose përkatësie në një grup të caktuar ose për çdo shkak tjetër që përbën diskriminim.

3. Të miturit e paraburgosur dhe të dënuar trajtohen duke respektuar liritë dhe të drejtat themelore të tyre. Trajtimi mbështetet në interesin më të lartë të fëmijës, të integritetit shoqëror, edukimit dhe parandalimit të rifutjes në krim.

4. Gratë e paraburgosura dhe të dënuara trajtohen duke respektuar liritë dhe të drejtat themelore dhe pa diskriminim, duke parandaluar çdo akt dhune me bazë gjinore që sjell dëmim fizik, seksual ose psikologjik, vuajtje ose çdo formë tjetër abuzimi e keqtrajtimi që dënohet sipas legjislacionit në fuqi.

5. Të paraburgosurve dhe të dënuarve me çrregullime të shëndetit mendor u garantohej trajtim i barabartë, jodiskriminues, duke respektuar integritetin fizik dhe dinjitetin njerëzor. Trajtimi i tyre bëhet sipas standardeve shëndetësore, që zbatohen edhe për kategoritë e tjera të personave me çrregullime të shëndetit mendor.

6. Të paraburgosurve dhe të dënuarve me aftësi të kufizuara u garantohej liritë dhe të drejtat themelore të njeriut, trajtimi jodiskriminues i ndonjë lloji, për shkak të aftësisë së kufizuar, duke plotësuar nevojat specifike për aftësimin dhe riaftësimin e tyre.

7. Të paraburgosurit dhe të dënuarit e huaj ose pa shtetësi trajtohen duke mbajtur parasysh situatën e tyre të veçantë dhe nevojat individuale. Autoritetet e institucionit ndërmarrin veprime pozitive për të shmangur diskriminimin dhe për të zgjidhur probleme specifike, me të cilat këta persona përballen në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, gjatë transferimit dhe pas lirimit.

8. Të paraburgosurve dhe të dënuarve u

respektohen të drejtat e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë.

9. “Vlerësimi i riskut” duhet të mbështetet në parimet e vlerësimit të nevojës dhe proporcionalitetit të riskut dhe parimin e reagimit specifik.

10. Masat e veçanta, që janë të nevojshme të zbatohen për respektimin e lirive dhe të drejtave të grupeve të veçanta të të paraburgosurve dhe të të dënuarve nuk konsiderohen diskriminim, sipas kësaj rregulloreje.

Neni 3

Përkufizime

Në kuptim të kësaj rregulloreje, me termat e mëposhtëm do të kuptohet:

1. “IEVP”, institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, ku përfshihen paraburgimet dhe institucionet e ekzekutimit të dënimit me burgim.

2. “Regjim i hapur”, institucionet ku kryejnë dënimin personat e dënuar me gjysmëliri, të dënuarit të cilët pas vlerësimit të analizës së riskut nga një bord janë të përshtatshëm për t’u vendosur në këto regjime.

3. “I paraburgosur”, çdo person, shtetas shqiptar, i huaj apo pa shtetësi, ndaj të cilit është marrë masë sigurimi “arrest në burg”.

4. “I dënuar”, çdo person, shtetas shqiptar, i huaj apo pa shtetësi, i dënuar me burgim me vendim të formës së prerë të gjykatave shqiptare dhe në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare edhe të gjykatave të huaja, duke respektuar kërkesat përkatëse procedurale.

5. “Personel”, çdo punonjës i administratës në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe në IEVP.

6. “Të dhënat personale”, çdo informacion për të burgosurit, vendas ose të huaj, si dhe për personelin, të cilët janë të identifikuar ose të identifikueshëm. Elementet, me të cilat realizohet identifikimi i një personi, drejtpërdrejt apo tërthorazi, janë numrat e identitetit ose faktorë të tjerë të veçantë fizikë, psikologjikë, ekonomikë, socialë apo kulturorë.

7. “Të dhënat sensitive”, çdo informacion për të burgosurit dhe personelin, që ka të bëjë me origjinën e tij racore ose etnike, mendimet politike, anëtarësimin në sindikata, besimin fetar apo filozofik, dënimin penal, si dhe të dhëna për shëndetin dhe jetën seksuale.

8. “Kontrollues”, Drejtoria e Përgjithshme e



Burgjeve, si dhe të gjitha institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, të cilat, vetëm ose në bashkëpunim me të tjera, mbajnë, përpunojnë, administrojnë, arkivojnë dhe për këtë shkak kontrollojnë të dhënat personale.

9. “I mitur i privuar nga liria”, personi nën 18 vjeç për të cilin është marrë një vendim gjyqësor, që parashikon shprehimisht privimin e lirisë në një IEVP.

10. “Dhunë ndaj të miturve”, përdorimi i qëllimshëm i forcës fizike ose i formave të tjera të forcës, qoftë me kërcënim ose aktuale, kundër të miturit a grupit të të miturve, e cila rezulton apo ka shumë të ngjarë që të rezultojë në dëmtim, vdekje, dëmtim psikologjik, keqzhvillim ose privim.

11. “Dhunë psikologjike” përfshin veprimet që shkaktojnë dëmtime të shëndetit fizik, mendor, moral dhe social të fëmijës dhe që, ndër të tjera, kanë sjellë ose rrezikojnë të sjellin si pasojë kufizimin e lirisë së lëvizjes, sjellje degraduese, kërcënuese, frikësuese, diskriminuese, përqeshëse ose forma të tjera të trajtimit armiqësor apo refuzues nga prindërit, motra, vëllai, gjyshi, gjyshja, përfaqësuesi ligjor, një i afërm i familjes ose çdo person tjetër që e ka për detyrë të kujdeset për fëmijën.

12. “Dhunë fizike”, çdo tentativë ose çdo dëmtim fizik apo plagosje e fëmijës, përfshirë edhe ndëshkimin trupor të tij, të cilat nuk janë aksidentale. Në dhunë fizike përfshihen forma të tilla, si: rrahja, tortura, shkundja/shtytja me forcë, djegia, goditja (shuplakë ose shkelm), pickimi, çjerrja, kafshimi, qortimi i rreptë, detyrimi me forcë për të kryer një veprim, përdorimi i lëndëve që shkaktojnë dhimbje ose shqetësim.

13. “Trajtim ose vlerësim multidisiplinor”, trajtimi ose vlerësimi i koordinuar ligjor, social, psikologjik, shëndetësor, arsimor dhe kulturor i gjendjes të të miturit.

14. “Prind”, personi/personat që e kanë lindur ose e kanë birësuar të miturin të dy së bashku ose një i vetëm, të martuar ose të pamartuar apo që kanë njohur amësinë ose atësinë e të miturit të lindur jashtë martese.

15. “Përfaqësues ligjor”, kujdestari ose familja kujdestare, personi apo institucioni, i cili, brenda tagreve që i janë dhënë nga ligji ose nga gjykata, mbron interesat e të miturit nëpërmjet kryerjes apo jo të veprimeve juridike, në emër ose për llogari të të miturit.

16. “Risku”, një rrezik që kërcënon jetën dhe/ose është traumatizues dhe rekuperimi fizik ose psikologjik pritet të jetë i vështirë ose i pamundur.

17. “Vlerësimi i riskut”, vlerësimi i nevojave personale dhe identifikimi i tipareve që lidhen me veprën/veprat penale dhe sjelljen e dëmshme (nevojat kriminogjenike), si dhe nevojave që lidhen gjithmonë me menaxhimin e rrezikut.

18. “Personat me aftësi të kufizuar”, individët që kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose ndijore, dëmtime të cilat, në bashkëveprim me pengesat e ndryshme, përfshirë ato mjedisore dhe të qëndrimit, mund të pengojnë pjesëmarrjen e plotë dhe efikase të këtyre personave në shoqëri, në kushte të barabarta me të tjerët.

19. “Prindërimi në distancë”, një program që zhvillohet nga IEVP-ja, i cili synon forcimin e marrëdhënieve me familjen prind-fëmijë.

20. “TVSHB”, institucioni i veçantë i shërbimit të të burgosurve.

KREU II

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I IEVP-SË

Neni 4

Organizimi dhe funksionimi i IEVP-së

IEVP-të janë në përbërje të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, të cilat garantojnë masat e sigurisë, realizojnë trajtimin e të paraburgosurve dhe të të dënuarve, zbatimin e programeve të rehabilitimit dhe rintegritimit, zbatimin e politikave shëndetësore, si dhe detyrimet e tjera që rrjedhin nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 5

Drejtori i IEVP

1. Drejtori i IEVP-së është përgjegjës për organizimin, funksionimin dhe kontrollin e veprimtarisë në institucion dhe për respektimin e të drejtave të njeriut, trajtimin e paanshëm të të paraburgosurve dhe të të dënuarve në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, si dhe me rregulloren e brendshme të IEVP-së.

2. Veprimtaria e IEVP-së drejtohet dhe kontrollohet nga drejtori i tij, i cili është përfaqësues ligjor i institucionit me të tretët.



3. Drejtuesit e IEVP-ve informojnë në mënyrë të vazhdueshme drejtorin e Përgjithshëm të Burgjeve lidhur me menaxhimin e veprimtarisë së institucionit.

4. Drejtori i IEVP-së emërohet, lirohet dhe shkarkohet nga ministri i Drejtësisë, në përputhje me legjislacionin përkatës.

5. Drejtori i IEVP-së, në rast mungese, zëvendësohet nga një person i deleguar nga drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve.

Neni 6

Aktiviteti në IEVP

1. Garantimi i masave të sigurisë dhe zbatimi i aktivitetit në IEVP bëhet në përputhje me rregulloren e brendshme të çdo IEVP-je, si dhe me programe të tjera të miratuara nga drejtori i Përgjithshëm apo drejtori i IEVP-së.

2. Personeli, në përputhje me përshkrimet e punës, bën të mundur zbatimin e detyrimeve në përputhje me pikën 1.

3. Drejtori i IEVP-së monitoron zbatimin e aktivitetit ditor nga personeli përgjegjës sipas shërbimeve.

Neni 7

Regjistrat dhe dosjet në IEVP

Në IEVP hapen dhe mbahen këto regjistra dhe dosje:

- a) Regjistri themeltar i të dënuarve;
- b) Regjistri themeltar i të paraburgosurve;
- c) Dosja personale e të burgosurit;
- ç) Dosja psiko-sociale;
- d) Dosja shëndetësore;
- dh) Regjistri i kërkesë-ankesave;
- e) Regjistri i masave disiplinore;
- ë) Regjistri i lirimeve para kohe me kusht;
- f) Regjistri i lejeve të të burgosurve;
- g) Regjistri i ngjarjeve të rënda;
- gj) Regjistri i uljeve të dënimit;
- h) Regjistri i vizitave mjekësore;
- i) Regjistri i aktivitetit 24-orësh;
- j) Regjistri i punësimit;
- k) Regjistri i komisionit të pritjes;
- l) Regjistri i dokumentimit të rasteve të ushtrimit të dhunës;
- ll) Regjistri i kontrollit të ushqimit;
- m) Regjistri i indeksit alfabetik.

KREU III

PRANIMI DHE REGJISTRIMI I TË PARABURGOSURVE DHE TË TË DËNUARVE

Neni 8

Kushtet e pranimit të të paraburgosurve

1. Në çdo rast, të paraburgosurit mbahen në seksione të veçuara nga seksioni i të dënuarve.

2. Pranimi i të paraburgosurve në IEVP bëhet çdo ditë, pasi të jetë vendosur nga gjykata masa e sigurimit “arrest në burg”.

3. Pranimi bëhet mbi bazën e dokumentacionit, i cili duhet të përmbajë detyrimsht këto dokumente:

- a) Vendimin e gjykatës për caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”;
- b) Procesverbalin e ndalimit ose të arrestimit në flagrancë;
- c) Procesverbalin e kontrollit personal;
- ç) Formularin e identifikimit me dy foto dhe gjurmët e gishtërinjve;
- d) Dokumentin e identifikimit;
- dh) Dokumentin e kontrollit mjekësor;
- e) Certifikatën personale;
- ë) Për të paraburgosurat femra, eko nga mjeku gjinekolog.

4. Në rastet kur mungojnë dokumentet e parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh” dhe “e”, të këtij neni, IEVP-ja nuk e pranon të paraburgosurin. IEVP-ja duhet të marrë masat për plotësimin e dosjes personale për të paraburgosurën me dokumentin e parashikuar në shkronjën “f” brenda një afati prej 15 ditësh nga data e pranimit të saj.

Neni 9

Vlerësimi i riskut

1. Pas pranimit për çdo të paraburgosur apo të dënuar bëhet vlerësimi i riskut, i cili mbështetet në vlerësimin e nevojave personale dhe kriminogjene të të dënuarit/paraburgosurit.

2. Vlerësimi i riskut përfshin: analizën e riskut, vlerësimin e faktorëve të riskut dhe mundësisë për recidivizëm (historia kriminale, identifikimi i çështjes/eve penale, faktorët e inkriminimit) dhe identifikimin e riskut.

3. Për vlerësimin e riskut merren në konsideratë edhe konfliktet e mundshme me bashkëvuajtësit e tjerë, si dhe nevojat e tjera që lidhen gjithmonë me menaxhimin e riskut.



4. Mbështetur në rezultatet e vlerësimit të riskut, për çdo të dënuar/të paraburgosur hartohet strategjia dhe planëzimi i menaxhimit të riskut dhe ndërhyrjes.

Neni 10

Kushtet e pranimit të të dënuarve

1. Pranimi i të dënuarve në IEVP bëhet me urdhrin e drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, pasi të jetë lëshuar urdhri i ekzekutimit për vendimin e gjykatës.

2. Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve nxjerr urdhrin e pranimit brenda një afati prej 3 ditësh, nga dita e ardhjes së urdhrin të ekzekutimit për vendimin e gjykatës.

3. I dënuari duhet të jetë i shoqëruar me dosjen e tij personale, e cila përmban:

a) vendimin e formës së prerë të gjykatës që cakton dënimin me burgim;

b) urdhrin e prokurorit për ekzekutimin e këtij vendimi;

c) vendimin e arrestit;

ç) procesverbalin e ndalimit;

d) procesverbalin e kontrollit personal;

dh) formularin e identifikimit me dy foto dhe gjurmët e gishtërinjve;

e) kartelën personale të të dënuarit;

ë) kartelën e gjendjes shëndetësore;

f) dosjen psiko-sociale (për transferimet nga një IEVP në një IEVP tjetër).

4. Kur mungon urdhri i drejtorit të Përgjithshëm dhe dokumentet e parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç”, “d” dhe “dh”, të këtij neni, IEVP-ja nuk e pranon të dënuarin. Në rast se mungojnë dokumentet e kërkuara në shkronjat e tjera të këtij neni, i dënuari mund të pranohet në IEVP. Institucioni duhet të marrë masat për plotësimin e dosjes personale të të dënuarit me dokumentet që mungojnë brenda një afati prej 15 ditësh nga data e pranimit të tij.

Neni 11

Regjistrimi i të paraburgosurit apo të dënuarit

1. Me paraqitjen e të paraburgosurit apo të dënuarit në IEVP, punonjësit përkatës verifikojnë identitetin dhe saktësinë e dokumentacionit të tij.

2. Kur identiteti dhe dokumentacioni është i rregullt, hartohet procesverbali i pranimit të të paraburgosurit apo të dënuarit, dokumenteve shoqëruese dhe sendeve të tij personale. Në

procesverbal shënohen data dhe ora e pranimit.

3. Në ato raste kur lindin dyshime për identitetin e të paraburgosurit apo të të dënuarit ose rezultojnë mospërputhje në dokumentacion, njoftohet menjëherë oficeri i policisë gjyqësore dhe prokurori që ka urdhëruar ekzekutimin e vendimit penal të formës së prerë.

4. Personeli i ngarkuar i institucionit bën regjistrimin e të paraburgosurit apo të të dënuarit në regjistrin themeltar.

Neni 12

Njohja me të drejtat dhe detyrimet

1. Çdo i paraburgosur apo i dënuar informohet mbi të drejtat dhe detyrimet e tij që rrjedhin nga ligji, kjo rregullore dhe rregullorja e brendshme e IEVP-së. Për këtë qëllim, nga administrata e IEVP-së i vihen në dispozicion aktet e nevojshme ligjore e nënligjore.

2. Për të paraburgosurit dhe të dënuarit që nuk dinë shkrim e lexim, komunikimi i akteve bëhet me gojë nga personeli përgjegjës.

3. Për të paraburgosurit dhe të dënuarit me aftësi të kufizuara, komunikimi i akteve bëhet në një mënyrë të përshtatshme për ta, sipas llojit të aftësisë së kufizuar.

Neni 13

Veprimet paraprake gjatë pranimit

1. Pas momentit të pranimit në institucion, të sapoardhurit menjëherë i nënshtrohen një vizite ekzaminuese dhe interviste mjekësore nga ana e mjekut të institucionit për njohjen dhe parandalimin e përhapjes së sëmundjeve ngjitëse në institucion, vetëvrasjeve, regjistrimin e plagëve dhe dëmtimeve në kohën e duhur, duke respektuar parimin e konfidencialitetit.

2. Shenjat e dëmtimeve fizike, të identifikuar në vizitën e pranimit, duhet të regjistrohen në një regjister të veçantë së bashku me shpjegimet e të sapoardhurit mbi rrethanat e shkaktuara dhe njoftohet menjëherë drejtuesi i IEVP-së dhe prokurori.

3. Mjeku, në rast se i kërkohet, duhet të pajisë të sapoardhurin me një certifikatë mjekësore, e cila shpjegon gjendjen e lëndimeve dhe rrethanat e tjera.

4. Pas kontrollit mjekësor, i paraburgosuri/i dënuari si rregull vendoset në seksionin e pranimit për një periudhë jo më të gjatë se 10 ditë nga dita e



pranimi të tij, ku nga Komisioni i Pritjes kryhen veprimet e mëposhtme:

a) Kontrollohet higjiena personale;

b) Realizohet njohja me të dhënat personale, familjare, arsimin, profesionin, veprën penale, shkaku të kryerjes së veprës penale dhe vlerësimin e riskut.

5. Mbi bazën e dokumentacionit shoqërues, të shpjegimeve verbale, të formularit të vlerësimit të riskut, vlerësohen të dhënat individuale të të paraburgosurit dhe të të dënuarit lidhur me personalitetin e tij, përpilohet regjistri i komisionit të pritjes, dokumentacioni përkatës, sipas shërbimeve dhe programohet në vazhdim trajtimi individual për të paraburgosurin dhe të dënuarin.

6. Personeli i IEVP-së respekton të drejtën e të paraburgosurit/të të dënuarit për të mos informuar familjarët apo persona të tjerë të afërm për qëndrimin e tij në IEVP, përveçse kur ekzistojnë arsye ligjore.

Neni 14

Komisioni i pritjes

1. Në çdo institucion krijohet Komisioni i pritjes për të pranuar të sapoardhurit. Komisioni informon të paraburgosurin dhe të dënuarin në një gjuhë të kuptueshme për rregulloren e institucionit, të drejtat dhe detyrimet e tij, të drejtat e tij për këshillim dhe ndihmë ligjore, rregullat dhe procedurat për paraqitjen e kërkesave dhe ankesave.

2. Komisioni i pritjes përbëhet nga personeli shëndetësor, ligjor, social dhe ai i sigurisë.

3. Komisioni i pritjes merr kontaktin e parë me të burgosurin dhe njihet me problemet, personalitetin e të burgosurit dhe nëse i burgosuri përbën rrezikshmëri për sigurinë e të burgosurve të tjerë ose të personelit, i bën të njohur atij rregullat e brendshme të institucionit, të drejtat dhe detyrat, duke i vënë në dispozicion materialet përkatëse, si dhe e informon për mënyrën e jetesës gjatë kohës së qëndrimit në institucion.

4. Në librin e komisionit të pritjes evidentohen të dhënat personale e familjare, arsimi, profesioni, vepra penale për të cilën akuzohet, konfliktet e mundshme dhe bëhen rekomandimet përkatëse, të cilat i paraqiten drejtorit të IEVP-së.

5. Në rastet kur evidentohet dhe shënohet në regjistrin e komisionit të pritjes se i paraburgosuri/i dënuari i sapoardhur ka konflikt apo mos-

marrëveshje me të paraburgosur/të dënuar të tjerë ose ka lidhje gjinie a krushqie me personelin e institucionit, në pamundësi sistemimi merren menjëherë masa për transferimin e tij në një institucion tjetër.

6. Komisioni i pritjes mbledhet jo më vonë se 24 orë nga pranimi i të paraburgosurit/të dënuarit ose menjëherë kur për shkak të gjendjes shëndetësore apo të rrethanave të tjera është i detyrueshëm përsheptimi i procedurave të pranimi.

Neni 15

Kontrolli mjekësor

1. Institucionet mjekësore të posaçme jashtë sistemit të institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale dhe seksionet mjekësore të posaçme brenda institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale shërbejnë për mjekimin e të paraburgosurve dhe të të dënuarve me çrregullime të shëndetit mendor.

2. Vendosja e personave në institucionet mjekësore të veçanta, jashtë sistemit të institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale, kryhet në zbatim të vendimit të gjykatës.

3. Vendosja e personave në seksione mjekësore të posaçme kryhet në zbatim të vendimit të gjykatës ose të urdhrat të ekzekutimit të prokurorit. Në rastet që nuk presin, vendosja e personit të paraburgosur ose të dënuar urdhërohet nga drejtori i institucionit ku ndodhet i paraburgosuri ose i dënuari, duke vënë në dijeni menjëherë prokurorin.

4. Dalja nga institucionet mjekësore të posaçme bëhet me vendim të gjykatës në vijim të propozimit të drejtuesit të institucionit, kërkesës të të paraburgosurit dhe të të dënuarit ose kujdestarit ligjor të tij, si dhe me iniciativën e gjykatës, duke respektuar afatin maksimal të një viti për rivlerësimin e gjendjes së personit.

5. Për vendosjen, refuzimin e vendosjes, daljen ose refuzimin e daljes nga institucionet mjekësore të posaçme, i paraburgosuri dhe i dënuari, mbrojtësi ose kujdestari i tij, kanë të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 5 ditëve nga koha e vënies së tyre në dijeni.

6. Trajtimi në seksionet mjekësore të posaçme brenda institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale bëhet për aq kohë sa gjykata nuk shprehet për trajtimin e tyre në një institucion mjekësor të



posaçëm, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin për shëndetit mendor.

7. Në institucionet mjekësore të posaçme dhe seksionet mjekësore të posaçme respektohen të gjitha të drejtat e të paraburgosurve dhe të të dënuarve sipas ligjit për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të të paraburgosurve, sipas kësaj rregulloreje, si dhe legjislacionit në fuqi për të drejtat e pacientit.

8. Ministri i Drejtësisë dhe ministri i Shëndetësisë me udhëzim të përbashkët përcaktojnë mënyrën e zbatimit të procedurave që lidhen me trajtimin e kësaj kategorie personash.

Neni 16

Dosja personale

1. Për çdo të paraburgosur apo të dënuar hapet dosja personale, plotësimi i së cilës fillon nga momenti i pranimit në IEVP dhe vazhdon deri në lirimin e tij.

2. Dosja e shoqëron të paraburgosurin apo të dënuarin në rast transferimi në çdo IEVP tjetër.

3. Me përfundimin e kryerjes së dënimit ose në rast lirim, dosja arkivohet në IEVP.

Neni 17

Regjistrat themeltarë të të dënuarve dhe të të paraburgosurve

Në çdo IEVP mbahet regjistri themeltar i të paraburgosurve apo të të dënuarve, në të cilin pasqyrohen të dhënat e mëposhtme:

a) Informacion i plotë në lidhje me identitetin e të paraburgosurit apo të dënuarit (emri, atësia, mbiemri, datëlindja, vendlindja, vendbanimi, të afërmit me të cilët mund të komunikojë etj.).

b) Informacion lidhur me veprën penale (vepra penale e kryer, masa e dënimit, gjykata që ka dhënë vendimin, numri dhe data e vendimit, data e arrestimit, vendi ku është arrestuar, data dhe urdhri i prokurorit për ekzekutimin e vendimit, çdo vendim i mëvonshëm gjykate që ndryshon vendimin e mëparshëm ose sjell pasoja në ekzekutimin e tij, çdo amnisti, falje etj.).

c) Data, ora e pranimit dhe e lirim. Në rast vdekjeje të të paraburgosurit apo të të dënuarit, pasqyrohen në regjistrin themeltar të të paraburgosurve apo të të dënuarve data, vendi dhe ora e vdekjes, shkaku i vdekjes, kopje e aktit të vdekjes dhe personi apo autoriteti të cilit i dorëzohet kufoma.

Neni 18

Mbrojtja e të dhënave personale

1. Personeli i Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe IEVP-të zbatojnë legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, duke përfshirë edhe vendimet apo udhëzimet e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me qëllim arritjen e një niveli sigurie të përshtatshëm gjatë përpunimit të të dhënave personale të të paraburgosurve apo të dënuarve, nëpërmjet përdorimit të mjeteve të punës.

2. Veprimi apo mosveprimi, në kundërshtim me këtë dispozitë, përbën shkelje disiplinore dhe dënohet sipas legjislacionit në fuqi që rregullon marrëdhënien e punës së personelit.

Neni 19

Përdorimi i të dhënave personale

1. Të dhënat personale lidhur me të paraburgosurit dhe të dënuarit duhet të administrohen në përputhje me kërkesat ligjore dhe me ato mund të njihen ministri i Drejtësisë, drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, drejtori i Policisë, drejtori i IEVP-së, përgjegjësi i ruajtjes e sigurisë dhe çdo autoritet tjetër në përputhje me legjislacionin në fuqi ose nga personat e autorizuar prej tyre.

2. Personat të cilët, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, vihen në dijeni me të dhënat personale, detyrohen të ruajnë dhe të mos i nxjerrin këto të dhëna pas përfundimit të detyrës. Këto të dhëna mund të nxirren vetëm në rastet e parashikuara me ligj.

3. Të dhënat personale për çdo të dënuar administrohen në regjistra të certifikuar dhe të miratuar.

4. I paraburgosuri apo i dënuari ose një person i autorizuar prej tij mund t'i kërkojë drejtorit të IEVP-së të njihet me të dhënat personale të tij, pasi i deklaron drejtorit shkaku dhe llojin e informacionit që i duhet. Drejtori i IEVP-së duhet të sigurohet që informacioni i dhënë nuk lidhet me një të paraburgosur apo të dënuar tjetër.

5. Në rast se informacioni kërkohet nga një person i tretë, për dhënien e tij duhet marrë më parë pëlqimi me shkrim i të paraburgosurit apo të dënuarit, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga dispozitat ligjore në fuqi.



6. Për dëshmitarët dhe bashkëpunëtorët e drejtësisë, për administrimin e të dhënave të tyre personale zbatohet legjislacioni në fuqi.

Neni 20

Sendet personale dhe ruajtja e tyre

1. Të paraburgosurit apo të dënuarit i lejohet të mbajë me shpenzimet e veta veshje dhe sende personale, sipas përcaktimeve në rregulloren e brendshme të IEVP-së.

2. Pas hartimit të procesverbalit të pranimit të të paraburgosurit apo të të dënuarit, me dokumentet shoqëruese dhe sendet e tij personale, specialisti i informacionit organizon kontrollin e imët fizik dhe të materialeve personale të të paraburgosurit apo të të dënuarit dhe, në rast se konstaton sende që nuk lejohen të mbahen në regjim, sipas nenit 21, të kësaj rregulloreje, i regjistron ato në librin përkatës dhe harton një procesverbal, i cili nënshkruhet nga i paraburgosuri apo i dënuari dhe specialisti i informacionit, në prani të një punonjësi tjetër, ku njëra kopje e procesverbalit i jepet të paraburgosurit apo të dënuarit dhe administrohet në kartotekë.

3. Sendet personale dhe vlerat monetare të të paraburgosurit apo të të dënuarit i jepen atij në momentin e lirimt ose mund të tërhiqen në çdo kohë nga të afërmit e tij, sipas autorizimit të lëshuar nga i paraburgosuri apo i dënuari kundrejt procesverbalit të nënshkruar nga marrësi dhe nëpunësi i IEVP-së. Sendet që nuk mund të ruhen, u dërgohen personave të autorizuar nga i paraburgosuri apo i dënuari me shpenzimet e veta.

4. Në rastet e transferimeve, i paraburgosuri dhe i dënuari shoqërohet me sendet e tij personale.

Neni 21

Sendet e ndaluara

1. Në mjediset e brendshme të IEVP-së nuk lejohet të mbahen dhe të qarkullohen nga të paraburgosurit dhe të dënuarit:

a) objektet, mbajtja e të cilave përbën vepër penale;

b) sendet që rrezikojnë jetën dhe shëndetin e të burgosurve dhe të personelit, si dhe sigurinë e institucionit;

c) pajisje transmetimi dhe komunikimi, përfshirë aparatet celulare dhe fotografike;

ç) vlera monetare të çdo lloji;

d) pajisje të njëjta me ato që ofrohen nga institucioni, të cilat janë pjesë e dhomës apo e mjediseve të përbashkëta;

dh) sende me karakter diskriminues apo uniforma ushtarake;

e) bizhuteri, përveç atyre të lejuara sipas përcaktimeve të bëra në rregulloren e brendshme të institucionit;

ë) më shumë se një televizor dhe frigorifer sipas përcaktimeve të bëra në rregulloren e brendshme të IEVP-së.

2. Të gjitha sendet e ndaluara të të paraburgosurve apo të të dënuarve, përveç rasteve të cilat përbëjnë prova materiale, administrohen në zyrën e kartotekës dhe asgjësohen sipas një procedure të përcaktuar me urdhër të ministrit të Drejtësisë, me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. Vlerat monetare depozitohen në llogarinë e institucionit dhe përdoren për nevojat e Institucionit.

3. Për sendet që përbëjnë provë materiale ndiqen procedurat ligjore të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale.

Neni 22

Mjetet monetare

I paraburgosuri apo i dënuari lejohet të depozitojë mjete monetare në llogari personale, të hapura në IEVP apo në një institucion bankar. Në rastin e hapjes së llogarive në një institucion bankar, marrëdhëniet midis institucionit bankar dhe IEVP-së rregullohen me marrëveshje të përbashkëta, ku parashikohet mënyra e disponimit dhe përdorimit të mjeteve monetare nga të burgosurit.

2. IEVP-ja vë në dispozicion të të paraburgosurit apo të të dënuarit shumën e parave për çdo muaj, e cila nuk mund të kalojë vlerën e gjysmës së pagës minimale mujore, sipas kërkesës dhe nënshkrimit të të paraburgosurit apo të të dënuarit. Mjetet monetare përdoren nga të paraburgosurit apo të dënuarit për blerje të sendeve, të cilat lejohen nga kjo rregullore ose rregullorja e brendshme e IEVP-së. Të paraburgosurit apo të dënuarit kanë të drejtë t'i dërgojnë mjete monetare familjes.



KREU IV
TË DREJTAT DHE DETYRAT E TË
PARABURGOSURVE DHE TË TË
DËNUARVE

Neni 23

Të drejtat e të paraburgosurve dhe të dënuarve

1. Të paraburgosurit apo të dënuarit trajtohen pa njëanshmëri dhe pa diskriminim mbi bazë gjinie, race, ngjyre, përkatësie etnike, gjuhe, feje, bindjeje politike, fetare ose filozofike, orientimi seksual, identiteti gjinor, gjendjeje ekonomike, arsimore ose shoqërore, përkatësie prindërore, moshe, gjendjeje familjare ose martesore, gjendjeje shëndetësore, aftësie të kufizuar, shtetësie ose përkatësie në një grup të caktuar ose për çdo shkak tjetër që përbën diskriminim.

2. Gratë e paraburgosura apo të dënuara trajtohen duke respektuar liritë dhe të drejtat themelore e pa diskriminim, duke parandaluar çdo akt dhune me bazë gjinore që sjell dëmtim fizik, seksual ose psikologjik, vuajtje ose çdo formë tjetër abuzimi e keqtrajtimi, që dënohen sipas ligjeve në fuqi.

3. Të paraburgosurve apo të dënuarve me çrregullime të shëndetit mendor u garantohej trajtim i barabartë, jodiskriminues, duke respektuar integritetin fizik dhe dinjitetin njerëzor. Trajtimi i tyre bëhet sipas standardeve shëndetësore që zbatohen edhe për kategoritë e tjera të personave me çrregullime të shëndetit mendor.

4. Të paraburgosurve apo të dënuarve me aftësi të kufizuar u garantohej liritë dhe të drejtat themelore të njeriut, trajtimi jodiskriminues për shkak të aftësisë së kufizuar, duke plotësuar nevojat specifike për aftësimin e riaftësimin e tyre.

5. Të paraburgosurit apo të dënuarit e huaj ose pa shtetësi trajtohen duke mbajtur parasysh situatën e tyre të veçantë dhe nevojat individuale. Autoritetet e institucionit ndërmarrin veprime pozitive për të shmangur diskriminimin dhe për të zgjidhur probleme specifike, me të cilat këta persona përballen në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, gjatë transferimit dhe pas lirimit.

6. Masat e veçanta, që janë të nevojshme të zbatohen për respektimin e lirive dhe të drejtave të grupeve të veçanta të të paraburgosurve e të të dënuarve nuk konsiderohen diskriminim sipas kësaj rregulloreje.

7. Gjatë qëndrimit në institucion të dënuarit dhe të paraburgosurit, në përputhje me legjislacionin në fuqi, kanë këto të drejta:

a) U sigurohet takimi, letërkëmbimi, bisedat telefonike me avokatët duke pasur kohë të mjaftueshme dhe në konfidencë të plotë;

b) U sigurohet fjetje në krevat të veçantë me rroba fjetjeje sipas kushteve klimaterike;

c) U sigurohet ushqim tri herë në ditë, sipas normave të përcaktuara;

ç) Të kenë llogarinë personale, të cilën mund ta përdorin për nevojat e tyre;

d) Të takohen me familjarët e të afërmit e tyre deri në 4 herë në muaj;

dh) T'u sigurohet shërbimi mjekësor 24-orësh, nën kujdesin e personelit mjekësor në bashkëpunim me spitalin e burgjeve dhe me organet shtetërore përkatëse të shëndetësisë, si dhe të bëjnë vizita privatisht me shpenzimet e tyre;

e) Të paraqesin kërkesa dhe ankesa te personeli i IEVP-së dhe i çdo institucioni tjetër;

ë) T'u sigurohet e drejta dhe fshehtësia e letërkëmbimit;

f) Të drejtën e bisedave telefonike;

g) Të drejtën e ajrimit;

gj) Të marrin pjesë në aktivitete argëtuese, edukative që organizohen nga IEVP-ja;

h) Të drejtën e punësimit dhe punës.

i) Të drejtën e lirisë së besimit dhe ushtrimit të rriteve fetare;

j) Të drejtën e ndihmës socialo-psikologjike dhe konsulencës juridike;

k) Të përdorin sendet personale të lejuara sipas kësaj rregulloreje.

8. Shtetasit e huaj kanë të drejtë të marrin kontakte me përfaqësitë diplomatike të vendit të tyre dhe gëzojnë të njëjtat të drejta dhe detyrime me të paraburgosurit dhe të dënuarit e tjerë, për aq sa nuk parashikohet ndryshe në këtë rregullore.

Neni 24

Detyrimet e të paraburgosurve dhe të të dënuarve

Të paraburgosurit apo të dënuarit kanë për detyrë:

a) të mbajnë të pastër e të rregullt dhomën e tyre dhe mjediset e përbashkëta;

b) të kujdesen për higjienën personale;

c) të mos mbajnë dhe qarkullojnë sende të ndaluara, të cilat rrezikojnë rendin, jetën dhe



shëndetin e të paraburgosurve e të dënuarve dhe personelit, objekte që përbëjnë vepër penale, mjete që ndikojnë negativisht në hetim, si dhe vlera monetare të çdo lloji;

ç) të krijojnë marrëdhënie korrekte me të paraburgosurit dhe të dënuarit e tjerë, si dhe me personelin e institucionit;

d) të zbatojnë udhëzimet e personelit të institucionit;

dh) të dëmshpërblejnë vlerën përkatëse në rastet e dëmtimit të materialeve që janë pronë e institucionit ose e të paraburgosurve dhe të dënuarve të tjerë;

e) të zbatojnë programet ditore të institucionit;

ë) të respektojnë dinjitetin e pjesëtarëve të komunitetit dhe të personelit;

f) të informojnë menjëherë drejtorin e IEVP-së për rrethanat që mund të rrezikojnë sigurinë, jetën e të paraburgosurve dhe të dënuarve ose shkeljen e rregullave të brendshme në IEVP.

Neni 25

Kërkesat dhe ankesat

1. Kërkesat dhe ankesat bëhen sipas përcaktimeve të ligjit për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve.

2. Çdo institucion mban dhe përditëson regjistrin e kërkesave ose ankesave të të dënuarve dhe të të paraburgosurve, në formë shkresore dhe elektronike. Formatit dhe përmbajtja e regjistrit është sipas aneksit nr. 1, që bashkëlidhet kësaj rregulloreje dhe është pjesë përbërëse e saj.

Neni 26

Parandalimi i dhunës dhe trajtimi i viktimave

1. Të paraburgosurve apo të dënuarve që kanë pasur përvoja të dhunës fizike, psikologjike ose seksuale, para ose gjatë qëndrimit në institucion, u ofrohen menjëherë masa mbrojtjeje, mbështetjeje dhe këshillime ligjore me qëllim rehabilitimin e tyre.

2. Administrata e IEVP-së bën përpjekje për të mbrojtur të paraburgosurit dhe të burgosurit e rrezikuar nga kërcënimet dhe keqtrajtimi nga ana e të paraburgosurve dhe të të burgosurve të tjerë. Nëse ndarja nga të paraburgosurit dhe të burgosurit e tjerë është e nevojshme për arsye sigurie, duhet të shmanget izolimi i plotë dhe duhet të sigurohet një mjedis i sigurt dhe mbështetës.

KREU V

VENDOSJA DHE AKOMODIMI

Neni 27

Vendosja e të dënuarve

1. Vendosja e të paraburgosurit apo e të dënuarit në IEVP bëhet mbështetur në kriteret e vendosura në legjislacionin në fuqi për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve dhe të të paraburgosurve dhe në legjislacionin në fuqi për ekzekutimin e vendimeve penale, duke mbajtur parasysh kriterin e afërsisë së vendbanimit.

2. Gjatë vendosjes të të paraburgosurve apo të të dënuarve në IEVP, mbahet parasysh vlerësimi i rrezikut individual, informacionet që kanë të bëjnë me sigurinë e tij, si dhe krijimi i lehtësive për trajtimin dhe integrimin e tyre.

Neni 28

Vendosja e personave bashkëpunëtorë të drejtësisë

1. Brenda institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale krijohen seksione të veçanta për vendosjen e personave, të paraburgosur ose të dënuar, që gëzojnë statusin e bashkëpunëtorëve të drejtësisë.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në bashkëpunim me Drejtorinë e Policisë së Shtetit, marrin masa për sigurimin e jetës së personit dhe realizimin e programit të trajtimit individual të tij.

Neni 29

Vendosja nëpër dhoma

1. I paraburgosuri apo i dënuari qëndron në dhomën e pranimit jo më shumë se 10 ditë dhe më pas vendoset në mjedisin e banimit. Në vendosjen e të paraburgosurve/dënuarve nëpër dhoma mbahen parasysh kriteret që lidhen me gjendjen e tyre gjyqësore, faktin nëse janë ose jo përsëritës, llojin e veprës penale, masën e dënimit, moshën, gjendjen shëndetësore dhe nevojat mjekësore, arsimin, veçoritë intelektuale dhe psikike, kërkesat e veçanta për trajtimin e tyre, problemet konfliktuale, faktin nëse janë nën hetim për të njëjtën çështje penale me persona të tjerë të ndaluar me urdhër të prokurorit apo të gjykatës.

2. Në çdo IEVP krijohen seksione, sipas kategorizimit të përcaktuar me urdhër të ministrit të Drejtësisë.



3. Ndalohet mbajtja e të paraburgosurve apo e të dënuarve të mitur në një dhomë me të rriturit ose vendosja e vajzave të mitura me djem të mitur në një dhomë. Të paraburgosurit apo të dënuarit e mitur vendosen në seksione të veçuara, duke iu krijuar mundësi për një trajtim të veçantë.

4. Gratë e paraburgosura apo të dënuara vendosen në seksione të veçuara nga burrat dhe mbahen nën mbikëqyrjen dhe kujdesin e personelit femëror.

Neni 30

Dhomat dhe pajisjet e tyre

1. Në vendosjen e të paraburgosurve apo të të dënuarve mbahen parasysh kushtet dhe mundësitë konkrete të çdo I EVP-je, por në çdo rast duke iu siguruar kubatura jo më pak se 9 m³ dhe sipërfaqja e banimit jo më pak se 4 m² për çdo të paraburgosur apo të dënuar, dritare që mundësojnë ajrim të mjaftueshëm dhe ndriçim natyral normal për të lexuar e punuar. Drita artificiale duhet të plotësojë standardet e njohura teknike. Të paraburgosurve apo të dënuarve u sigurohet energji elektrike e nevojshme për ndriçim dhe nevoja të higjienës personale.

2. Elementet e sigurisë, që lidhen me parametrat e kërkuara për ndërtimin e burgjeve sipas shkallës së sigurisë, duhet të jenë në përputhje me udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës.

Neni 31

Veshjet dhe pajisjet e fjetjes

Çdo të paraburgosuri apo të dënuari i sigurohen shtresat, mbulesat për fjetje dhe veshje, në përputhje me kushtet klimaterike dhe nevojat e tij shëndetësore, sipas normave të miratuara në rregulloren e brendshme të I EVP-së.

KREU VI

AJIRIMI I TË PARABURGOSURVE DHE TË DËNUARVE

Neni 32

Ajrimi

1. Të paraburgosurit dhe të dënuarit dalin në ajrim në mjediset të hapura çdo ditë të javës, përfshirë ditët e shtuna, të diela dhe festat zyrtare dhe jo më pak se dy orë në ditë. Kufizimi i orarit të ajrimit bëhet vetëm për shkaqe të jashtëzakonshme

dhe vetëm me urdhër të drejtorit të institucionit. Ajrimi kryhet në vendin e caktuar sipas grafikut të miratuar.

2. Në raste të veçanta ose për të sëmurët, me rekomandim të mjekut të I EVP-së, lejohet dalja në ajrim shtesë, pasi mjeku të shpjegojë me shkrim arsyet e dhënies së kohës shtesë për ajrim dhe afatin e përcaktuar.

3. Dalja në ajrim bëhet me grupe ose individualisht. Në dalje dhe në hyrje bëhet kontrolli fizik i të burgosurve.

4. Gjatë kohës që kryhet ajrimi, veprimet e të paraburgosurve dhe të të dënuarve vëzhgohen.

5. Në rast se konstatohen shqetësime, ndërpritet ajrimi dhe të paraburgosurit apo të dënuarit futen nëpër dhoma dhe raportohet te specialisti i informacionit, duke hartuar raport shërbimi dhe mbajtur një procesverbal.

6. Institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale mundëson infrastrukturën e përshtatshme në rastet kur kushtet atmosferike janë jo të favorshme për kryerjen e ajrimit nga të dënuarit.

Neni 33

Koha e pushimit

Koha e pushimit të të dënuarve bëhet duke respektuar orarin e veprimeve të miratuara nga drejtori i I EVP-së.

KREU VII

HIGJIENA VETJAKE DHE E MJEDISIT

Neni 34

Shërbimet higjienike

1. Shërbimet higjienike ndërtohen në mënyrë të tillë që të sigurojnë kushtet normale për jetesë. Vendet ku kryhen këto shërbime pajisen me pajisjet hidro-sanitare të nevojshme dhe kanë ujë të rrjedhshëm.

2. Shërbimet higjienike vendosen në mjediset të veçanta, të ndara nga mjediset e tjera ku zhvillohen veprimtari të përbashkëta dhe në raporte të përshtatshme me numrin e të burgosurve.

Neni 35

Higjiena personale dhe e mjedisve

1. I paraburgosuri apo i dënuari është i detyruar të kujdeset vazhdimisht për higjienën dhe pamjen e pastër e të rregullt të tij, si dhe të mbajë pastër e të rregullt dhomën dhe mjediset e përbashkëta.



2. Detergjentet pastrues e dezinfektues dhe mjetet e tjera për pastrim sigurohen nga IEVP-të. Të paraburgosurve apo të dënuarve u lejohet që të sigurojnë edhe vetë, me shpenzimet e tyre, detergjente pastrues e dezinfektues dhe mjete të tjera për pastrim.

3. Kontrolli higjieno-sanitar i dhomave dhe i mjediseve të përbashkëta bëhet çdo ditë nga personeli mjekësor dhe specialisti i regjimit të brendshëm, të cilët lënë detyrat përkatëse për të metat e konstatuara dhe informojnë drejtorin e IEVP-së për gjendjen.

Neni 36

Pastrimi i dhomave

1. Të paraburgosurit apo të dënuarit duhet të mbajnë pastër dhomat e tyre dhe mjediset e tjera të përbashkëta. Çdo IEVP parashikon në rregulloren e brendshme mënyrën e hartimit të grafikut ditor të pastrimit të dhomave dhe mjediseve të përbashkëta, rregullat e pastrimit dhe kontrollin e tyre.

2. IEVP-ja garanton ujin, detergjentet pastrues dhe dezinfektues, si dhe mjetet e tjera të nevojshme për pastrim.

KREU VIII

USHQIMI I TË PARABURGOSURVE DHE I TË DËNUARVE

Neni 37

Ushqimi

1. Të paraburgosurve apo të dënuarve u sigurohet ushqim për tri vaktet, sipas normave dhe llojshmërisë, të përcaktuara me akte nënligjore.

2. Të paraburgosurit apo të dënuarit i lejohet furnizimi nga familja dhe njësia e tregimit në institucion 4 herë në muaj me produkte ushqimore, ku në çdo radhë mund të pranohen deri në 5 kg ushqime, 3 kg fruta, ndërsa lëngjet duhet të jenë me ambalazh të tejdukshëm dhe të hapura. Cigaret nuk llogariten në peshën e ushqimeve.

3. I paraburgosuri apo i dënuari mund të blejë produkte ushqimore, cigare dhe sende të tjera në njësitë tregtare të IEVP-së, të përcaktuara në rregulloren e brendshme të IEVP-së dhe sipas sasisë së parashikuar në pikën 2, të këtij neni, me të ardhurat që ka në llogarinë e tij.

4. Institucioni u siguron të paraburgosurve apo të dënuarve të sëmure dietë të veçantë, sipas rekomandimeve të mjekut.

5. Llojshmëria e ushqimit përcaktohet në tabela të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve. Norma e ushqimit është në përputhje me urdhrin e Përbashkët të ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Shëndetësisë. Respektimi i tyre verifikohet nga shërbimi shëndetësor i IEVP-së.

6. Në qoftë se i paraburgosuri apo i dënuari, për shkak të ndërgjegjes ose besimit fetar, kërkon një ushqim të ndryshëm, kjo kërkesë respektohet nga personeli i IEVP-së në përputhje me rregullat fetare dhe mundësitë praktike të IEVP-së.

7. Sektorët e shëndetësisë, të policisë e të logjistikës përpilojnë një raport të përbashkët, të hollësishëm për sasinë e ushqimit, të ndarë sipas kategorive të të burgosurve.

8. Drejtori i IEVP-së merr masa për ngritjen e njësisë së tregimit në IEVP për plotësimin e nevojave të të burgosurve. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve miraton dhe kontrollon rregullisht veprimtarinë e njësive të tregimit në IEVP.

9. Të miturve u sigurohet një dietë ushqimore, në cilësi dhe sasi, që mban parasysh moshën, shëndetin, kushtet fizike, fenë, kulturën dhe aktivitetet, që ata kryejnë në institucion.

Neni 38

Kontrolli i cilësisë së ushqimit

1. Personeli mjekësor dhe specialisti i informacionit, 30 minuta përpara ndarjes së ushqimit, kontrollojnë cilësinë dhe verifikojnë respektimin e normave të ushqimit, duke bërë shënimet përkatëse në regjistrin “Kontrolli i ushqimit”. Format i regjistrit “Kontrolli të ushqimit” përcaktohet me urdher të drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.

2. Për çdo vakt merren kampione nga ushqimi i gatuar, të cilat mbahen 24 orë në kushte frigoriferike, të mbyllura dhe të vulosura, nga specialisti i informacionit.

Neni 39

Shpërndarja e ushqimit

1. Ushqimi u shërbehet të dënuarve apo të burgosurve në vendin e caktuar dhe sipas grafikut të miratuar nga drejtori i IEVP-së, në përputhje me parashikimet e rregulloreve të brendshme të IEVP-ve.

2. Drejtori i IEVP-së merr parasysh rekomandimet e mjekut për dietën ushqimore për të paraburgosurit apo të burgosurit e sëmure, si dhe



shtesën në ushqim për të dënuarit që punojnë. Në raste të veçanta, siç janë festat zyrtare, ritet fetare, ngjarjet e jashtëzakonshme etj., me miratimin e drejtorit të IEVP-së, ky orar mund të ndryshojë.

KREU IX KONTAKTET ME BOTËN E JASHTME

Neni 40

Takimi me familjen, të afërmit dhe miqtë

1. Të paraburgosurit apo të dënuarit kanë të drejtë të takohen 4 herë në muaj me familjarët, të afërmit dhe miqtë e tyre. Të paraburgosurit apo të dënuarit e mitur kanë të drejtë të takohen me familjarët 8 herë në muaj. Drejtori i IEVP-së mund të japë takime shtesë të arsyetuara për të paraburgosurit apo të dënuarit.

2. Takimet e zgjatura lejohen deri në 5 orë për të dënuarit e martuar ose bashkëjetues, në përputhje me kriteret e përcaktuara në Kodin e Familjes.

3. Takimet bëhen çdo ditë sipas orarit të veprimeve, në vendet e përcaktuara në rregulloren e IEVP-së.

4. Në çdo takim lejohen fëmijët e mitur dhe tre persona madhorë.

5. Drejtori i IEVP-së, me vendim të prokurorit apo të gjykatës, kufizon të drejtën e të paraburgosurit apo të të dënuarit të presë vizita, nëse kjo është e nevojshme për kryerjen e veprimeve procedurale penale.

Neni 41

Procedurat për takimet me familjarët, të afërmit dhe miqtë

1. Takimet e të paraburgosurit apo të të dënuarit me familjarët, të afërmit dhe miqtë bëhen me kërkesë të të paraburgosurit, të të dënuarit apo të të interesuarit për takim.

2. Me paraqitjen e kërkesës të të interesuarit për takim me të paraburgosurin dhe të dënuarin, verifikohet identiteti i personit, bëhet verifikimi i numrit të takimeve në regjistrin e indeksit alfabetik dhe, më pas, bëhet regjistrimi në regjistrin e takimeve të të paraburgosurve dhe të të dënuarve me familjarët, duke i dhënë numrin e radhës së takimit të interesuarit për takim.

3. Më pas, njoftohet përgjegjësi i regjimit të brendshëm, i cili lajmëron të paraburgosurin apo të dënuarin mbi ardhjen e familjarëve apo të afërmeve

e miqve të tyre dhe merr masa për organizimin e takimit.

4. Në rastet kur konstatohet se nga vizitorët tentohet të futen sende të ndaluara që i posedojnë vetë, pezullohet takimi dhe ndiqen procedurat ligjore. Për rastet e sendeve të ndaluara që përbëjnë vepër penale njoftohet Prokuroria, ndalohet personi dhe bëhet kallëzim për ndjekje penale.

5. Kur vizitori tenton të fusë sende të ndaluara, drejtori i IEVP-së vendos moslejimin e takimeve për këtë vizitor për një periudhë nga 3 deri në 6 muaj.

Neni 42

Vëzhgimi i takimeve

1. Takimet zhvillohen në vendet e caktuara nën mbikëqyrjen vizuale të personelit mbikëqyrës.

2. Në rast se personeli mbikëqyrës i policisë konstaton se vizitorët tentojnë apo kryejnë shkëmbime sendesh të ndaluara me të paraburgosurin apo të dënuarin, ndërpret menjëherë takimin dhe njofton specialistin e informacionit.

3. Pas përfundimit të kohës së takimit, personeli mbikëqyrës njofton specialistin e informacionit për shoqërimin e të paraburgosurit apo të të dënuarit në regjimin e brendshëm dhe për shoqërimin e daljen e vizitorëve nga institucioni.

Neni 43

Korrespondenca

1. Çdo i paraburgosur apo i dënuar ka të drejtë të mbajë korrespondencë dhe t'i garantohet fshehtësia e saj.

2. Për të paraburgosurit dhe të dënuarit që nuk i kanë mundësitë, personeli i IEVP-së vë në dispozicion mjetet e nevojshme për korrespondencë.

3. Korrespondenca duhet të hidhet në kutinë postare të IEVP-së, e cila merret nga një punonjës i shërbimit postar. Shpërndarja e korrespondencës së ardhur bëhet nga personeli i IEVP-së, duke ruajtur fshehtësinë e saj.

4. Në rastet kur ka dyshime të bazuara se në korrespondencë ka sende të ndaluara, ajo hapet në prani të të paraburgosurit apo të të dënuarit dhe të drejtorit të IEVP-së.

5. Drejtori i IEVP-së, me vendim të prokurorit ose të gjykatës, mund të kufizojë të drejtën e të paraburgosurit apo të të dënuarit për korres-



pondencë, nëse kjo është e nevojshme për kryerjen e veprimeve procedurale penale.

Neni 44

Bisedat telefonike

1. Të paraburgosurit apo të dënuarit i lejohet 8 herë në muaj biseda telefonike me familjarët, të afërmit dhe miqtë e tij. Drejtori i IEVP-së lejon kryerjen e bisedave telefonike shtesë dhe në këtë rast shërbimi telefonik përballohet nga vetë i paraburgosuri apo i dënuari. Bisedat telefonike zhvillohen nën mbikëqyrjen vizuale të personelit. Të paraburgosurit dhe të dënuarit të mitur si dhe grave u lejohet 16 herë në muaj biseda telefonike.

2. Në rastet kur i paraburgosuri apo i dënuari nuk ka mjete financiare për të kryer biseda telefonike me familjarët, kjo e fundit i sigurohet 1 herë në muaj deri në 5 minuta me shpenzimet e IEVP-së.

3. Drejtori i IEVP-së, me vendim të prokurorit ose gjykatës, kufizon të drejtën e të paraburgosurit apo të të dënuarit për biseda telefonike.

Neni 45

Takimet e të paraburgosurve dhe të të dënuarve të huaj me përfaqësitë diplomatike

1. Të paraburgosurit apo të dënuarit me shtetësi të huaj i krijohen të gjitha lehtësitë e nevojshme për komunikimin me përfaqësuesit diplomatikë ose konsullorë të shtetit përkatës.

2. Të paraburgosurit apo të dënuarit, shteti i të cilit nuk ka përfaqësi në Republikën e Shqipërisë, refugjatëve, si dhe personave pa shtetësi, u krijohen të njëjtat lehtësira për të komunikuar me përfaqësuesit diplomatikë të shtetit që merr përsipër mbrojtjen e interesave të tyre ose me autoritetet kombëtare apo ndërkombëtare që kanë për objekt të veprimtarisë së tyre mbrojtjen e interesave të këtyre personave.

3. Përfaqësuesit diplomatikë dhe konsullorë kanë të drejtë të zhvillojnë takime në çdo kohë me shtetasit e tyre të paraburgosur dhe të dënuar, me njoftimin paraprak të institucionit.

KREU X

TAKIMET ME PROKURORË, AVOKATË DHE INSTITUCIONE TË TJERA

Neni 46

Takimet me prokurorë, avokatë ose oficerë të policisë gjyqësore

1. Gjyqtarët, prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore të autorizuar lejohen të futen në regjimin e brendshëm për të zhvilluar veprime procedurale me të paraburgosurit apo të dënuarit.

2. Avokatët lejohen të marrin takim me të paraburgosurit dhe të dënuarit, kundrejt aktit të përfaqësimit.

3. Marrja në pyetje e të paraburgosurit apo e të dënuarit të mitur, nga ana e prokurorit ose oficerit të policisë gjyqësore, bëhet në praninë të avokatit të tij dhe psikologut.

4. Takimet e gjyqtarit, prokurorit, oficerit të policisë gjyqësore lejohen në çdo kohë.

5. Të paraburgosurit apo të dënuarit kanë të drejtë të zhvillojnë takime në çdo kohë me përfaqësuesin e tyre ligjor, me njoftimin paraprak të institucionit.

Neni 47

Takimet me Avokatin e Popullit

1. Avokati i Popullit takohet me të paraburgosurin apo të dënuarin, në çdo kohë, pa njoftimin paraprak të institucionit.

2. Takimi i të paraburgosurit apo të dënuarit me Avokatin e Popullit nuk mbikëqyret.

Neni 48

Takimet me noterët dhe punonjësit e gjendjes civile

1. Të paraburgosurit apo të dënuarit lejohen të takohen me noterin e zgjedhur për kryerjen e veprimeve ligjore.

2. Të paraburgosurit apo të dënuarit shoqërohen në zyrën e gjendjes civile për lidhje martesë apo për aplikimin për kartë identiteti ose pasaportë.

Neni 49

Hyrja në institucion

1. Subjektet e përmendura në nenin 43, të ligjit nr.8328, datë 16.4.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar, kanë të drejtë të hyjnë pa autorizim në IEVP.



2. Drejtori i Përgjithshëm lëshon autorizime për hyrje në IEVP për subjektet e tjera pas depozitimit të kërkesës me shkrim.

3. Miratimi apo refuzimi i autorizimit për të hyrë në IEVP duhet të jetë i motivuar.

4. Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve lëshon autorizim për futjen e mediave në regjimin e brendshëm të IEVP-së. Ndalohej realizimi i filmimeve në mjediset e banimit të të paraburgosurve dhe të të dënuarve, si dhe transmetimi i emisioneve të drejtpërdrejta nga mjediset e IEVP-së.

5. Në kërkesën për pajisje me autorizim duhet të shpjegohen hollësisht arsyet për të cilat kërkohet hyrja në institucion dhe ajo duhet të shoqërohet me dokumentin e identifikimit të kërkuarit, dokumentet që vërtetojnë arsyen e kërkesës, nëse ka. Kur kërkuari është një person juridik, kërkesa duhet të shoqërohet me autorizimin për t'u përfaqësuar nga personi/at fizikë të caktuar në kërkesë.

KREU XI

LEJET

Neni 50

Shqyrtimi i kërkesave për leje shpërblyese apo të veçanta

1. Drejtori i IEVP-së është autoriteti përgjegjës për dhënien e lejeve shpërblyese dhe të veçanta për të dënuarit.

2. Miratimi apo refuzimi i kërkesave për leje shpërblyese apo të veçanta duhet të bëhet në përputhje me kërkesat ligjore të parashikuara në nenet 59 dhe 75/5, të ligjit nr. 8328, datë 16.4.1998, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", i ndryshuar, me kërkesat e kësaj rregulloreje, si dhe me udhëzimin e ministrit të Drejtësisë.

3. Drejtoritë e IEVP-ve në çdo fillim viti dërgojnë planifikimin vjetor të lejeve shpërblyese të të dënuarve që plotësojnë kriteret ligjore, të ndarë sipas një grafiku të përcaktuar.

4. Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, pas marrjes së planifikimit nga çdo IEVP, ngre Bordin e Monitorimit të dhënies së lejeve shpërblyese dhe të veçanta.

5. Kërkesat për leje të veçanta i drejtohen drejtorit të IEVP-së dhe regjistrohen në regjistrin e lejeve të të dënuarve.

Neni 51

Lejet shpërblyese

1. Të dënuarit, të cilët respektojnë rregullat e disiplinës dhe rregulloren e brendshme të institucionit dhe janë të motivuar për të marrë pjesë në programet rehabilituese e të riintegritit apo nuk paraqesin rrezikshmëri shoqërore, kanë të drejtë të marrin leje shpërblyese, deri në 20 ditë në vit.

2. Planifikimi i lejeve shpërblyese bëhet sipas një grafiku të përcaktuar në fillim të vitit dhe nuk mund të zgjatë më shumë se 7 ditë.

3. Brenda 7 ditëve nga data e marrjes së kërkesës për leje shpërblyese, drejtori i IEVP-së vendos miratimin ose jo të saj, duke u bazuar në planifikimin vjetor dhe raportet e vlerësimit të përgjegjësve të sektorit të sigurisë, sektorit të çështjeve shoqërore dhe sektorit ligjor. Në raportet e vlerësimit përfshihen respektimi i kërkesave ligjore, vlerësimi i sjelljes të të dënuarit, vlerësimi i riskut, pjesëmarrja e tij në programe rehabilituese dhe riintegruese ose në programe të tjera brenda institucionit, besueshmëria që paraqet i dënuari për kthimin e tij në institucion, ekzistenca ose jo e masave disiplinore, marrëdhëniet me familjen, si dhe çdo aspekt tjetër që ka të bëjë me profilin e të dënuarit. Për miratimin e lejes duhet vlerësimi pozitiv i të gjithë sektorëve.

4. Në çdo rast, duhet të kenë kaluar të paktën 3 muaj nga miratimi i lejes shpërblyese të fundit.

5. Leja shpërblyese u jepet:

a) personave të dënuar deri në 3 vjet burgim, pasi të kenë vuajtur jo më pak se 1/4 e dënimit;

b) personave të dënuar nga 3 deri në 10 vjet burgim, pasi të kenë vuajtur jo më pak se 1/2 e dënimit;

c) personave të dënuar mbi 10 vjet burgim, pasi t'u ketë mbetur për të vuajtur më pak se 5 vjet heqje lirie.

6. Në rast refuzimi të dhënies së lejes, i dënuari ose përfaqësuesi i tij ligjor ka të drejtë të bëjë ankim brenda 5 ditëve pranë drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve ose ministrit të Drejtësisë, sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative dhe më pas ka të drejtë të ankohet në gjykatë, e cila vendos për kërkesën për leje.

7. Procedurat e dhënies së lejeve përcaktohen me udhëzim të ministrit të Drejtësisë.



Neni 52

Lejet shpërblyese për të dënuarit në seksionet e sigurisë së lartë

1. Lejet shpërblyese për të dënuarit, që kryejnë dënimin në seksionet e sigurisë së lartë, jepen vetëm me urdhër të ministrit të Drejtësisë apo me autorizim të ministrit të Drejtësisë nga drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve.

2. Ministri i Drejtësisë dhe drejtori i Përgjithshëm, me marrjen e kërkesës nga i dënuari, i kërkojnë drejtorit të I EVP-së të përgatitë informacionin përkatës.

3. Në rast refuzimi, brenda 5 ditëve, i dënuari mund të ankohet në gjykatë, e cila vendos për kërkesën për dhënien e lejes shpërblyese.

Neni 53

Lejet e veçanta

Drejtori i I EVP-së është personi përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës të të paraburgosurit apo të të dënuarit për leje të veçantë sipas procedurës së mëposhtme:

a) Kërkesa e të paraburgosurit apo e të dënuarit duhet të jetë e argumentuar dhe e shoqëruar nga dokumentacioni përkatës. Në raste sëmundjesh të rënda, të cilat rrezikojnë jetën e anëtarëve të familjes të të paraburgosurit apo të të dënuarit, kërkesa duhet të shoqërohet me raportin mjekësor të familjarit të sëmurë ku vërtetohet gjendja e rëndë shëndetësore e tij. Në rastet e ngjarjeve të rëndësishme familjare, si vdekje, lindje apo martesë, kërkesa duhet të shoqërohet me dokumentin zyrtar që provon vdekjen, lindjen apo martesën. Me anëtarë të familjes të të paraburgosurit apo të të dënuarit nënkuptohen nëna, babai, fëmijët, motra, vëllai, bashkëshorti/ja ose, në rastet kur martohet vetë, si dhe në rastet e dhënies së provimeve nga ana e tij.

b) Pas marrjes së kërkesës dhe dokumentacionit përkatës nga i paraburgosuri apo i dënuari, drejtori i I EVP-së urdhëron, brenda ditës së marrjes së kërkesës, përgjegjësin e sektorit ligjor, përgjegjësin e sektorit të sigurisë dhe përgjegjësin e sektorit të shërbimit social për shqyrtimin dhe përgatitjen e dokumentacionit që do të shërbejë si bazë e miratimit apo refuzimit të lejes së veçantë.

c) Lidhur me lejet e veçanta për arsye shëndetësore të anëtarëve të familjes të të paraburgosurit apo të të dënuarit, dokumenti

mjekësor që shoqëron kërkesën për leje të veçantë vlerësohet edhe nga përgjegjësi i sektorit të shëndetësisë në I EVP ose në mungesë të tij nga mjeku i institucionit, i cili bën akt verifikimin e epikrizës mjekësore duke kontrolluar të gjitha elementet që provojnë vërtetësinë e saj, shprehet me shkrim për shkallën e rrezikshmërisë së sëmundjes së anëtarit të familjes të të burgosurit, kontrollon nëpërmjet komunikimit telefonik me qendrën spitalore, ku është shtruar i sëmurë ose me mjekët që kanë nënshkruar epikrizën. Aktverifikimi i mjekut dhe mendimi me shkrim i tij i bashkëlidhen raportit të përbashkët të tre sektorëve të përcaktuar në shkronjën “b”, të pikës 1, të këtij neni.

ç) Përgjegjësi i sektorit të sigurisë dhe përgjegjësi i shërbimit social përgatitin, brenda ditës nga data e marrjes së urdhrit, një raport të përbashkët, të hollësishëm, i cili shpjegon dhe dokumenton lidhjen e ngushtë familjare të të paraburgosurit apo të të dënuarit me personin e sëmurë rëndë, të vdekur, të lindur ose të martuar, kohëzgjatjen e vuajtjes së dënimit, lejet e kryera më parë, respektimin e rregullores së brendshme të I EVP-së, rrezikshmërinë dhe besueshmërinë që paraqet i paraburgosuri apo i dënuari, përmes qëndrimit të tij jashtë institucionit, pjesëmarrjen në programe rehabilituese, që zhvillohen në institucion, çdo të dhënë tjetër që ka të bëjë me të paraburgosurin apo të dënuarin, si dhe propozimin e argumentuar të miratimit apo të refuzimit të lejes së veçantë dhe të ditëve që duhet të marrë i paraburgosuri apo i dënuari, si leje e veçantë.

d) Raporti, propozimi dhe dokumentacioni i paraqiten brenda ditës drejtorit të I EVP-së, i cili e shqyrton dhe jep miratimin apo refuzimin e motivuar të lejes së veçantë.

dh) Leja e veçantë mund të miratohet nga drejtori i I EVP-së, vetëm pasi të ketë marrë mendimin pozitiv të tre sektorëve, hartues të raportit, në favor të miratimit të saj nga përgjegjësi i sektorit ligjor, përgjegjësi i sektorit të sigurisë dhe përgjegjësi i shërbimit social.

2. Drejtori i I EVP-së që jep lejen duhet të përcaktojë mënyrën, kushtet, mjetet e shoqërimit të të dënuarit, me forca të policisë së burgjeve dhe numrin e tyre. Leja e veçantë për të dënuarit jepet me kohëzgjatje deri në 48 orë dhe bëhet me shoqërim vetëm gjatë ditës.



3. Leja e veçantë mund të zgjatet me kërkesë të të dënuarit edhe 24 orë të tjera me miratimin e drejtorit të IEVP-së, vetëm për rastet e sëmundjeve të rënda, kundrejt dokumentacionit ligjor të paraqitur në institucion.

4. Lejet e veçanta për të paraburgosurit jepen sipas kërkesave të këtij neni, me miratimin e prokurorit dhe me shoqërim.

KREU XII PUNA NË IEVP

Neni 54 Punësimi

1. Të paraburgosurit apo të dënuarit kanë të drejtë të punojnë në përputhje me aftësitë fizike, shëndetësore dhe psikologjike.

2. Puna nuk ka karakter dënimi, por rehabilitimi dhe riintegrimi.

3. Aktet ligjore dhe nënligjore që shërbejnë për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë në punë, mirëqenies sociale dhe kohëzgjatjen e punës, si dhe ato që rregullojnë marrëdhëniet e punës, me përjashtim të ushtrimit të së drejtës për grevë dhe pjesëmarrje në sindikata, zbatohen njëlojtë edhe për të paraburgosurit e të dënuarit.

4. Personat e paraburgosur mund të punësohen:

a) duke lidhur kontratë pune me IEVP-në;

b) duke lidhur kontratë pune me persona të tretë juridikë, vendas apo të huaj, për punë e cila mund të kryhet brenda mjediseve të IEVP-së apo jashtë tij, me miratimin e drejtorit të IEVP-së;

c) duke u vetëpunësuar.

5. Të paraburgosurit apo të dënuarit që kanë probleme të shëndetit mendor mund të punësohen, kur kjo i shërben qëllimeve terapeutike. Vërtetimi i gjendjes së shëndetit mendor bëhet në bazë të raportit mjekësor përkatës, të lëshuar sipas legjislacionit në fuqi.

6. Drejtori i IEVP-së, ku do të zhvillohet aktiviteti i punës, sigurohet që i paraburgosuri apo i dënuari të punojë duke pasur parasysh formimin profesional, aftësitë fizike dhe mendore të tij. Me urdhër të drejtorit të IEVP-së, të paraburgosurit apo të dënuarit i kërkohet të marrë pjesë në parandalimin e katastrofave natyrore, epidemive, aksidenteve ose në eliminimin e pasojave të tyre.

7. Punësimi i të paraburgosurve apo të dënuarve të mitur mbështetet në kriteret ligjore të parashikuara në Kodin e Punës.

KREU XIII REHABILITIMI, PËRGATITJA PËR LIRIM DHE RI-INTEGRIM

Neni 55

Qëllimet e shërbimit social

1. Trajtimi human i të paraburgosurve dhe i të dënuarve bëhet duke siguruar mjediset dhe mjetet e përshtatshme, në përputhje me personalitetin, arsimin, gjendjen social-ekonomike, prirjet dhe aftësitë që ata kanë, duke synuar rehabilitimin për riintegrimin e tyre në jetën familjare, shoqërore dhe ekonomike dhe uljen e recidivizmit. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve zhvillon programe të cilat synojnë rehabilitimin dhe riintegrimin e këtyre personave në shoqëri.

2. Përgatitja për riintegrim fillon në paraburgim dhe vazhdon gjatë kryerjes së dënimit e pas lirimit nga burgu.

3. IEVP-të, në bashkëpunim me shërbimin e provës, shërbimet e mirëqenies sociale, institucionet vendore dhe organizatat jofitim-prurëse hartojnë programe riintegrimi për personat në prag lirimi për adresimin e çështjeve gjinore.

4. Për të paraburgosurit dhe të dënuarit që i përkasin minoriteteve etnike dhe gjuhësore, të huajt dhe personat pa shtetësi, për aq sa është e mundur, mundësohen programe që respektojnë kulturën e tyre.

5. Për realizimin e rehabilitimit social dhe riintegrimin të të paraburgosurve dhe të të dënuarve, IEVP-ja duhet të vërë në dispozicion të gjitha burimet e përshtatshme, duke realizuar përkrahjen morale, kualifikimin profesional, arsimimin, edukimin fizik, zhvillimin e aftësive shoqërore, këshillimin, pjesëmarrjen në aktivitete të përbashkëta dhe nxitjen e kontakteve me jashtë, në mënyrë që të zgjerohet perspektiva e riintegrimin shoqëror pas lirimit.

6. Administrata e burgut duhet të zhvillojë një vlerësim të kujdesshëm për të përcaktuar nëse të burgosur të caktuar paraqesin rrezik për dëmtimin e vetes apo të burgosurve të tjerë, personave që punojnë në burg ose që vizitojnë burgun ose komunitetit dhe mundësinë për t'u arratisur ose për të kryer një krim tjetër të rëndë ndërkohë që është me leje nga burgu ose i liruar.

7. Vlerësimi fillestar i rrezikut dhe i nevojave duhet të kryhet nga një personel i trajnuar në



mënyrë të përshtatshme dhe mundësisht të zhvillohet në një qendër vlerësimi.

8. Trajtimi i grupeve të veçanta të të paraburgosurve dhe të të dënuarve bëhet nga një personel i trajnuar për këto kategori.

Neni 56

Individualizimi i trajtimit

1. Individualizimi i trajtimit bëhet duke vlerësuar nevojat individuale psikologjike, shoqërore, të moshës, gjinore, gjendjen shëndetësore, orientimin seksual ose identitetin gjinor, situatën kulturore dhe ekonomike, mjedisin ku ka jetuar i paraburgosuri dhe i dënuari, veprën penale dhe faktorët e riskut dhe motivimin për t'u përfshirë në veprimtaritë që organizohen në institucion.

2. Personeli i shërbimit social vlerëson personalitetin e të paraburgosurit dhe të të dënuarit, me qëllim identifikimin e nevojave psikologjike e sociale, aftësinë dhe vullnetin e të paraburgosurit dhe të të dënuarit për punë e formim profesional. Në bazë të rezultatat të vëzhgimit dhe të të dhënave personale, familjare, shoqërore, të masës së dënimit, personeli i kujdesit social harton planin e riintegrit për çdo të paraburgosur dhe të dënuar dhe programin e individualizuar të trajtimit për grupe të veçanta, i cili përgatitet nga një grup specialistësh, i përbërë nga psikologë, punonjës socialë dhe edukatorë. Plani i riintegrit përfshin këshillim, terapi, edukim, arsimim, formim profesional, punësim, shërbim bibliotekar, si dhe çdo shërbim tjetër të nevojshëm.

3. Punonjësi i shërbimit social evidenton të dhënat e grumbulluara nga vëzhgimi, trajtimi individual, si dhe nga sjellja gjatë gjithë periudhës së burgimit, të përfshira në dosjen psiko-sociale të të paraburgosurit dhe të të dënuarit.

4. Punonjësi i shërbimit social diskuton me të paraburgosurin dhe të dënuarin planin e riintegrit dhe programin e individualizuar dhe bën rivlerësimin dhe ndryshimin në përputhje me ecurinë e trajtimit.

5. Rëndësi e veçantë i kushtohet trajtimit psiko-social të të paraburgosurve dhe të dënuarve të mitur, të rinjve 18 deri 21 vjeç, grave, personave me çrregullime të shëndetit mendor, të pasura ose të fituara gjatë burgimit, personave me aftësi të kufizuar, personave me orientim seksual të

ndryshëm, personave me sëmundje kronike ose të varur nga droga, të moshuarve, personave të dënuar me dënime afatgjata, personave që i përkasin minoriteteve etnike ose gjuhësore, shtetasve të huaj dhe personave pa shtetësi.

6. Planifikimi individual për menaxhimin e dënimit të përjetshëm ose afatgjatë të të burgosurit duhet të ketë si qëllim zhvillimin progresiv në sistemin e burgjeve.

7. Vëzhgimi, programimi dhe realizimi i trajtimit bëhen nga administrata e institucionit me anë të personelit të vet, në bashkëpunim me organet dhe institucionet shtetërore përkatëse.

8. Bashkëpunimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve me Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës për hartimin, zhvillimin, realizimin e programeve të mbikëqyrjes të të paraburgosurve dhe të të dënuarve bëhet me urdhër të nxjerrë nga ministri i Drejtësisë.

9. Kontributi i organizatave jofitimprurëse dhe individëve të veçantë nxitet dhe mbështetet nga administrata e burgjeve në realizimin e programit të trajtimit.

Neni 57

Prindërimi në distancë

1. Prindërimi në distancë synon forcimin e marrëdhënieve me familjen dhe përgatitjen për riintegrim me përqendrim të veçantë tek të miturit dhe gratë.

2. Prindërimi në distancë zhvillohet në mjedise të veçanta të institucionit, të përshtatura për zbatimin e këtij programi, ku të dënuarit dhe të paraburgosurit shpenzojnë deri në 8 orë me familjen.

Neni 58

Pjesëmarrja në aktivitete dhe veprimtari kulturore, çlodhëse e sportive

1. Procesi i edukimit përfshin edhe programe të trajtimit në grup të të paraburgosurve dhe të të dënuarve, duke u dhënë mundësi atyre të marrin pjesë në aktivitete të ndryshme të institucionit, të cilat i ndihmojnë të zhvillojnë ndjenjën e përgjegjësisë, vetëbesimit, si dhe të nxitin interesin për arsimim, formim profesional, veprimtari kulturore, çlodhëse e sportive, punë etj.

2. Administrata e institucionit bashkëpunon me institucionet e tjera, organizatat jofitimprurëse e ato fetare për organizimin e veprimtarive kulturore,



krijuese dhe sportive, brenda dhe jashtë institucionit.

Neni 59

Shërbimi bibliotekar

1. Në çdo IEVP funksionon një bibliotekë për përdorim nga të gjithë të paraburgosurit dhe të dënuarit.

2. Shërbimi i bibliotekës organizohet dhe mbikëqyret nga personeli përgjegjës, i cili kujdeset për mirëmbajtjen dhe pasurimin e saj, shpërndarjen e literaturës dhe përhapjen e dijes e të kulturës.

3. Në përzgjedhjen e literaturës duhet të mbahet parasysh sigurimi sa më i mirë i nivelit shkencor, kulturor dhe artistik.

4. Favorizohet leximi pa kufizim i botimeve dhe përdorimi i sistemeve të tjera informative të bibliotekës së institucionit.

5. Çdo bibliotekë në institucion duhet të ketë literaturë për të drejtat dhe trajtimin e të paraburgosurve dhe të dënuarve, legjislationin bazë penal, procedural penal dhe në fushën e trajtimit të të paraburgosurve dhe të dënuarve.

KREU XIV

ARSIMI DHE FORMIMI PROFESIONAL

Neni 60

Arsimimi

1. Të paraburgosurit apo të dënuarit, që nuk e ka përfunduar arsimin nëntëvjeçar, i krijohen kushte për përfundimin e tij me anë të një programi të veçantë, të miratuar nga ministria përgjegjëse për çështjet e arsimit.

2. Mësimdhënia realizohet nga mësues. Në përfundim, i paraburgosuri apo i dënuari pajiset me dokumentin që vërteton përfundimin e arsimimit dhe rezultatet e tij.

3. I paraburgosuri apo i dënuari nxitet të marrë pjesë për arsimimin në nivele më të larta brenda dhe jashtë IEVP-së. Për të paraburgosurit apo të dënuarit që studiojnë në nivelin 9-vjeçar dhe të mesëm, IEVP-ja merr përsipër mbulimin e shpenzimeve për arsimim.

Neni 61

Kurset profesionale

1. Administrata e institucionit nxit dhe krijon kushtet për formimin profesional brenda dhe jashtë

institucionit. Mësimdhënia në këto kurse realizohet nga profesionistë dhe dhënia e autorizimit përkatës bëhet nga drejtori i IEVP-së.

2. Kujdes i veçantë i kushtohet formimit kulturor e profesional të të paraburgosurve dhe të të dënuarve me moshë nën 25 vjeç.

3. Të dënuarve dhe të paraburgosurve, që u përkasin minoriteteve etnike ose gjuhësore, që nuk e kuptojnë ose zotërojnë gjuhën shqipe dhe të dënuarve të huaj, u mundësohen materiale të shkruara në gjuhën e tyre ose në një gjuhë që e kuptojnë më mirë.

4. I paraburgosuri dhe i dënuari nxitet për frekuentimin e kurseve të formimit profesional.

Neni 62

Liria e shprehjes dhe besimit

1. Liria e mendimit, ndërgjegjes dhe e besimit respektohen.

2. Programi institucional organizohet në mënyrë të tillë që për aq sa është e mundur t'u lejojë praktikimin e fesë dhe ndjekjen e besimit të tyre, marrjen pjesë në shërbesa apo mbledhje të drejtuara nga përfaqësues fetarë të miratuar nga institucioni, zhvillimin e takimeve me këta përfaqësues pa praninë e personelit të IEVP-së dhe mundësinë e mbajtjes së librave që lidhen me fenë apo besimin.

3. Të miturit nuk mund të detyrohen të praktikojnë një fe, të ndjekin një besim apo të marrin pjesë në shërbesa fetare ose të pranojnë takime nga përfaqësues fetarë.

4. Praktikimi apo ushtrimi i besimit bëhet përmes monitorimit të psikologut të institucionit.

Neni 63

Përgatitja për lirim dhe riintegrim

1. Përgatitja e të paraburgosurit apo e të dënuarit për lirim bëhet që në paraburgim dhe ka për qëllim të veçantë uljen e recidivizmit.

2. Shërbimi social, rast pas rasti, jo më vonë se 6 muaj nga dita e lirim, harton dhe zhvillon një program të veçantë trajtimi paralirimi, duke bashkëpunuar edhe me institucionet vendore, Shërbimin e Provës, OJF-të, familjen dhe aktorë të tjerë.



KREU XV
SHOQËRIMI JASHTË IEVP-SË DHE
TRANSFERIMI

Neni 64
Shoqërimi jashtë IEVP-së

1. Shoqërimi i të paraburgosurve apo i të dënuarve jashtë IEVP-së kryhet nga grupet e sigurisë dhe shoqërimit.

2. Shoqërimi i grave të paraburgosura apo të dënuara kryhet nga personeli i së njëjtës gjini, ndërsa shoqërimi i të sëmurve kryhet me praninë e personelit mjekësor.

3. Gjatë shoqërimit tregohet kujdesi i duhur për ta ekspozuar sa më pak të paraburgosurin ose të dënuarin në sytë e njerëzve, duke marrë masa mbrojtëse për të siguruar anonimin.

4. Në të gjitha rastet, shoqërimi i të paraburgosurit apo i të dënuarit bëhet me dokumentacionin përkatës.

5. Në rastet e transferimeve të të paraburgosurve apo të të dënuarve, institucioni u lejon atyre njohimin e familjarëve. Nëse i paraburgosuri apo i dënuari nuk ka mundësi financiare, institucioni u krijon kushte për kryerjen e njohimit.

Neni 65
Kërkesa për transferim

1. Kërkesa për transferim mund të paraqitet nga i paraburgosuri dhe i dënuari ose familjarët e tij, për arsye shëndetësore, familjare, shkaqe që kanë të bëjnë me formimin profesional, kur i rrezikohet jeta ose shëndeti, si dhe për shkak të afërsisë me vendbanimin e familjarëve të tij.

2. Kërkesa për transferimin e të paraburgosurit dhe të të dënuarit mund të paraqitet nga prokurori i çështjes për nevojë të hetimit e të gjyqimit.

3. Kërkesa për transferimin e të paraburgosurit apo të të dënuarit mund të paraqitet nga drejtori i IEVP-së në rastet e mbipopullimit në IEVP, për arsye sigurie kur rrezikohet jeta ose shëndeti i të paraburgosurit nga të tjerë, si dhe për të gjitha rastet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni.

4. Të paraburgosurit dhe të dënuarit transferohen së bashku me sendet vetjake, dosjen personale dhe dosjen psiko-sociale.

5. Transferimi i të paraburgosurve dhe i të dënuarve nuk mund të kryhet nëse nuk janë të shoqëruar me dokumentacionin përkatës.

Neni 66

Shqyrtimi i kërkesës për transferim

1. Me paraqitjen e kërkesës për transferimin e të paraburgosurit apo të të dënuarit, drejtori i IEVP-së e regjistron menjëherë kërkesën në një regjister të veçantë dhe urdhëron përkatësisht sektorin ligjor, sektorin e ruajtjes dhe sigurisë, sektorin e kujdesit shëndetësor apo sektorin e kujdesit social që, brenda një afati 5 - ditor nga dita e regjistrimit të kërkesës, të përgatitë një raport të hollësishëm sipas argumentimit të paraqitur në kërkesë.

a) Kur kërkesa për transferim bazohet në arsye të rënda sigurie, kur rrezikohet jeta ose shëndeti i të paraburgosurit apo të dënuarit nga të tjerët, ose kur ka mbipopullim në IEVP, sektori i sigurisë përgatit një raport të arsyetuar dhe të hollësishëm ku jepen të dhëna dhe prova për vërtetimin e shkakut për transferimin e të paraburgosurit apo të të dënuarit;

b) Kur kërkesa për transferim bazohet në nevojat e hetimit dhe gjyqimit, sektori ligjor përgatit një raport të arsyetuar dhe të hollësishëm, ku jepen të dhëna mbi gjendjen gjyqësore të të paraburgosurit apo të të dënuarit, dinamikën e vuajtjes së dënimit, si dhe për referencat zyrtare të ardhura nga organet e drejtësisë ku është kërkuar transferimi i të paraburgosurit apo të dënuarit;

c) Kur kërkesa për transferim bazohet në shkaqe shëndetësore, sektori i kujdesit shëndetësor përgatit një raport të arsyetuar dhe të hollësishëm ku jepen të dhënat e nevojshme mbi gjendjen shëndetësore të të paraburgosurit apo të të dënuarit, raportet dhe analizat mjekësore që vërtetojnë gjendjen e të paraburgosurit dhe të të dënuarit, si dhe nevojën shëndetësore për transferimin e tij;

ç) Kur kërkesa për transferim bazohet në shkaqe familjare, të formimit profesional, si dhe në afërsinë me vendbanimin e familjarëve të tij, sektori i kujdesit social përgatit një raport të arsyetuar dhe të hollësishëm, ku jepen të dhëna për gjendjen familjare, vendbanimin e familjarëve të të paraburgosurit apo të të dënuarit, gjendjen sociale, arsimore dhe profesionale të tij, si dhe për referencat zyrtare të ardhura nga institucionet e tjera shtetërore, të cilat vërtetojnë shkakun familjar, të vendbanimit të familjarëve, si dhe formimin profesional.



d) Për kërkesat për transferim sipas shkronjave “c” dhe “ç” bëhet vlerësimi i riskut nga sektori i policisë, sipas masave të sigurisë.

2. I EVP-ja ku ndodhet i paraburgosuri apo i dënuari mund të kërkojë nga institucionet e tjera shtetërore të dhëna provuese apo shtesë lidhur me shkaktuesin e transferimit të të burgosurit, të cilat i bashkëlidhen raportit.

3. Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, që nga momenti i regjistrimit të kërkesës pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve:

a) vlerëson mundësinë e transferimit të të paraburgosurit apo të të dënuarit bazuar në kriteret ligjore;

b) analizon rrezikshmërinë bazuar në vlerësimin e riskut të të paraburgosurit apo të të dënuarit;

c) përcakton I EVP-në ku do të transferohet i paraburgosuri apo i dënuari.

4. Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve nxjerr urdhrin për transferimin e të paraburgosurit apo të të dënuarit. Në rast të refuzimit të kërkesës, i paraburgosuri apo i dënuari njoftohet me shkrim. Ai ka të drejtë ta ankimojë atë tek ministri i Drejtësisë, brenda 15 ditëve nga vënia e tij në dijeni për refuzimin e kërkesës.

Neni 67

Transferimi i të paraburgosurve dhe të dënuarve

1. Transferimi i të paraburgosurve apo i të dënuarve kryhet duke zbatuar masat e sigurisë dhe duke respektuar dinjitetin e tij.

2. Transferimi i të paraburgosurve apo i të dënuarve kryhet me mjete transporti që krijojnë kushte të përshtatshme për transferim.

3. I paraburgosuri apo i dënuari, përpara se të transferohet i nënshtrohet kontrollit personal dhe vizitohet nga mjeku, i cili verifikon gjendjen psikofizike të tij dhe konkludon nëse është në gjendje të përballojë udhëtimin. Në qoftë se i paraburgosuri dhe i dënuari nuk mund të përballojë udhëtimin, drejtori i I EVP-së njofton drejtorin e Përgjithshëm, i cili vlerëson kryerjen e transferimit në një kohë tjetër.

4. Në çdo rast të kryerjes së transferimeve të të paraburgosurve apo të të dënuarve, personeli i policisë harton dhe administron procesverbalet e marrjes në dorëzim dhe të dorëzimit të të paraburgosurit apo të të dënuarit dhe të sendeve të tij personale.

KREU XVI GRATË E DËNUARA

Neni 68

Parime të përgjithshme

1. Gratë e dënuara apo të paraburgosura trajtohen pa diskriminim dhe duke marrë parasysh nevojat dalluese gjinore. Marrja parasysh e këtyre nevojave, me synimin e arritjes së një barazie gjinore, nuk konsiderohet si diskriminim.

2. Grave të dënuara apo të paraburgosura të porsaardhura iu sigurohen lehtësira për të kontaktuar me të afërmit e tyre, mundësi për këshillim ligjor, informacion në një gjuhë të kuptueshme mbi rregullat e brendshme të institucionit dhe regjimin e burgut, si dhe ku të drejtohen për ndihmë në rast nevojë.

3. Shtetaseve të huaja u ofrohen gjithashtu mundësi për të kontaktuar përfaqësitë konsullore.

Neni 69

Gratë e dënuara me fëmijë deri në 3 vjeç

1. Grave me fëmijë deri në 3 vjeç, për shkak të situatës së veçantë të tyre, u kushtohet një vëmendje e veçantë gjatë procedurave të pranimit në institucion.

2. Gjatë pranimit ose kryerjes së dënimit të grave me përgjegjësi për kujdesjeje për fëmijë të kësaj grup-moshe, institucioni duke marrë parasysh interesin më të lartë të fëmijës ndihmon lidhur me marrëveshjen për fëmijën.

3. Të dhënat personale të fëmijës të së paraburgosurës dhe të së dënuarës që pranohet në institucion regjistrohen gjatë pranimit të së dënuarës. Regjistri përfshin të paktën emrin dhe moshën e fëmijës, si dhe të dhëna të tjera në bazë të legjislacionit në fuqi për të dhënat personale.

4. Për fëmijët deri në 3 vjeç, që nuk shoqërojnë nënën në institucion, regjistrohet vendndodhja dhe statusi i kujdestarisë.

5. I gjithë informacioni që lidhet me identitetin e fëmijës ruhet si konfidencial, dhe përdorimi i këtij informacioni duhet të jetë gjithmonë në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

6. Sistemimi i fëmijës bëhet në seksione të veçanta për nënat me fëmijë brenda I EVP-së, me personel të kualifikuar.



7. Kur fëmijët arrijnë moshën 3-vjeçare ose për arsye të tjera të ligjshme, sistemimi i tyre bëhet sipas rregullave të përcaktuara në Kodin e Familjes.

Neni 70

Asistenca gjatë periudhës së shtatzënisë dhe menjëherë pas lindjes

1. Gratë shtatzëna dha ato lehona të paraburgosura apo të dënuara ndihmohen dhe trajtohen në qendra të specializuara të obstetrigjinekologjisë jashtë IEVP-ve, gjatë periudhës së shtatzënisë, gjatë dhe pas lindjes.

2. Ndihma mjekësore për fëmijët e nënave të paraburgosura dhe të dënuara jepet nga specialistë të pediatriës.

3. Kur një fëmijë lind në IEVP, ky fakt nuk pasqyrohet në certifikatën e lindjes së tij.

Neni 71

Vendosja

Gratë e dënuara apo të paraburgosura vendosen në institucione të veçuara nga burrat dhe mbahen në mbikëqyrjen dhe kujdesin e personelit femëror. Vendosja e tyre bëhet, brenda mundësive, në institucione që ndodhen afër vendbanimit të tyre ose vendeve të rehabilitimit shoqëror, duke marrë parasysh përgjegjësitë e tyre përkujdesëse, si dhe pëlqimin individual të gruas dhe disponueshmërinë e programeve e të shërbimeve të përshtatshme.

Neni 72

Higjiena personale

Për gratë e dënuara apo të paraburgosura duhet të ketë lehtësira dhe materiale të nevojshme për plotësimin e nevojave specifike të higjienës së grave, duke përfshirë peshqirë sanitare falas dhe furnizim të rregullt me ujë për kujdesin personal të fëmijëve dhe grave, në veçanti gratë që kanë fëmijë deri në 3 vjeç dhe janë shtatzëna.

Neni 73

Shërbimet e kujdesit shëndetësor për gratë

1. Kujdesi shëndetësor i grave të dënuara apo të paraburgosura ofrohet mbështetur në nevojat specifike gjinore dhe përfshin kontroll të plotë për të përcaktuar nevojat e kujdesit shëndetësor parësor.

2. Kontrolli mjekësor i grave të dënuara apo të paraburgosura duhet të përfshijë kontroll

gjithëpërfshirës për të përcaktuar nevojat parësore të kujdesit shëndetësor dhe gjithashtu duhet të përcaktojë:

a) praninë e sëmundjeve seksualisht të transmetueshme ose sëmundjeve të mbartura nëpërmjet gjakut dhe, në varësi të faktorëve të riskut, grave të dënuara mund t'u ofrohen teste për HIV-in, me këshillim para dhe pas testit;

b) nevojat e kujdesit të shëndetit mendor, duke përfshirë çrregullimin e stresit posttraumatik dhe rrezikun e vetëdëmtimit dhe/apo vetëvrasjes;

c) historinë e shëndetit riprodhues të gruas së dënuar, duke përfshirë shtatzëni ekzistuese ose të fundit, si dhe problematika në lindje dhe të tjera të lidhura me shëndetin riprodhues;

ç) ekzistencën e varësisë nga droga;

d) abuzimin seksual dhe format e tjera të dhunës të pësura para pranimit.

3. Të dënuarave apo të paraburgosurave të mitura u garantohen programe dhe shërbime specifike me qasje sipas moshës dhe gjinisë. Ato informohen në një gjuhë të kuptueshme për kujdesin shëndetësor për parandalimin e sëmundjeve të ndryshme, higjienën vetjake, për format e dhunës dhe çdo lloj abuzimi.

4. Gratë dhe të miturat, që kanë pasur përvoja të dhunës fizike, psikologjike, seksuale, u nënshtrohen programeve të kujdesit shëndetësor për trajtimin dhe rehabilitimin e tyre.

KREU XVII

MBROJTJA DHE TRAJTIMI I TË MITURVE TË PRIVUAR NGA LIRIA

Neni 74

Parime të përgjithshme

1. Të dënuarit apo të paraburgosurit e mitur trajtohen duke respektuar liritë dhe të drejtat e tyre themelore. Trajtimi mbështetet në parimin e interesit më të lartë të fëmijës, të integritetit shoqëror, edukimit dhe parandalimit të rifutjes në krim.

2. Të miturve të privuar nga liria u garantohen veprimtari dhe programe, sipas një plani individual, që nxitin zhvillimin e tyre fizik dhe mendor, vetërespektin, ndjenjën e përgjegjësisë dhe zhvillojnë tek ata sjellje e aftësi për parandalimin dhe kryerjen sërish të krimeve (recidivizmin).

3. Të miturit e privuar nga liria nxiten të marrin pjesë në diskutimet për kushtet e përgjithshme dhe



regjimin në institucione dhe të komunikojnë individualisht ose në grup, sipas rastit, me autoritetet për këto çështje.

Neni 75

Organizimi institucional për të miturit

1. Të miturit, si rregull, e kryejnë dënimin në institucione të posaçme vetëm për ta dhe, në pamundësi, në seksione të veçanta në IIEVP të tjera.

2. Institucionet për të miturit apo seksionet për të miturit në IIEVP sigurojnë lehtësi për të plotësuar nevojat individuale të të miturve të privuar nga liria.

3. Institucionet për të miturit apo seksionet për të miturit në IIEVP zbatojnë shkallën më të ulët të sigurisë dhe kontrollit, aq sa është e nevojshme për mbrojtjen e të miturve nga shkaktimi i vetëdëmtimeve apo shkaktimi i dëmit ndaj personelit apo të tjerëve.

4. Institucionet për të miturit apo seksionet për të miturit në IIEVP ndërtohen ose organizohen për të përmbushur qëllimin rehabilitues nga privimi i lirisë, duke pasur parasysh të drejtën e të miturit për privatësi, stimulim shqisor, mundësi për shoqërizim me të miturit e tjerë, pjesëmarrje në sporte, ushtrime fizike dhe argëtim.

Neni 76

Personeli në institucionet për të miturit

1. Personeli përzgjidhet me kujdes në mënyrë që t'u sigurojë të miturve një rol dhe model pozitiv.

2. Personeli që punon me të miturit trajnohet në çështje të psikologjisë të të miturve, mirëqenies të të miturve dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e të miturve.

Neni 77

Vendosja në institucione

1. Vendosja e kategorive të ndryshme të të miturve në institucione bëhet në bazë të nevojave të veçanta dhe mbrojtjes së integritetit fizik, mendor si edhe mirëqenies të të miturit.

2. Të miturit vendosen në institucione që janë pranë vendbanimit të familjes së tyre apo vendeve që shërbejnë për riintegrimin e tyre shoqëror.

3. Aq sa është e mundur, të miturit dhe, sipas rastit, prindërit apo kujdestari ligjor i të miturit

këshillohen për transferimin e të miturit nga një institucion në tjetrin.

4. Transporti i të miturit kryhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, duke respektuar dinjitetin e tyre dhe garantuar me mjete transporti që sigurojnë ventilim dhe ndriçim të përshtatshëm.

Neni 78

Pranimi në institucion i të miturit

1. Në momentin e pranimi, të miturit informohen për rregulloren e brendshme të institucionit dhe për të drejtat e detyrimet e tij në një gjuhë dhe mënyrë të kuptueshme.

2. Për të paraburgosurit dhe të dënuarit e mitur që nuk dinë shkrim e lexim, komunikimi i akteve bëhet me gojë nga personeli përgjegjës, sipas shërbimeve.

3. Njoftimi i vendosjes të të miturit në institucion, si edhe informimi mbi rregulloren e institucionit apo çdo informacion tjetër i nevojshëm i jepet menjëherë prindërve apo përfaqësuesit ligjor të të miturit.

4. Menjëherë pas pranimi, i mituri i nënshtrohet kontrollit mjekësor nga personeli mjekësor brenda 24 orëve dhe për të hapet dosja mjekësore, ku regjistrohet trajtimi i sëmundjeve apo dëmtimeve. Në regjistrin e kontrollit mjekësor në kohën e pranimi shënohen me saktësi data dhe ora e kontrollit dhe i mituri nënshkruan. Ky kontroll përfshin kontrollin për sëmundjet ngjitëse.

Neni 79

Veprimet menjëherë pas pranimi

1. Menjëherë pas pranimi, i mituri intervistohet nga personeli i sektorit social, i cili përgatit një raport psikologjik dhe social që identifikon nivelin e përkujdesjes dhe programin individual për të miturin. Ky raport, së bashku me raportin e përgatitur nga mjeku që ka kontrolluar të miturin menjëherë pas pranimi, i dërgohen drejtorit të IIEVP-së.

2. Për vendosjen e të miturit në institucion, merr vendim drejtori i IIEVP-së, i cili përcakton nivelin e përshtatshëm të sigurisë, që mund të rishikohet më pas dhe llojin e programit individual për të.

3. Me përjashtim të rasteve kur periudhat e privimit të lirisë janë shumë të shkurtra, për çdo të mitur hartohet një program arsimimi dhe trajnimi në përputhje me karakteristikat individuale të të miturit brenda katër javëve nga



koha e pranimit në institucion duke marrë mendimet e të miturit. Në mungesë të përfundimit të një programi të plotë, drejtori i institucionit merr masa që i mituri të fillojë programin shkollor në mënyrë të menjëhershme.

Neni 80

Klasifikimi dhe vendosja nëpër dhoma

1. Në çdo institucion ku vendosen të mitur, ngrihet dhe funksionon një sistem vlerësimi për klasifikimin e të miturve në përputhje me nevojat e tyre edukuese, zhvillimore dhe të sigurisë.

2. Kriteri kryesor për klasifikimin e kategorive të ndryshme të të miturve është lloji i përkujdesjes që i përmbush më mirë nevojat individuale të një të mituri, si edhe mbrojtja e integritetit dhe mirëqenies së tyre fizike, mendore e morale.

3. Të miturit duhet të këshillohen përpara se të ndajnë dhomën dhe atyre u jepet mundësia të tregojnë se me cilin të mitur dëshirojnë të ndajnë dhomën.

4. Personeli i IEVP-së garanton mbikëqyrje të rregullt dhe diskrete të të gjitha dhomave, veçanërisht gjatë natës, për të siguruar mbrojtjen e çdo të mituri.

Neni 81

Dosja shëndetësore

1. Mjeku pranë IEVP-së hap një dosje shëndetësore për çdo të mitur, e cila është konfidenciale.

2. Dosja përmban informacion diagnostifikues (përfshi rezultatet e ekzaminimeve të veçanta të pacientit) si edhe të dhëna për gjendjen e shëndetit fizik dhe mendor dhe të trajtimeve që ka marrë.

3. I mituri, prindi, kujdestari apo mbrojtësi ligjor, në bazë të kërkesës, kanë mundësi të këshillohen me dosjen mjekësore të të miturit, me përjashtim kur kjo nuk është e këshillueshme nga një këndvështrim terapeutik.

4. Në rast transferimi, dosja mjekësore dorëzohet tek personeli mjekësor i institucionit pritës, dhe në rast lirimi, dosja mjekësore, me pranimin e të miturit, prindit, apo kujdestarit ligjor, i dorëzohet mjekut të familjes në komunitet.

Neni 82

Higjiena

1. Drejtori i IEVP-së merr masa që institucioni

për të mitur të mirëmbahet dhe të jetë i pastër në çdo kohë.

2. Të miturit duhet të kenë akses të menjëhershëm në tualete dhe dushe, që janë të pastra dhe që respektojnë privatësinë.

3. Të miturve u garantohej të bëjnë dush individual, nëse është e mundur, çdo ditë, në një temperaturë që është e përshtatshme me kushtet atmosferike.

4. Të miturit ruajnë higjienën vetjake, të veshjeve dhe të dhomave të tyre. Drejtori i IEVP-së merr masa që të miturve t'u mësohet si të veprojnë për ruajtjen e higjienës.

Neni 83

Shëndeti

1. Kujdesi shëndetësor ndaj të miturve të privuar nga liria sigurohet sipas standardeve mjekësore që zbatohen ndaj të miturve në komunitet.

2. Çdo të mituri i sigurohet kujdes shëndetësor i përshtatshëm, parandalues dhe kurues, ku përfshihen shërbimi stomatologjik, oftalmologjik dhe i shëndetit mendor, produkte farmaceutike dhe dieta të veçanta sipas vlerësimit të mjekut dhe edukim shëndetësor.

3. Sa herë të jetë e mundur, kujdesi mjekësor i sigurohet të miturit përmes shërbimit mjekësor që ofrohet në komunitetin ku ndodhet IEVP-ja, me qëllim parandalimin e stigmatizimit, nxitjen e respektit për veten dhe integritetit të të miturit në komunitet.

4. Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve harton dhe zbaton politika për të parandaluar vetëvrasjet dhe vetëdëmtimet nga të miturit, veçanërisht gjatë fazës menjëherë pas privimit nga liria, të veçimit dhe periudhave të tjera me rrezik të lartë.

5. Ndaj të miturve të privuar nga liria zbatohen të njëjtat parime etike dhe parime të shprehjes së vullnetit, që rregullojnë ndërhyrjet mjekësore në shoqërinë e lirë. Për çdo trajtim mjekësor apo ilaç të dhënë mbahet një regjistër i veçantë.

6. Në IEVP-të për të miturit u kushtohet vëmendje e veçantë nevojave të:

a) të miturve më të vegjël;

b) vajzave shtatzëna dhe nënave me fëmijë bebe;

c) të miturve që janë të varur nga lëndët narkotike apo alkoolike;

ç) personave me HIV/AIDS;



d) të miturve me aftësi të kufizuar fizike dhe mendore;

dh) të miturve të cilët janë të privuar nga liria për periudha të gjata kohore;

e) të miturve të cilët kanë provuar abuzim fizik, mendor apo seksual;

ë) të miturve që i përkasin komunitetit LGBT;

f) grupeve të tjera veçanërisht vulnerabël.

7. Të miturit me çrregullime të shëndetit mendor trajtohen nga psikiatër dhe psikologë të specializuar në çështje të shëndetit mendor të të miturve.

8. Shërbimet mjekësore të ofruara për të miturit janë pjesë integrale e një programi përkujdesi multidisiplinor.

9. IEVP-ja merr masat e nevojshme për koordinimin e afërt të punës ndërmjet personelit të shërbimit mjekësor, psikologjik, social dhe arsimor në IEVP, të cilët kanë kontakte të rregullta me të miturit.

10. Në rastet kur personeli mjekësor ka arsye të besojë se shëndeti fizik dhe mendor i një të mituri është dëmtuar ose do të dëmtohet për shkak të privimit nga liria, nga grevat e urisë apo kushtet e privimit nga liria, i raporton menjëherë drejtorit të IEVP-së.

Neni 84

Parandalimi i dhunës ndaj të miturve dhe trajtimi i viktimave

1. IEVP-ja merr masa dhe tregon kujdes të veçantë për nevojat e të miturve që kanë përjetuar dhunë fizike, mendore ose seksuale, si dhe për parandalimin e dhunës ndaj të miturve në institucion.

2. IEVP-ja merr masat e mëposhtme:

a) Kujdeset që të gjitha ndërhyrjet e planifikuara nga grupet e ndërhyrjes speciale të regjistrohen në video.

b) Në asnjë rast, nuk vendos një të mitur të privuar nga liria në pozicionin e ushtrimit të autoritetit ndaj të miturve të tjerë.

c) Në rast të pretendimeve për ushtrim dhune nga një punonjës i policisë së burgjeve, merren masa të menjëhershme, të cilat e shmangin nga kontaktet e drejtpërdrejta me të miturin, derisa të përfundojë procesi i vlerësimit të këtyre pretendimeve.

ç) Nëse një i mitur i privuar nga liria pretendon se ndaj tij është ushtruar dhunë nga të

burgosur/të paraburgosur të tjerë, ky i mitur vendoset në një akomodim alternativ apo kryen ajrimin duke shmangur kontaktet e drejtpërdrejta me të burgosurin/të paraburgosurin që pretendohet se ka ushtruar dhunë, derisa të përfundojë procesi i vlerësimit të pretendimeve.

Neni 85

Detyrat e mjekut në rast të dëmtimeve traumatike të të miturit

1. Në rast se konstatohen dëmtime traumatike, mjeku pranë IEVP-së regjistron konstatimet e bëra gjatë kontrollit mjekësor në një procesverbal të veçantë. Ky procesverbal mbahet në dosjen mjekësore të të miturit.

2. Në këtë procesverbal, mjeku shënon:

a) përshkrime të hollësishme për pjesët e trupit ku konstatohen dëmtimet traumatike;

b) deklarin e bërë nga i mituri gjatë kontrollit mjekësor, ku përfshihet përshkrimi për gjendjen shëndetësore dhe çdo pretendim për keqtrajtime;

c) një përshkrim të gjetjeve mjekësore objektive bazuar në një kontroll tërësor;

ç) përfundimet e kontrollit mjekësor, të cilat tregojnë shkallën e përputhshmërisë ndërmjet pretendimeve të ngritura nga i mituri dhe gjetjeve mjekësore objektive.

3. Nëse është e mundur, personeli mjekësor bën fotografi të këtyre dëmtimeve, të cilat vendosen në dosjen mjekësore të të miturit.

4. Një kopje e këtij procesverbali i jepet të miturit, prindit ose kujdestarit, si edhe mbrojtësit të tij ligjor. Në çdo rast marrësi i procesverbalit nënshkruan për njoftimin.

5. Në rast se vëren dëmtime traumatike të të miturit, mjeku e referon menjëherë të miturin tek psikologu i IEVP-së.

6. Mjeku i raporton menjëherë drejtorit të IEVP-së dhe prokurorit për të gjitha rastet e dëmtimeve traumatike të të miturve, pavarësisht se nga çfarë janë shkaktuar.

Neni 86

Plani individual i trajtimit dhe realizimi i tij

1. Për çdo të mitur të privuar nga liria hartohet një plan individual rehabilitimi dhe riintegrimi, duke marrë në konsideratë vlerësimin psikologjik, situatën emocionale, nivelin arsimor, dëshirat dhe mundësitë e tij për të ndjekur kurse profesionale



ose për të përparuar në arsimim. Ky plan individual trajtimi realizohet në bashkëpunim me të miturin.

2. Plani i trajtimit përfshin, ndër të tjera,;

- a) arsimin;
- b) kurse profesionale;
- c) terapi në punë;
- ç) edukim qytetar;
- d) trajnim për aftësim social;
- dh) menaxhim të agresionit apo zemërimit;
- e) terapi kundër varësisë nga drogat;
- ë) terapi individuale apo në grup;
- f) edukim fizik dhe sporte;
- g) programe të drejtësisë restorative dhe reparacioneve për veprën penale të kryer;
- gj) aktivitetet krijuese të kohës së lirë;
- h) veprimtari jashtë institucionit në komunitet, dhënia e lejeve ditore apo formave të tjera të lejeve,
- i) përgatitja për lirim dhe riintegrim.

3. Plani i trajtimit zbatohet dhe përditësohet rregullisht me pjesëmarrjen e të miturit, të mësuesve dhe aq sa është e mundur të prindit dhe të përfaqësuesit ligjor.

4. Programi ditor parashikon që të miturit të kalojnë sa më shumë orë të munden jashtë fjetores dhe aq sa janë të nevojshme për një nivel të përshtatshëm ndërveprimi social.

5. Vëzhgimi, programi dhe realizimi i trajtimit bëhen nga administrata e institucionit me anë të personelit të vet, në bashkëpunim me strukturat dhe institucionet shtetërore përkatëse.

6. Programet e mbikëqyrjes të të miturve të privuar nga liria hartohen, zhvillohen dhe realizohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës.

7. Kontributi i organizatave jofitimprurëse dhe individëve të veçantë nxitet dhe mbështetet nga administrata e burgjeve në realizimin e programit të trajtimit.

8. Drejtori i IEVP-së merr masa që institucioni të organizojë veprimtari edhe gjatë fundjavave dhe ditëve të festave.

Neni 87

Arsimi dhe formimi profesional

1. Çdo i mitur, i cili nuk ka përfunduar arsimimin e detyrueshëm, ka të drejtë të arsimohet sipas nevojave dhe aftësive të tij, mbi bazën e një programi arsimor që e përgatit për t'u riintegruar në shoqëri.

2. Nëse është e mundur, ky arsimim duhet të kryhet në shkollat publike që ndodhen pranë IEVP-së dhe në çdo rast nga mësues të kualifikuar përmes programeve të integruara me sistemin arsimor, në mënyrë që pas lirit, i mituri të vazhdojë shkollimin pa vështirësi.

3. Për të miturit e paraburgosur apo të dënuar merren masa që të mos e ndërpresin vazhdimin e arsimit të detyruar.

4. Drejtuesi i IEVP-së merr masa që të garantojë regjistrimin e të miturve në shkollën pranë IEVP-së dhe transferimin e tyre për zhvillimin mësimor.

5. Dëftesat apo certifikatat që i jepen të miturit të privuar nga liria nuk duhet të tregojnë në asnjë rast apo mënyrë që personi ka qenë në një institucion të privimit nga liria.

6. Nëse nuk është e mundur që të miturit të ndjekin shkollën apo qendrat e trajnimit jashtë institucionit, ky arsimim dhe kualifikim bëhet brenda IEVP-së, sipas rastit, nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e Ministrisë së Arsimit dhe Shërbimit Shtetëror të Punësimit. Drejtori i IEVP-së merr masa që mësuesit e caktuar për mësimdhënie pranë IEVP-së të kenë akses të garantuar dhe të zhvillojnë normalisht mësimin në IEVP.

Neni 88

Ajrimi i të miturve

1. Të miturit e paraburgosur/të dënuar lejohen të ushtrohen rregullisht për të paktën 3 orë në ditë, prej të cilave një orë duhet të jetë në një mjedis të hapur, nëse e lejojnë kushtet atmosferike.

2. Koha e ajrimit mund të reduktohet, por jo më pak se 2 orë në ditë, për shkaqe të jashtëzakonshme dhe vetëm me urdhër të drejtorit të institucionit.

3. Ajrimi për të miturit kryhet veçmas nga të rriturit.

Neni 89

Punësimi i të miturve

1. Drejtori i IEVP-së merr masa që për të miturit të sigurohet punë me karakter arsimor dhe profesional, me qëllim që ata të kenë mundësi të gjejnë punësim të përshtatshëm pas kthimit në komunitet.

2. Të miturve mbi 16 vjeç u krijohen mundësi për t'u angazhuar në punë me pagesë, dhe nëse është e mundur në komunitetin lokal.



3. Organizimi dhe metodat e punës së ofruar në IEVP duhet të jenë sa më të ngjashme me ato në komunitet, për t'i përgatitur të miturit me kushtet normale të punësimit.

Neni 90

Takimet, vizitat, korrespondencat dhe informacioni

1. Personeli i IEVP-së i ndihmon të miturit në mbajtjen e kontakteve të përshtatshme me botën e jashtme dhe iu siguron atyre mjetet e nevojshme për mbajtjen e këtyre kontakteve.

2. Korrespondencat dhe vizitat mund të kufizohen dhe të mbikëqyren për arsye të kryerjes së hetimeve, ruajtjes së rendit publik, sigurisë, parandalimit të veprave penale, por këto kufizime, përfshi kufizimet e veçanta të caktuara me vendim gjykatë ose urdhër prokurori, duhet të lejojnë një nivel minimal kontaktesh.

3. Informacionet për vdekjen apo sëmundje serioze të familjarëve të afërm u njoftohen të miturve menjëherë në mënyrë të përshtatshme.

Neni 91

Lejet shpërblyese

1. Të miturit përfitojnë leje sipas nenit 51, të kësaj rregulloreje.

2. Për të dënuarit e mitur, kohëzgjatja e lejeve shpërblyese nuk mund të jetë më shumë se 20 ditë për çdo rast të dhënies së saj dhe, në total, nuk mund të jetë më shumë se 45 ditë në vit.

3. Në çdo rast, leja jepet në prani të prindit, kujdestarit apo përfaqësuesit të tij ligjor.

Neni 92

Veçimi për arsye sigurie

1. Nëse, në raste përjashtuese, një i mitur ndahet nga të tjerët për arsye sigurie, kjo vendoset nga drejtori i IEVP-së në përputhje me legjislacionin në fuqi për trajtimin e të burgosurve, ku specifikohet natyra e veçimit, kohëzgjatja e tij maksimale dhe arsyet e këtij veçimi.

2. Vendimi për veçim i njoftohet të miturit, prindit ose përfaqësuesit ligjor dhe mbrojtësit të të miturit.

3. Vendimi i veçimit rishikohet çdo dy muaj.

4. I mituri, prindi, kujdestari ose mbrojtësi ligjor i të miturit mund të paraqesin një ankesë për çdo aspekt të vendimit për veçim.

5. Drejtori i IEVP-së informon menjëherë mjekun, i cili merr kontakt të menjëhershëm me të miturin.

Neni 93

Disiplina

1. Masat disiplinore për të miturin zbatohen sipas parimit se masa disiplinore është forma e fundit e disiplinimit të sjelljes.

2. Masat disiplinore të parashikuara nga ligji, e konkretisht;

a) përjashtimi nga veprimtari të veçanta, të përbashkëta deri në 5 ditë;

b) përjashtimi nga ajrosja në grup për jo më shumë se 10 ditë;

c) përjashtimi nga të gjitha veprimtaritë e përbashkëta deri në 10 ditë,

merren ndaj të miturit të dënuar ose të paraburgosur, vetëm pasi më parë të jenë zbatuar këshillimi individual ose vërejtja në prani të të dënuarve dhe të të paraburgosurve.

3. Të miturve, ndaj të cilëve merren masa disiplinore, informohen menjëherë në një mënyrë dhe gjuhë që ata e kuptojnë për natyrën e akuzave kundër tyre dhe atyre u jepet kohë e mjaftueshme që të përgatitin mbrojtjen. Ata lejohen të mbrojnë veten me ndihmën e prindërve, të përfaqësuesit ligjor ose të një mbrojtësi ligjor.

4. Vendimi për masën disiplinore përmban mundësinë dhe mënyrën se si ankimohet masa disiplinore.

5. Ndalohen dënimet kolektive, ndëshkimet trupore, dënimi përmes vendosjes në dhoma të errëta dhe forma të tjera dënimesh çnjerëzore dhe degraduese.

6. Ndalohet izolimi si masë disiplinore ndaj të miturve.

7. Veçimi për qëllime disiplinore vendoset vetëm në raste përjashtuese kur sanksionet e tjera nuk kanë qenë efektive. Ky veçim vendoset për një periudhë të përcaktuar kohore, e cila duhet të jetë sa më e shkurtër që të jetë e mundur, mundësisht 3 ditë. Regjimi gjatë këtij veçimi duhet të garantojë kontakte njerëzore, materiale leximi dhe të sigurojë të paktën një orë ajrim çdo ditë nëse e lejojnë kushtet atmosferike.

8. Masat disiplinore për të miturit si rregull nuk përfshijnë kufizime ndaj kontakteve me familjen apo vizitave me përjashtim të rastit ku shkelja disiplinore lidhet me këto vizita apo kontakte.



9. Ushtrimet fizike nuk duhet të kufizohen për shkak të masës disiplinore.

Neni 94

Përgatitja për lirim dhe riintegrim

1. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe personeli i IEVP-së merr masa që të gjithë të miturit e privuar nga liria të ndihmohen për t'u rikthyer në komunitet në bashkëpunim me vetë të miturin, punonjësën social, familjen ose kujdestarin e tij.

2. Personeli i IEVP-së bashkëpunon ngushtësisht me organizata dhe agjenci që kanë të miturit në qendër të veprimtarive të tyre për të mundësuar rikthimin e të miturit në komunitet, nëpërmjet:

a) kthimit të tyre në familje apo gjetjen e një familjeje kujdestare;

b) ndihmës për të zhvilluar marrëdhënie sociale;

c) gjetjes së vendqëndrimit;

ç) ofrimit të vazhdimet të shkollës dhe formimit profesional;

d) punësimit;

dh) referimit në organizata ose agjenci që merren me mbrojtjen shoqërore dhe shëndetësore;

e) dhënies së ndihmës monetare dhe veshmbathjeve në varësi të kushteve ekonomike familjare.

3. Drejtori i IEVP-së siguron që përfaqësuesit e organizatave ose agjencive që ofrojnë shërbim riintegrimi dhe rehabilitimi, të kenë akses të vazhdueshëm në institucionet e të miturve për të ndihmuar në lirin e tyre.

4. Drejtuesi i IEVP-së merr masa dhe njofton paraprakisht për lirin prindërit apo përfaqësuesin ligjor të të miturit.

Neni 95

Të miturit në paraburgim

1. Të miturit e paraburgosur nuk trajtohen si të dënuar ose si persona që mund të dënohen në të ardhmen.

2. Të miturit e paraburgosur gëzojnë të gjitha të drejtat që gëzojnë edhe të miturit e dënuar me burgim.

3. Drejtori i IEVP-së merr masa që të miturit në paraburgim të ndihmohen menjëherë nga agjencitë që janë përgjegjëse për ta pas lirit, me qëllim që të sigurohet vazhdimësia e përkujdesjes dhe të përfshihen në programe veprimtarish të njëjta me ato të të miturve të dënuar.

Faqe | 4566

KREU XVIII

TRAJTIMI I KATEGORIVE TË TJERA

Neni 96

Trajtimi i të dënuarve me shtetësi të huaj

1. Të paraburgosurit dhe të dënuarit të huaj i mundësohet njoftimi i familjes, këshilltarit ligjor, përfaqësuesit konsullor ose organizatës kompetente që vepron në fushën e mbrojtjes të të drejtave të njeriut.

2. Shtetasve të huaj, që nuk kanë përfaqësi diplomatike ose konsullore në vend, refugjatëve ose personave pa shtetësi, u mundësohet komunikimi me përfaqësitë diplomatike të shtetit që mbron interesat e tyre ose me autoritetin kombëtar ose ndërkombëtar, detyra e të cilit është mbrojtja e interesave të këtyre personave.

Neni 97

Transferimi i shtetasve të huaj

Për t'u siguruar që transferimi i të dënuarve të huaj e lehtëson riintegrimin e tyre dhe nuk shkel të drejtat e tyre themelore, duhen marrë parasysh mendimi i të dënuarve, lidhjet familjare, gjuhësore, kulturore, sociale e ekonomike dhe kushtet e burgjeve në shtetin ku ai do të vuajë dënimin, para marrjes së vendimit të formës së prerë.

Neni 98

Veprimet në rast vdekjeje të të dënuarve të huaj

1. Në rastin e vdekjes të të paraburgosurve dhe të të dënuarve të huaj, njoftimi i vdekjes bëhet nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme, përfaqësuesve diplomatikë ose konsullorë në Republikën e Shqipërisë, të shtetit të cilit ai i përket, përfaqësuesve të shtetit që merr në mbrojtje interesat e tyre ose nëpërmjet autoriteteve kombëtare apo ndërkombëtare, që kanë për qëllim të veprimtarisë së tyre mbrojtjen e interesave të këtyre personave.

2. Në rastin e të paraburgosurve dhe të të dënuarve të huaj që nuk u dihet vendbanimi, familjarët ose personat e tjerë të caktuar më parë nga ai, njoftimi i tyre bëhet të paktën në dy media kombëtare për një periudhë 10-ditore.



Neni 99

Trajtimi i të dënuarve të minoriteteve etnike ose gjuhësore

Të paraburgosurit dhe të dënuarit që i përkasin minoriteteve etnike ose gjuhësore, të huaj ose persona pa shtetësi, pajisen me informacion me gojë dhe me shkrim, në gjuhën që ata kuptojnë, për të drejtat dhe detyrimet e tyre në institucion dhe u ofrohen kurse të gjuhës shqipe.

Neni 100

Trajtimi i të paraburgosurve dhe të dënuarve me aftësi të kufizuar

1. Të paraburgosurve dhe të dënuarve me aftësi të kufizuar u ofrohet trajtim dhe siguri shëndetësor, në mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme.

2. Shërbimi shëndetësor i të paraburgosurve dhe të dënuarve me aftësi të kufizuar u ofrohet me të njëjtën cilësi dhe standard të shërbimeve shëndetësore në strukturat e shëndetit publik dhe pa pagesë.

Neni 101

Trajtimi i të paraburgosurve dhe të dënuarve me HIV/AIDS

1. Për të paraburgosurit dhe të dënuarit me HIV/AIDS garantohej trajtim specifik falas dhe ofrohet këshillim për HIV/AIDS-in, me qëllim përgatitjen e të dënuarit për përballimin e pasojave të mundshme të stresit dhe për t'i ndihmuar në marrjen e vendimeve bazuar në informacionet për HIV/AIDS-in. Këshillimi përfshin informimin, edukimin dhe mbështetjen psikosociale, të cilat i mundësojnë personit me HIV/AIDS të jetojë dhe të parandalojë transmetimin e virusit HIV/AIDS.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve bashkëpunon me institucionet shëndetësore publike për të siguruar ekzaminime mjekësore specifike dhe trajtim të specializuar për personat që jetojnë me HIV/AIDS.

KREU XIX**SHËRBIMI SHËNDETËSOR**

Neni 102

Organizimi i kujdesit shëndetësor në IEVP

1. Shërbimi shëndetësor sigurohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve gjatë gjithë kohës së qëndrimit në institucion dhe mbulohet nga siguri

i detyrueshëm i kujdesit shëndetësor sipas legjislacionit në fuqi. IEVP-të sigurojnë shërbim shëndetësor pa ndërprerje, nën kujdesin dhe kontrollin e personelit mjekësor dhe shëndetësor.

2. Shërbimi shëndetësor i përgjigjet çdo kërkesë të të paraburgosurve dhe të të dënuarve, që lidhet me shëndetin e tyre dhe në mënyrë periodike ushtron kryesisht kontrolle mjekësore për të parë gjendjen e përgjithshme të të paraburgosurve e të të dënuarve, veçanërisht atë psikike. Çdo kontroll duhet të dokumentohet në kartelën shëndetësore të të paraburgosurit dhe të të dënuarit, e cila është pjesë e dosjes mjekësore të tij.

3. Mjeku i raporton drejtorit të IEVP-së kurdoherë që mendon se gjendja fizike e mendore e një të paraburgosuri apo të dënuari është përkeqësuar ose do të keqësohet nga vazhdimi i qëndrimit në IEVP.

Neni 103

Kërkesa për vizitë mjekësore

1. I paraburgosuri apo i dënuari që ka probleme shëndetësore i paraqet kërkesën me shkrim ose me gojë për vizitë mjekësore personelit shëndetësor ose personelit të sigurisë në regjim. Personeli mjekësor i turnit harton listën përkatëse dhe ia dorëzon mjekut të IEVP-së për të bërë vizita, me përjashtim të rasteve urgjente.

2. Lëvizja e të paraburgosurit apo të dënuarit nga dhoma për në infermieri dhe anasjelltas, me përjashtim të rasteve urgjente, bëhet një nga një, sipas kërkesës së mjekut, i shoqëruar. Gjatë vizitës mjekësore, punonjësi shoqërues qëndron jashtë dhomës deri në mbarimin e vizitës.

3. I paraburgosuri apo i dënuari është i detyruar të zbatojë udhëzimet e mjekut gjatë terapisë.

4. I paraburgosuri apo i dënuari nuk mund të mbajë apo të përdorë asnjë lloj medikamenti mjekësor pa miratimin e mjekut.

Neni 104

Kujdesi shëndetësor për kategori të veçanta

1. Shërbimi shëndetësor në IEVP organizohet pa diskriminim për shkak të statusit ligjor të personit në institucion ose për ndonjë arsye tjetër, që mund të përbëjë diskriminim.

2. Trajtimi i personave me çrregullime të shëndetit mendor bëhet sipas legjislacionit në fuqi për shëndetin mendor. Të paraburgosurit apo të dënuarit, që gjenden në institucionet e ekzekutimit



të vendimeve penale dhe që vuajnë nga çrregullime të shëndetit mendor, gëzojnë të drejtën për trajtim të veçantë shëndetësor pranë seksioneve mjekësore të posaçme (seksione të kujdesit të veçantë) të institucioneve ose në qendrën spitalore të burgjeve.

3. Të dënuarit apo të paraburgosurit, që shfaqin shenja të përdorimit të drogës, substancave psikotrope ose alkoolit apo shenja të stresit, trajtohen sipas programeve shëndetësore dhe sociale që zbatohen në shoqërinë jashtë institucionit.

4. Personat që mbartin sëmundje infektive trajtohen në mënyrë jodiskriminuese dhe sipas standardeve që zbatohen për këto kategori në institucionet spitalore.

5. Të paraburgosurit apo të dënuarit me sëmundje kronike ose të moshuar përfitojnë shërbim shëndetësor sipas standardeve që zbatohen për këto kategori personash pranë institucioneve të specializuara jashtë sistemit të burgjeve.

6. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve merr masa për të mundësuar ofrimin e shërbimeve shëndetësore të nevojshme në institucione dhe në pamundësi të tyre, në institucione të specializuara jashtë sistemit të burgjeve.

7. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve merr masa që kategoria e personave me aftësi të kufizuara të mos i nënshtrohet eksperimentimit mjekësor apo shkencor pa pëlqimin e tij të lirë.

Neni 105

Shërbimi stomatologjik

1. Në klinikën stomatologjike të institucionit kryhet shërbimi dentar për të paraburgosurit dhe të dënuarit.

2. Të paraburgosurit dhe të dënuarit kanë të drejtë që, me mjetet e tyre financiare, të mjekohen në klinika stomatologjike jashtë IEVP-së, kur ekzistojnë kushtet e sigurisë.

Neni 106

Vizitat mjekësore jashtë institucionit dhe në IVSHB

1. Në rastet e urgjencave apo të sëmundjeve ngjitëse, i dënuari dërgohet në IVSHB ose institucione të tjera mjekësore për vizita dhe trajtime të specializuara.

2. Të paraburgosurit apo të dënuarit i lejohet që, me shpenzimet e veta, të kryejë vizita dhe mjekime

të specializuara në klinika të tjera jashtë institucionit, me miratimin e drejtorit të IEVP-së.

3. Transporti dhe ruajtja e të paraburgosurve apo të dënuarve bëhet nga IEVP-ja me shoqërim nga mjeku ose ndihmësmjeku dhe punonjësit e policisë, kur ekzistojnë kushtet e sigurisë.

4. Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve nxjerr udhëzim për lëvizjen e të paraburgosurve dhe të dënuarve për në IVSHB.

Neni 107

Medikamentet mjekësore, sigurimi dhe shpërndarja e tyre

1. Pas vizitës mjekësore, mjeku i IEVP-së ose mjeku specialist, sipas llojit të sëmundjes të të paraburgosurve apo të të dënuarve, përcakton mjekimin e nevojshëm që shënohet në regjistrin e vizitave mjekësore dhe kartelën mjekësore. Njëkohësisht u jepen rekomandimet e rastit personelit shëndetësor dhe farmacistit për veprimet e mëtejshme.

2. Trajtimi me medikamentet mjekësore bëhet nga farmacia e IEVP-së, ndërsa shpërndarja bëhet nga personeli shëndetësor.

3. Me miratimin dhe udhëzimin e mjekut të IEVP-së të paraburgosurit dhe të dënuarit lejohen të trajtohen me barna mjekësore të siguruar me shpenzimet e tyre.

Neni 108

Veçimi mjekësor

1. Në rastet e sëmundjeve ngjitëse mjeku vendos për veçimin e të paraburgosurit apo të dënuarit, duke e mbajtur nën kontroll të vazhdueshëm dhe njofton menjëherë drejtorin e IEVP-së për situatën.

2. Në rastet e konstatimit të sëmundjeve ngjitëse dhoma dezinfektohet, ndërsa i paraburgosuri apo i dënuari vendoset në një mjedis të veçantë ose dërgohet në IVSHB për trajtim të specializuar.

3. Mjeku vendos për pushimin e veçimit kur nuk ekzistojnë më shkaqet që çuan në vendosjen e veçimit.

Neni 109

Trajtimi i të paraburgosurit dhe të dënuarit me çrregullime të shëndetit mendor

1. Të paraburgosurit apo të dënuarit me çrregullime të shëndetit mendor trajtohen në



institucione mjekësore të posaçme jashtë sistemit të institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale dhe në seksione të kujdesit të veçantë, brenda institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale, që shërbejnë për trajtimin e kësaj kategorie.

2. Vendosja e personave në institucionet mjekësore të veçanta, jashtë sistemit të institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale, kryhet në zbatim të vendimit të gjykatës.

3. Vendosja e personave në seksione mjekësore të posaçme kryhet në zbatim të vendimit të gjykatës ose urdhrit të ekzekutimit të prokurorit. Në rastet urgjente, vendosja e personit të paraburgosur ose të dënuar urdhërohet nga drejtori i institucionit ku ndodhet i paraburgosuri ose i dënuari, duke vënë në dijeni menjëherë prokurorin.

4. Dalja nga institucionet mjekësore të posaçme bëhet me vendim të gjykatës, në vijim të propozimit të drejtuesit të institucionit, kërkesës të të paraburgosurit dhe të të dënuarit ose kujdestarit ligjor të tij, si dhe me iniciativën e gjykatës, duke respektuar afatin maksimal të një viti për rivlerësimin e gjendjes së personit.

5. Për vendosjen, refuzimin e vendosjes, daljen ose refuzimin e daljes nga institucionet mjekësore të posaçme, i paraburgosuri ose i dënuari, mbrojtësi ose kujdestari i tij kanë të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 5 ditëve nga vënia e tyre në dijeni.

6. Trajtimi në seksionet mjekësore të posaçme brenda institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale bëhet për aq kohë sa gjykata nuk shprehet për trajtimin e tyre në një institucion mjekësor të posaçëm, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin për shëndetin mendor.

KREU XX

NJOFTIM PËR VDEKJET, SËMUNDJET E TË PARABURGOSURIT APO TË DËNUARIT

Neni 110

Njoftimet për rastet e sëmundjeve dhe vdekjeve

1. Në rastet e sëmundjeve të rënda, dëmtimeve serioze të të paraburgosurit apo të dënuarit, IEVP-ja njofton menjëherë familjarët ose të afërmit dhe, në çdo rast, çdo person tjetër të caktuar më parë nga i paraburgosuri apo i dënuari.

2. I paraburgosuri apo i dënuari duhet të njoftohet menjëherë për vdekjen dhe sëmundjen e familjarëve dhe të afërmeve të tij.

Neni 111

Veprimet në rast vdekjeje

1. Në rast vdekjeje të të paraburgosurit apo të të dënuarit, IEVP-ja merr masa për kryerjen e procedurave ligjore, që kanë të bëjnë me verifikimin e rastit, shkakun e vdekjes, kryerjen e veprimeve procedurale hetimore, si dhe veprimeve të tjera për sqarimin dhe dokumentimin e faktit të vdekjes.

2. IEVP-ja njofton menjëherë Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, prokurorin, familjarët dhe, në mungesë të familjarëve, autoritetet e gjendjes civile.

3. Sendet personale dhe depozitat në të holla të të paraburgosurit apo të të dënuarit i dorëzohen familjarëve, sipas procedurave dhe dokumentacionit përkatës.

4. Në qoftë se brenda 6 muajve nga vdekja e të paraburgosurit apo të të dënuarit sendet e tij nuk janë tërhequr nga familja ose të afërmit e tij, ato dërgohen në organet e qeverisjes vendore të vendbanimit të tij.

5. Në rast se i paraburgosuri apo i dënuari i vdekur nuk merret nga familja ose të afërmit e tij, personeli i IEVP-së kujdeset për varrosjen e tij në varrezat publike, duke përballuar shpenzimet e nevojshme dhe duke bërë shënimin e duhur në regjistrin themeltar.

KREU XXI

SJELLJA NË INSTITUCION

Neni 112

Komisioni i vlerësimit të sjelljes

1. Komisioni i vlerësimit të sjelljes të të paraburgosurve apo të të dënuarve ngrihet me urdhër të Drejtorit të IEVP-së.

2. Komisioni i vlerësimit të sjelljes kryesohet nga përgjegjësi sektorit ligjor dhe përbëhet nga katër anëtarë:

- a) përgjegjësi i sektorit të çështjeve shoqërore;
- b) edukatori i grupit;
- c) përgjegjësi i sektorit të sigurisë;
- ç) specialisti i regjimit të brendshëm.



Neni 113

Vlerësimi i sjelljes së të paraburgosurve dhe të dënuarve

1. Komisioni i vlerësimit të sjelljes harton vlerësimin e sjelljes për çdo të paraburgosur apo të dënuar, si më poshtë:

a) Çdo 6 muaj dhe vlerësimi protokollohet e administrohet në dosjen psikosociale.

b) Për seancat gjyqësore me objekt uljen e dënimit, ku pasqyrohen të gjitha masat disiplinore të dhëna ndaj tij për vitin e fundit të vuajtjes së dënimit.

c) Për seancat gjyqësore me objekt lirim me kusht ose ndryshimin e klasifikimit të sigurisë, ku pasqyrohen të gjitha masat disiplinore të dhëna ndaj të dënuarit gjatë 2 viteve të fundit të vuajtjes së dënimit.

2. Në çdo rast, transferimi nga një institucion në tjetrin shoqërohet me vlerësimin e sjelljes, i cili administrohet në dosjen personale.

Neni 114

Përgjegjësia për shkaktimin e dëmit

1. Në rastin e dëmtimit të një sendi të luajtshëm ose të paluajtshëm, pronë e IEVP-së, drejtoria e institucionit duhet të përcaktojë dëmtuesin dhe masën e dëmit dhe pasi dëgjon të paraburgosurin ose të dënuarin përgjegjës, e njofton atë për vlerën e dëmit, duke e ftuar që ta shlyejë atë vullnetarisht. Në rast të kundërt, drejtori i institucionit ngre komisionin e vlerësimit të dëmit dhe urdhëron e mbajtjen e vlerës monetare nga numri i llogarisë personale të të paraburgosurit apo të dënuarit. Nëse vlera nuk gjendet në llogarinë personale, atëherë thirren familjarët e tyre për të bërë zhdëmtimin kundrejt dokumentacionit ligjor.

2. Në rast dëmtimi të sendeve të të paraburgosurve apo të të dënuarve nga njëri-tjetri, drejtoria e IEVP-së ndërmjetëson për zgjidhjen me mirëkuptim të çështjes. Dëmshpërblimi vullnetar përbën rrethanë lehtësuese kur gjatë shqyrtimit të masës disiplinore vendoset për masën disiplinore përkatëse. Në rast të kundërt, ndiqet procedura e përcaktuar në pikën 1, të këtij neni.

Neni 115

Veprat penale në burgje

Hetimet mbi një veprë penale të dyshuar se është kryer nga të dënuarit apo të paraburgosurit

brenda IEVP-së zhvillohen në të njëjtën mënyrë në burg, si në shoqërinë e lirë dhe trajtohen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

KREU XXII

PROCEDURAT DISIPLINORE

Neni 116

Klasifikimi i shkeljeve disiplinore

1. Shkeljet disiplinore klasifikohen në shkelje shumë të rënda, shkelje të rënda dhe shkelje të lehta.

2. Konsiderohen shkelje shumë të rënda disiplinore:

a) organizimi, pjesëmarrja dhe nxitja e veprimtarive që cenojnë masat e sigurisë në IEVP;

b) kundërshtimi me dhunë ndaj punonjësve të IEVP-së;

c) ushtrimi i dhunës fizike ose psikike ndaj të burgosurve të tjerë;

ç) përgatitja dhe përpjekja për t'u larguar nga IEVP-ja ose gjatë shoqërimit të tij;

d) përvetësimi ose dëmtimi me dashje i pasurisë së IEVP-së ose të burgosurve të tjerë;

dh) dhuna verbale dhe sjellja agresive ndaj të burgosurve të tjerë;

e) mbajtja, përdorimi dhe qarkullimi i sendeve të ndaluara, kur përbëjnë vepër penale;

ë) prodhimi dhe përdorimi i lëndëve narkotike dhe pijeve alkoolike;

f) shkelja e afatit të kthimit në IEVP pas lejes, pa arsye objektive të vërtetuara.

3. Konsiderohen shkelje të rënda disiplinore:

a) përdorimi i fjalëve të pahijshme e fyese ndaj personave të tjerë;

b) kryerja e veprimeve ose akteve me qëllime përfitimi;

c) moszbatimi i detyrimeve dhe urdhrave ose vonimi i pajustificuar i zbatimit të tyre;

ç) mbajtja, përdorimi dhe qarkullimi i sendeve të ndaluara, kur nuk përbëjnë vepër penale.

4. Konsiderohen shkelje të lehta disiplinore:

a) neglizhenca në kryerjen e pastrimit personal, të dhomës apo të mjediseve të përbashkëta;

b) simulimi i sëmundjes;

5. Ndaj të paraburgosurit dhe të dënuarit nuk mund të fillojë procedimi disiplinor në rastet kur sjelljet, veprimet apo mosveprimet e tyre nuk përbëjnë shkelje disiplinore.



6. Masa disiplinore caktohet në përputhje me llojin dhe rëndësinë e shkeljes, qëndrimin e të paraburgosurit/të dënuarit, si dhe vlerësimin e sjelljes.

7. Masat disiplinore zbatohen duke respektuar personalitetin dhe dinjitetin e të paraburgosurit dhe të dënuarit.

8. Masat disiplinore duhet të përdoren si mjet i fundit i disiplinimit të sjelljes, veçanërisht për kategorinë e të miturve dhe grave. Në rastet kur është e mundur, autoritetet e institucionit përdorin ndërmjetësimin për zgjidhjen e konflikteve mes të dënuarve dhe të paraburgosurve ose mes tyre dhe personelit të institucionit.

9. Masat disiplinore zbatohen në mënyrë që të nxitin ndjenjën e përgjegjësisë dhe aftësinë e vetëkontrollit të të paraburgosurit dhe të dënuarit.

10. Për personat e diagnostikuar me çrregullime të shëndetit mendor, personat që kanë pasur përvoja të dhunës fizike, psikologjike ose të abuzimit seksual, zbatohet një regjim disiplinor lehtësues në përputhje me nevojat e tyre.

Neni 117

Masat parandaluese

1. Drejtori i IEVP-së urdhëron veçimin e të paraburgosurit apo të dënuarit, vetëm për shkelje shumë të rënda, duke e vendosur në mjediset e veçimit, deri në mbledhjen e komisionit disiplinor të IEVP-së.

2. Komisioni vendos për masën disiplinore me qëllim garantimin e masave të sigursë në IEVP dhe për të parandaluar dëmtime apo pasoja, që mund të vijnë nga sjellja apo veprimet e të paraburgosurve ose të dënuarve, si dhe për të demonstruar zbatimin e regjimit e të rregullave të brendshme në IEVP.

3. Në rastet e kryerjes së shkeljeve të rënda ose të lehta, masa disiplinore ekzekutohet pas vendimit nga Komisioni Disiplinor i IEVP-së.

Neni 118

Masat disiplinore

1. Për shkeljet disiplinore shumë të rënda zbatohen këto masa:

- a) Përfashtimi nga të gjitha veprimtaritë e përbashkëta deri në 20 ditë;
- b) Mbajtja në mjedise të veçanta;

c) Ndërprerja e dhënies së lejeve për një periudhë nga 6 muaj deri në 1 vit, në rast të përsëritjes së shkeljes disiplinore.

2. Për shkeljet disiplinore të rënda zbatohen këto masa:

a) Përfashtim nga veprimtari të përbashkëta deri në 10 ditë;

b) Mbajtja në mjedise të veçanta;

c) Përfashtim nga ajrosja në grup, por jo më shumë se 20 ditë.

3. Për shkeljet disiplinore të lehta zbatohen këto masa:

a) Këshillim individual;

b) Vërejtje me shkrim, e cila futet në dosjen personale;

c) Vërejtje në prani të të paraburgosurve/të dënuarve;

4. Masat disiplinore të parashikuara në pikën 2, të këtij neni, merren ndaj të miturit të dënuar apo të paraburgosur vetëm pasi më parë janë zbatuar këshillimi individual ose vërejtja në prani të të dënuarve.

5. Ndaj të paraburgosurve apo të dënuarve merren masa disiplinore, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe asnjëherë dy herë për të njëjtën shkelje.

6. Për shkelje të përsëritura brenda të njëjtit klasifikim, jepet një masë më e rëndë, për shkelje të klasifikimeve të ndryshme, jepet masa e klasifikimit më të rëndë, për disa shkelje brenda të njëjtit klasifikim, jepet masa disiplinore më e rëndë.

7. Masa disiplinore parashkruhet, sipas përcaktimeve të ligjit për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve.

Neni 119

Komisioni Disiplinor dhe procedimi disiplinor

1. Në rastin e një shkeljeje disiplinore personeli i IEVP-së dokumenton shkeljen e ndodhur, nëpërmjet procesverbalit të konstatimit, që administrohet në sekretari dhe i vihet në dispozicion drejtorit të IEVP-së, i cili urdhëron fillimin e procedurave disiplinore.

2. Në rastet e shkeljeve shumë të rënda dhe të rënda, të parashikuara në nenin 118, të kësaj rregulloreje, masa vendoset nga Komisioni Disiplinor i IEVP-së.

3. Në rastet e shkeljeve të lehta, të parashikuara në nenin 118, të kësaj rregulloreje, masa jepet nga drejtori i institucionit pas sqarimit të rrethanave,



komunikimit me të burgosurin dhe pasi këtij të fundit i garantohet e drejta e mbrojtjes.

4. Komisioni Disiplinor përbëhet nga drejtori i IEVP-së në cilësinë e kryetarit dhe me cilësinë e anëtarëve: përgjegjësi i sektorit ligjor, përgjegjësi i sektorit të sigurisë, përgjegjësi i sektorit të kujdesit social dhe specialisti i sektorit të kujdesit social që trajton të paraburgosurin apo të dënuarin.

5. Mjeku merr pjesë në mbledhjet e komisionit disiplinor pa të drejtë vendimmarrjeje. Ai harton në çdo rast një raport mjekësor, ku shprehet mbi gjendjen shëndetësore të të paraburgosurit apo të të dënuarit. Ky raport mjekësor i shërben komisionit disiplinor për përcaktimin e masës disiplinore.

6. Komisioni ngrihet dhe funksionon me urdhër të drejtorit të IEVP-së, i cili e mbledh atë jo më vonë se 24 orë nga momenti i kryerjes së shkeljes.

7. Gjatë mbledhjes së komisionit disiplinor dëgjohen pretendimet e të paraburgosurit apo të të dënuarit. Të paraburgosurit apo të dënuarit i lejohej mbrojtja me avokat. Për të paraburgosurit apo të dënuarit e huaj sigurohet ndihma e një përkthyesi.

8. Komisioni disiplinor merr vendimin përkatës me shumicë votash, i cili i komunikohet të paraburgosurit apo të dënuarit dhe i jepet një kopje e tij. Vendimi mund të ankimohej në përputhje me legjislacionin në fuqi.

9. Ndaj të paraburgosurve apo të dënuarve të mitur dhe grave masat e rënda dhe shumë të rënda të parashikuara në nenin 118, të kësaj rregulloreje, jepen deri në gjysmën e kohës së parashikuar.

10. Masat disiplinore evidentohen në regjistrin përkatës dhe në dosjet personale dhe psiko-sociale të të paraburgosurit apo të të dënuarit.

Neni 120

Procedura e dhënies së masave disiplinore

1. Komisioni disiplinor merr vendim për dhënien e masës disiplinore pasi ka dëgjuar të paraburgosurin apo të dënuarin, nëse ai dëshiron të shprehet, ndaj të cilit ka një propozim për masë disiplinore.

2. Njoftimi i të paraburgosurit apo të dënuarit, ndaj të cilit ka një propozim për masë disiplinore, ose refuzimi i tij për t'u shprehur përpara komisionit vërtetohet kundrejt nënshkrimit të të interesuarit dhe në rastet e hezitimit të tij për të firmosur, me nënshkrimin e dy personave të tjerë nga personeli, që nuk janë të përfshirë në ngjarjen

që ka shkaktuar propozimin për masë disiplinore.

3. I dënuari apo i paraburgosuri mund të mbrohet vetë ose nga mbrojtësi i tij, kur e çmon të nevojshme. Gjithashtu, atij i garantohet e drejta për të thirrur dëshmitarë në emër të tyre ose për të kundërshtuar provat ndaj tyre, si dhe garantohet kohë e mjaftueshme dhe lehtësi për të përgatitur mbrojtjen.

4. I dënuari apo i paraburgosuri gëzojnë të drejtën të kenë përkthyes, nëse nuk mund të kuptojnë ose të flasin gjuhën shqipe.

5. Komisioni disiplinor i dorëzon të dënuarit ose të paraburgosurit një kopje të vendimit për marrjen e masës disiplinore.

6. Masa disiplinore nuk mund të jepet nëse kanë kaluar 30 ditë nga konstatimi i saj.

Neni 121

Ankimimi kundër vendimit të Komisionit Disiplinor

1. I paraburgosuri apo i dënuari ka të drejtë të ankimojë masën disiplinore pranë Komisionit të Apelit të masave disiplinore në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, brenda 15 ditëve nga vënia e tij në dënim.

2. Përbërja, organizimi dhe funksionimi i Komisionit të Apelit përcaktohen me një procedurë standarde të miratuar me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.

3. Komisioni i Apelit vendos lënien në fuqi, shfuqizimin ose kthimin për rishqyrtim, të vendimit të Komisionit Disiplinor në IEVP.

4. Komisioni i Apelit njofton me shkrim të dënuarin apo të paraburgosurin lidhur me vendimin e tij.

KREU XXIII

SIGURIA NË INSTITUCION

Neni 122

Përdorimi i armëve

1. Ndalohet mbajtja e armëve të zjarrit brenda në regjimin e institucioneve.

2. Mbajtja e shkopinjve të gomës apo mjeteve të kufizimit fizik mund të lejohej vetëm në rastet kur ato nevojiten për sigurinë e IEVP-së.

3. Armët e zjarrit përdoren sipas kushteve dhe kritereve të legjislacionit në fuqi për përdorimin e armëve të zjarrit.



Neni 123

Përdorimi i forcës dhe mjeteve të kufizimit fizik

1. Ndalohet përdorimi i forcës ndaj të paraburgosurve apo të dënuarve, përveçse si mjet i fundit për vetëmbrojtje apo, në rast se tentohet arratisja, bëhet rezistencë fizike ndaj një urdhri të ligjshëm, ka një rrezik të drejtpërdrejtë për shkaktim dëmi ndaj vetvetes apo i shkaktohet një dëm serioz pasurisë.

2. Shkalla e përdorimit të forcës do të jetë minimumi i nevojshëm dhe zbatohet për kohën më të shkurtër të mundshme.

3. Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve harton dhe realizon një plan trajnimi të personelit të institucioneve për teknika që mundësojnë përdorimin minimal të forcës për të ndaluar sjelljet agresive.

4. Ndalohet përdorimi i prangave apo këmbësive të forcës, me përjashtim të rasteve, kur forma të tjera të përdorimit të forcës më pak intensive kanë dështuar. Prangat mund të përdoren nëse janë të domosdoshme për të parandaluar një sjellje të dhunshme ose, nëse gjatë transferimit, i mituri bën përpjekje për t'u arratisur. Prangat hiqen kur i paraburgosuri apo i dënuari shfaqet para një organi gjyqësor apo administrativ, me përjashtim të rastit kur ky autoritet vendos ndryshe.

5. Ndalohet përdorimi i mjeteve të kufizimit fizik më gjatë sesa është e nevojshme. Ndalohet përdorimi i zinxhirëve dhe hekurave.

6. Izolimi në një dhomë të veçantë si mjet kufizimi i përkohshëm përdoret vetëm përjashtimisht dhe vetëm për pak orë dhe, në çdo rast, nuk duhet të kalojë 24 orë.

7. Në rast të dëmtimit fizik të të paraburgosurit apo të të dënuarit, atij i jepet menjëherë ndihma mjekësore, e cila pasqyrohet në kartelën shëndetësore.

8. Në rastin e tejkalimit të masës së përdorimit të forcës nga ana e punonjësve të IEVP-së, ndaj tyre veprohet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 124

Kontrollet

1. Të paraburgosurit apo të dënuarit a personat që kanë të drejtë të marrin takim me ta i nënshtrohen kontrollit nga ana e Policisë së

Burgjeve. Personeli që bën kontrollin duhet të jetë i së njëjtës gjini me atë të personit që kontrollohet.

2. Personeli i autorizuar mund të kryejë kontroll ndaj të paraburgosurve apo të dënuarve në regjimin e brendshëm, kur ekziston dyshimi i arsyeshëm për posedim të sendeve të ndaluara.

3. Në raste të veçanta, për kryerjen e kontrollit mund të kërkohet edhe mbështetja e njësive të specializuara nga institucione të tjera.

4. Kontrollet e vizitorëve të të paraburgosurve apo të të dënuarve dhe të dhomave të tyre duhet të bëhen duke respektuar personalitetin dhe dinjitetin e tyre dhe pa dëmtuar sendet që ata posedojnë.

5. Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve ushtron kontrolle për sende të ndaluara dhe elementet e sigurisë në IEVP.

6. Procedura dhe kontrolli përcaktohen me procedurë standarde të miratuar nga drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve.

7. Kontrolli i grave dhe të miturave të paraburgosura apo të dënuara kryhet vetëm nga personeli me të njëjtën gjini.

8. Ushtrimi i kontrollit personal të anësive, plagëve, dëmtimeve apo thyerjeve të fashuara kryhet nga personeli mjekësor, kur ekziston një dyshim i arsyeshëm se i paraburgosuri apo i dënuari mban sende të ndaluara.

9. Policia e Burgjeve kontrollon mjediset ku rrinë, flenë, punojnë dhe zhvillojnë aktivitet të paraburgosurit dhe të dënuarit.

10. Në rastin e një dyshimi të arsyeshëm për posedim të sendeve të ndaluara kryhet kontroll i imtësishëm, i cili kryhet në çdo rast, në praninë e jo më pak se dy punonjësve.

11. Kontrolli i të miturve të paraburgosur apo të dënuar me çrregullime të shëndetit mendor kryhet në prani të punonjësit social të institucionit.

12. Kontrollet intime mund të përligjen vetëm nga dyshime të arsyeshme për një rast individual dhe kryhen vetëm nga personeli mjekësor.

Neni 125

Situatat emergjente

1. Kufizimi në grup i të drejtave bëhet sipas kriterëve të nenit 7, të ligjit "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve" dhe kësaj rregulloreje.

2. Konsiderohen situata emergjente, si më poshtë:

a) Fatkeqësia natyrore, e cila paraqet një situatë natyrore të pazakonte e të paparashikuar, që vë në



rrezik administrimin dhe menaxhimin e institucionit dhe mund të cenojë jetën dhe shëndetin e të dënuarve;

b) Rastet e sulmeve të armatosura nga jashtë institucionit;

c) Rastet e revoltave masive apo të pjesshme;

ç) Rastet e tentativave apo arratisjeve nga institucioni;

d) Përhapja e sëmundjeve ngjitëse/epidemike;

3. Në rastet e marrjes së informacionit apo konstatimit të njëres prej situatave të pikës 2, drejtuesi i institucionit njofton drejtorin e Përgjithshëm të Burgjeve, i cili vendos shpalljen ose jo të gjendjes së jashtëzakonshme.

4. Nëse gjendja e jashtëzakonshme e institucionit është shkaktuar nga një situatë emergjente, e cila mund të përkeqësohet, atëherë drejtuesi i institucionit mund të vendosë kufizimin në grup të të drejtave dhe njofton menjëherë drejtorin e Përgjithshëm të Burgjeve.

Neni 126

Masat në rastet e situatave emergjente

Llojet e masave në rastet e situatave emergjente janë:

a) rritja e masave nivelit të sigurisë në institucion në përputhje me vlerësimin e rrezikut dhe nivelin e klasifikimit të gatishmërisë, sipas urdhrit të ministrit të Drejtësisë;

b) transferimi i përkohshëm i të paraburgosurit apo i të dënuarit në një institucion më të përshtatshëm të kryerjes së dënimit;

c) kufizimi dhe pezullimi i aktiviteteve në institucion deri në përfundimin e situatës emergjente.

KREU XXIV

MONITORIMI, INSPEKTIMI DHE MASAT ANTIKORRUPSION

Neni 127

Monitorimet e pavarura

DPB-ja krijon mundësi për kryerjen e monitorimeve të pavarura nga agjenci ndërkombëtare dhe nga institucione shtetërore të vendit, që gëzojnë ligjërisht të drejtën të vizitojnë burgjet dhe të monitorojnë kushtet e mbajtjes dhe trajtimit të të dënuarve apo të të paraburgosurve.

Neni 128

Inspektimi në IEVP

Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve dërgon në IEVP grupe inspektimi, të përbëra nga specialistë të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, të cilët bëjnë verifikime me objekt të përgjithshëm apo tematike.

Neni 129

Masat antikorrupsion

1. Pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve funksionon Bordi Antikorrupsion, i cili ngrihet me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve dhe ka për detyrë ndërgjegjësimin, sinjalizimin dhe këshillimin me qëllim parandalimin e çdolloj forme aktive apo pasive të korrupsionit në sistemin e burgjeve.

2. Mënyra e funksionimit dhe kompetencat e Bordit Antikorrupsion përcaktohen sipas udhëzimit të drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.

KREU XXV

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 130

Mbrojtja shtesë e personave të paraburgosur

1. Në asnjë rast të paraburgosurit nuk trajtohen si të dënuar ose si persona që mund të dënohen në të ardhmen.

2. Personat e paraburgosur gëzojnë të drejtat dhe detyrimet që gëzojnë të dënuarit me burgim për aq sa nuk parashikohet ndryshe në këtë rregullore dhe legjislacionin në fuqi.

3. Të paraburgosurit lejohen të informojnë menjëherë familjen për vendndodhjen e tyre. Atyre u krijohen të gjitha kushtet e nevojshme të takohen me familjarët, me përjashtim të rasteve kur kjo pengon ose nuk është në interes të zhvillimit të hetimit dhe gjykimit.

4. Drejtori i institucionit të paraburgimit kufizon të drejtën e të paraburgosurve për të pritur vizita, për të kryer letërkëmbim apo për biseda telefonike, kur është e nevojshme, për kryerjen e veprimeve procedurale penale të urdhëruara nga organi procedues përkatës.



Neni 131

Këshillimi ligjor

Të paraburgosurit informohen në çdo rast për të drejtën për të përfituar këshillim ligjor dhe u krijohen procedura lehtësuese që ata të takohen me mbrojtësit ligjorë dhe të përgatitin mbrojtjen përgjatë gjithë gjykimit.

Neni 132

Lejet e veçanta për të paraburgosurit

1. Të paraburgosurit nuk përfitojnë leje shpërblyese.

2. Me miratimin paraprak të prokurorit dhe të drejtorit të institucionit, të paraburgosurit mund t'i jepet leje e veçantë për:

- a) lindje të fëmijës të të paraburgosurit;
- b) martesë e fëmijës, vëllait, motrës apo prindit të të paraburgosurit;
- c) vdekje të fëmijës, bashkëshortit / bashkëshortes, vëllait, motrës apo prindit të të paraburgosurit ose të bashkëshortit të tij.

3. Vërtetimi i fakteve juridike dhe identifikimi i

personave të mësipërm bëhen në bazë të dokumenteve të lëshuara për këto raste nga institucionet përkatëse.

Neni 133

Lirimi i të paraburgosurve

1. Lirimi i personave të paraburgosur bëhet vetëm me vendim të gjykatës ose të prokurorisë. Në rastet kur i paraburgosuri i liruar nuk ka mundësi strehimi ose transporti pranë familjes së tij, drejtori i institucionit, në bashkëpunim me institucionet vendore, si dhe organizatat e tjera, mundësojnë sistemimin dhe transportin e tij.

2. Në rast pamundësie objektive për t'u larguar nga institucioni pas lirim, me kërkesën e tij, personi i paraburgosur mundëson strehimin në institucion deri në përfundimin e pengesës për largim.

Neni 134

Dispozitë kalimtare

Rregulloret e brendshme të IEVP-ve mbeten në fuqi deri në miratimin e rregulloreve të reja.

Aneksi nr. 1

REGJISTRI I KËRKESËS DHE ANKESËS

Nr.	Protokoll (Nr. datë)	Emër/Mbiemër	Objekti		Përmbajtja	Shtatori i detyrës	Data e delegimit	Vendimi dhe kryerësi	Data e kthimit të përgjigjes	Numërimi	Vërejtje
			Kërkesë	Ankesë							

**VENDIM****Nr. 438, datë 20.5.2015**

**PËR KRIJIMIN E FONDIT KOMBËTAR
TË GARANCISË PËR KREDITIMIN E
BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6, pika 3, e 7, të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, dhe të marrëveshjes ndërmjet qeverisë shqiptare dhe qeverisë japoneze për krijimin e Njësisë së Menaxhimit të Projektit “Rritja e prodhimit ushqimor 2KR”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin, në buxhetin e vitit 2015, miratuar për Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, të Fondit Kombëtar të Garancisë, në masën 300 000 000 (treqind milionë) lekë, për nxitjen e kreditimit në bujqësi dhe zhvillimin rural, me burim financimi, si më poshtë vijon:

a) Në zërin “Transferte në buxhetet familjare”, të fondit të bujqësisë dhe zhvillimit rural, për vitin 2015, pakësohet fondi prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh.

b) Fondet e mbledhura dhe të ricikluara të ish-projektit 2KR, deri në masën 200 000 000 (dyqind milionë) lekë, bëhen pjesë e Fondit Kombëtar të Garancisë, për kreditimin e bujqësisë dhe zhvillimit rural.

2. Procedurat, kriteret dhe kushtet e përfitimit nga Fondi Kombëtar i Garancisë do të përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe ministrit të Financave.

3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Financave dhe Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

VENDIM**Nr. 439, datë 20.5.2015**

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH PËR
SHPENZIME KAPITALE, NDËRMJET
PROGRAMEVE, BRENDA BUXHETIT
TË VITIT 2015, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E MJEDISIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rishpërndarjen e fondeve për shpenzime kapitale, ndërmjet programeve, brenda buxhetit të vitit 2015, miratuar për Ministrinë e Mjedisit, si më poshtë vijon:

a) Në programin “Administrimi i pyjeve” shtohet fondi në vlerën 12000000 (dymbëdhjetë milionë) lekë, për investim në projektin “Parandalimi i zjarreve dhe prerjeve të paligjshme në pyje në Qarkun e Tiranës”;

b) Në programin “Mbrotja e mjedisit” pakësohet fondi në vlerën 4425000 (katër milionë e katër qind e njëzet e pesë mijë) lekë, për kosto lokale për projektin “Kune-Vain/UNEP”, për vitin 2015;

c) Në programin “Mbrotja e mjedisit” pakësohet fondi për projektin “IPA 2013–Ndryshimet klimaterike”, në vlerën 2666500 (dy milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind) lekë, për kosto lokale, dhe TVSH në vlerën 2000000 (dy milionë) lekë;

ç) Në programin “Mbrotja e Mjedisit” pakësohet fondi për projektin “IPA 2013–Mbetjet”, në vlerën 2666500 (dy milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind) lekë, për kosto lokale, dhe TVSH në vlerën 242000 (dyqind e dyzet e dy mijë) lekë.

2. Ngarkohen Ministria e Mjedisit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

**VENDIM****Nr. 440, datë 20.5.2015**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA RIKONSTRUKSIONI
DHE ASFALTIMI I RRUGËVE TË
BRENDSHME NË BASHKINË E VORËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga rikonstruksioni dhe asfaltimi i rrugëve të brendshme në Bashkinë e Vorës, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Vorë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen për pasuritë tokë “truall”, 75 (shtatëdhjetë e pesë) m², dhe “ndërtesë”, 225 (dyqind e njëzet e pesë) m², në vlerën 5 815 670 (pesë milionë e tetëqind e

pesëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë) lekë, sipas listës bashkëngjitur këtij vendimi.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 5 815 670 (pesë milionë e tetëqind e pesëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë) lekësh të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë Vorë, planifikuar në buxhetin e saj.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga Bashkia Vorë.

6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Afati i përfundimit të punimeve të objektit në Bashkinë Vorë të jetë, në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki.

8. Regjistrimi i ri i pasurisë, për 75 (shtatëdhjetë e pesë) m² truall dhe 225 (dyqind e njëzet e pesë) m² ndërtesë, për rikonstruksionin dhe asfaltimin e rrugëve të brendshme, të bëhet në favor të Bashkisë Vorë.

9. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Bashkia e Vorës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**LISTA E EMËRORE E PERSONAVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR
EFEKT TË TË SHPRONËSIMIT PËR “RIKONSTRUKSIONIN DHE ASFALTIMIN E RRUGËVE
TË BRENDSHME” BASHKIA VORË**

Nr	Emri, mbiemri	Zona kadastrale	Truall/m ²	Ndërtesë/m ²	Çmimi/ truall/lekë	Vlera e truallit	Vlera e ndërtesës	Vlera e shpronësimit/ truall+ndërtesë/ lekë	Nr. i paursisë	Lloji i dokumentit
1	Resul Tahir Devolli Vera Ramazan Devolli	3127	75	225	318.15	234 525	5 581 145	5 815 670	2686	Vërtetim pronësie (bashkëpronësi)
	Totali							5 815 670		

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 476 lekë